

EKOINFO-SISTEM

Research in economics and informatics



Revista EkoInfo-Sistem

KRYEREDAKTOR

Nikollaq Pano
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
E-mail: npano@umsh.edu.al

REDAKTORË

Lindita Milo
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
E-mail: lindita.milo@umsh.edu.al

Dhimitri Tole
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
E-mail: dhimitri.tole@umsh.edu.al

ANËTARË TË REDAKSISË

Neki Frashëri, Akademia e Shkencave	Kozeta Sevrani Universiteti i Tiranës
Greta Angjeli Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë	Jusuf Qarkaxhia Universiteti AAB, Prishtinë
Shpëtim Latifi Ministria e Arresimit, RMV	Frederik Premti Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
Alqi Naqellari Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë	Ira Gjika Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
Orkida Ilollari Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë	Florjan Bombaj Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
Olgerta Idrizi Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë	Blerina Metanj Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
Dolantina Hyka Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë	Vebina Resuli Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
Kreshnik Vukatana Universiteti i Tiranës	Elira Hoxha Universiteti i Tiranës
Blerina Vika Universiteti i Tiranës	

Grafik Dizajn

Iris Tole
GR Property Mng; UX Leader
+1 269 290 6184

UMSHPRESS

Qëllimi dhe objektivat

Revista EkoInfo–Sistem, si pjesë e shtëpisë botuese UMSH Press, boton studime, kërkime, vëzhgime dhe analiza në fushën e ekonomisë dhe informatikës. Ajo synon të nxisë debatin shkencor në këto disiplina, duke përfshirë mjedisin universitar shqiptar dhe subjektet e biznesit që janë baza e ekonomisë së vendit. Me punimet e saj revista do të ofrojë një mbështetje qoftë edhe modeste për të gjithë të interesuarit në nxitjen e konkurrencialitetit të subjekteve ekonomike, rritjen e nivelit të tyre të digjitalizimit, forcimin e kapaciteteve eksportuese dhe përmirësimin e aktiviteteve menaxheriale, me ndikim në rritjen e rendimentit të punës.

Filozofia editoriale

Bordi editorial dhe gjithë e gjithë struktura organizative e kësaj reviste janë të përkushtuar që të rrisin mundësinë e botimeve si me problematika teorike ashtu dhe me rekomandime praktike, në mënyrë që në fushat përkatëse mundësia e botimit të jetë shumë e lartë. Kjo politikë realizohet nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë të bordit editorial me autorët e artikujve, që nga faza e paraqitjes së tyre deri sa ato marrin formën përfundimtare për botim.

Njëkohësisht, i gjithë procesi i rishikimit, sugjerimit, rikonceptimit problemor të përmbajtjes dhe pasqyrimin të vërejtjeve të çdo artikulli është tërësisht i fshehtë, duke garantuar objektivitetin e vlerësimit, barazmundësinë e botimit dhe mbi të gjitha cilësinë e punimit. Ky proces garantohet nga një aplikacion specifik i botimit të revistës, që siguron një sistem të mbyllur gjatë gjithë procesit të përpunimit të çdo artikulli. Bordi editorial realizon një procedurë transparente për autorët në ndihmë të cilësisë së botimeve.

Përfitimet për autorët

Revista synon t'ju shërbejë interesave të studiuesve parësorë, pedagogëve, studentëve të universiteteve të vendit dhe praktikienëve në biznese dhe organizata të tjera. Të gjithë autorët që do të botojnë në këtë revistë do të përfitojnë një ripozicionim të tyre në tregun e botimeve, ndërtimin e marrëdhënieve më aktive me studentët, pedagogët, kërkuesit dhe sidomos më shumë paraqitje për problematikat e fushës së ekonomisë dhe informatikës në fondin e literaturës shqiptare.

Përmbajtja

Evolucioni i institucioneve shoqërore dhe efekti i ekonomisë digjitale mbi to	1
1. Konteksti socio-institucional	1
2. Korniza teorike historike	3
3. Qasja metodologjike	4
4. Gjetjet kryesore	5
4.1 Paraja si kredi	5
4.2 Paraja si normë sociale	6
5. Diskutim dhe përfundime	6
Sfida e “Green Finance” në vendet në zhvillim	9
1. Hyrje	10
2. Rishikim i literaturës	11
3. Metodologjia e Kërkimit	13
4. “Green Finance”, rasti i Shqipërisë	13
5. Përfundime	15
Kontributi i ekonomisë monetare moderne në interpretimin e krizave	18
1. Konteksti i kërkimit	19
2. Kuadri teorik	20
3. Qasja metodologjike	21
4. Gjetjet kryesore	22
4.1 Një ndikim pothuajse zero i politikës monetare të BQE-së	22
4.2 Kërkesa e pamjaftueshme efektive	23
5. Diskutim	26
6. Përfundime	27
Vështrim teorik mbi metodat e reja në menaxhimin e projekteve	30
1. Hyrje	31
2. Qëllimi dhe metodologjia	31
3. Metodatat e menaxhimit të ciklit të jetës së projekteve	32
3.1 Kuadri historik	32
3.2 Metodatat që përdoren në menaxhimin e projekteve	33
4. Përfundime	38
Roli i marketingut digjital në biznesin e vogël në Shqipëri	42
1. Hyrje	43
2. Rishikim literature	43
3. Metodatat e kërkimit	45

4. Analizë e të dhënave	45
5. Rezultate dhe Rekomandime	49
Analiza e faktorit njeri si kërcënim i brendshëm ndaj sigurisë së një organizate	51
1. Hyrje	52
2. Rishikim i literaturës	52
3. Metodologjia	53
4. Kërcënimet e sigurisë	53
4.1 Faktori njeri	53
4.2 Kërcënimet e sigurisë së një sistemi	54
5. Mbrojtja nga punonjësit e privilegjuar	54
5.1 Kontrolli i sesionit të privilegjuar si zgjidhje	55
5.2 Implementimi Politikave të Sistemit të Monitorimit	55
5.3 Hartimi i politikave të monitorimit të aksesit të privilegjuar	55
5.4 Implementimi i monitorimit të aksesit të privilegjuar	59
6. Politika dhe procese mbrojtëse	63
7. Përfundime	64

Evolucioni i institucioneve shoqërore dhe efekti i ekonomisë digjitale mbi to

Albert Gajo^{a,1}, Florjan Bombaj^a, Valter Hoxha^a

^a*Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, Tiranë*

Përmbledhja

Paraja në kuptimin klasik ekonomik luan tre funksione themelore: si mjet pagese, matës vlere dhe ruajtëse e vlerës. Ky artikull fokusohet në disa aspekte të tjerë të funksioneve dhe rolit të parasë në shoqëri, siç janë ato në krijimin, mbështetjen dhe ekuilibrimin e institucioneve në shoqëri, si dhe në aspektet shoqërore. Me një pozicionim teorik socio-ekonomik modern, metodologjia e përdorur është ajo e rishikimit historik të varësisë ndaj tregut ku pas një analize historike të rolit të parasë në formësimin e institucioneve të rëndësishme në shoqëri si familja dhe shteti, si dhe më pas me kthimin e parasë si kredi në një vend me ekonomi tregu të lirë, ky artikull analizon një përmbledhje të drejtimeve kryesore të diskutimeve akademike mbi funksionet shoqërore të parasë në kushtet e rritjes së përdorimit të teknologjisë së informacionit, digjitalizimit apo përdorimit gjithnjë e më shumë të Inteligjencës Artificiale (IA), si dhe vendit dhe rolit që do të ketë paraja virtuale kundrejt parasë klasike.

Fjalët kyç: Paraja; institucionet shoqërore; inteligjenca artificiale; qeverisja monetare

Abstract

Money in the classical economic sense plays three basic functions: as a means of payment, a measure of value and a store of value. This article focuses on some other aspects of the functions and role of money in society, such as those in creating, supporting and balancing institutions in society, as well as social aspects. With a modern socio-economic theoretical positioning, the methodology used is that of the historical review of path dependence where after a historical analysis of the role of money in shaping important institutions in society such as the family and the state, and then with the return of money as credit in a country with a free market economy, this article analyzes a summary of the main directions of academic discussions on the social functions of money in the conditions of the increased use of information technology, digitalization or the increasing use of Artificial Intelligence (AI), as well as the place and role that virtual money will have against classic money.

Keywords: Money; social institutions; artificial intelligence; monetary governance

1. Konteksti socio-institucional

Institucionet kryesore të gjithë-pranuar në shoqëri janë familja, shteti, ideologjia dhe ekonomia, të cilat kanë lindur në faza të hershme të shoqërisë njerëzore, por në bashkëveprimin e tyre një rol të rëndësishëm ka luajtur paraja. Paraja në format e saj embrionale lehtësoi shkëmbimet tregtare, i bëri ato më pak të kushtueshme dhe i dha kuptimin e duhur pronës private, e cila nga

¹ KONTAKT: albertgajo@umsh.edu.al

ana e saj do të krijonte, sipas Engels (1884), premisat për krijimin e institucionit të familjes, si institucioni i parë i një shoqërie civile. Krijimi i institucionit të familjes nuk është vetëm një domosdoshmëri që rridhte nga fakti i nevojës për përmirësimin e gjenetikës, por njëkohësisht si një nevojë për të trashëguar dhe konsoliduar pasurinë dhe pronën private.


Krijimi dhe konsolidimi i familjes do sillte në pellgun e Egjeut dhe Gadishullin Ballkanik krijimin e shteteve të para si institucione që do të formësoheshin nga bashkërendimi me institucionin e familjes. Pa dyshim që paraja në këtë bashkërendim institucional do të luante një rol parësor. Shteti ishte institucioni “çudibërës”, pasi sipas filozofit të njohur Aristotel do t’u kthente njeriun nga një qenie biologjike në një qenie politike. Por nga ana tjetër Aristotel, duke analizuar rolin dhe funksionet e parasë, do t’u konsideronte paranë vetëm për funksionin e saj si mjet shkëmbimi, duke e konsideruar atë “sterile”².

Karakteri “steril” i parasë do të trashëgohej si një dogmë nga ideologjia kristiane pas formimit të shtetit papal, pas rënies së perandorisë Romake, me një ndikim edhe në besimtarët ortodoksë në rajonin e Ballkanit dhe më gjerë. Por ajo që duhet të theksohet është se “ilaçi çudibërës” i parasë nuk buronte nga karakteri steril i tij, por ky qëndrim etatist kristian i tij ndikoi në një dinamizëm më të madh të institucionit religjioz, duke sjellë lindjen e besimit të ri si Muslimanizmi, i cili ndër popujt ku ai u shtri me shpejtësi, ndikoi në zhvillimin e ekonomisë së rajoneve të gjera që shtriheshin nga oqeani Atlantik deri në Paqësor. Po kështu, konsolidoi pozitën e komunitetit jezuit, të cilët e përdorën paranë si instrumentin kryesor jo vetëm për sigurimin e mbijetesës nëpërmjet krijimit dhe funksionimit të institucioneve të para financiare, që do të vinin, apo paranë në qendër të këtij sistemi.

Roli i parasë për ndërlidhjen dhe konsolidimin e institucioneve shoqërore si Familja, Shteti, Ideologjia dhe Ekonomia mund të shikohen në lidhje rrethore kur bëhet fjalë për një shoqëri funksionale me institucione pak a shumë të balancuara dhe të pavaruara. Në këtë rast paraja ka luajtur një rol gjithnjë e më të madh institucional për ekuilibrimin e këtyre institucioneve. Vetëm një shoqëri thellësisht autokratike, si ajo komuniste, do t’u rikthente paranë në origjinën e saj “sterile”, por në një sistem të tillë institucionet nuk janë të ndara dhe të balancuara, por qëndrojnë si një piramidë institucionale ku ekuilibri përcaktohet nga shkalla e represionit dhe presioni ideologjik.

Sir James Steuart (1767), tetë vjet përpara botimit të veprës së Adam Smith-it (Pasuria e Kombeve), në analizën e tij historike natyrshëm vjen në vetitë institucionale që ka paraja, sa më shumë që një ekonomi kalon nga një shoqëri merkantaliste feudale në një shoqëri me një ekonomi tregu të lirë. James Steuart funksionet institucionale të parasë i lidhi ngushtësisht me shndërrimin e parasë në formë kredie ku në formën më të përsosur shoqëria do të ndahej nga sistemi feudal merkantilist kur paraja të funksiononte si kredi. Funksionimi i parasë si kredi lidhet ngushtësisht me institucionin e garancisë së kredisë dhe kjo e fundit me pronën private. Ndërlidhja e parasë në formën e saj institucionale dhe ndërthurja me institucionet e tjera në shoqëri pasqyrohet në Figurën 1.

² Shiko më shumë për këtë çështje Gajo, Albert: Shqipëria Demokraci në Deficit, 2001

Figura 1. Funkzionet socio-institucionale të parasë

2. Korniza teorike historike

Një ekonomi e mallrave është ajo në të cilën prodhimi i tyre shpërndahe në duart e një morie prodhues-shkëmbyesish sovranë, duke marrë vendimet e tyre në mënyrë të pavarur dhe duke hyrë në marrëdhënie me njëri-tjetrin mbi bazën ekskluzive të shkëmbimit vullnetar të produkteve të tyre (Zelizer, 1989). Pra, çdo varësi personale ose hierarkike dhe çdo angazhim kolektiv që do të kufizonte a priori autonominë e vullneteve private përjashtohen nga marrëdhënia e tregut. Termi “ndarje tregu” na duket më i përshtatshmi për të shprehur këtë lidhje paradoksale ku secili duhet të përballlet vazhdimisht me të tjerët për të ngjallur interesin e tyre nëse duan të sigurohen që ka një transaksion. Megjithatë, kur marrim parasysh një ndarje sociale të punës që është edhe pak e zhvilluar, çdo prodhues-shkëmbyes i veçantë e gjen veten të varur materialisht nga një numër shumë i madh prodhues-shkëmbyesish të tjerë, së pari, nga ana e prodhimit, për të marrë të gjitha inputet, por edhe në anën e shitjes së produkteve të tij kur përfshin një mori konsumatorësh fundorë. Për më tepër, identiteti i këtij numri shumë të madh individësh ndryshon sipas evolucionit të teknikave të prodhimit dhe preferencave të konsumatorëve. Në fund të fundit, në një shoqëri të zhvilluar tregu, të gjithë potencialisht varen nga të gjithë, qoftë si furnizues apo si klient, pavarësisht se janë të ndarë nga të gjithë.

Për ekonomistët, paraja karakterizohet nga fakti se ajo është një ekuivalent i përgjithshëm, i pranuar nga të gjithë në të gjitha sferat e shkëmbimit ekonomik (fuqi e pakufizuar çliruese), krejtësisht e këmbyeshme dhe e ndashme. Neoklasikët konsiderojnë gjithashtu se ai është vetëm një mbulesë e mbivendosur mbi shkëmbimin dhe se nuk mund të ketë asnjë efekt në ekonominë reale (prandaj asnjë efekt tjetër përveç çmimeve). Mund të theksojmë kalimthi se Zelizer (1989) ruan vetëm një version, sigurisht dominues, të analizës ekonomike të parasë: le të kujtojmë se për autorë si Hayek (1931), krijimi monetar do të ketë efekte në strukturën e çmimeve relative dhe se Keynes konsideron se mund të të jetë e dëshiruar për vete, gjë që shkakton efekte në ekonominë reale. Megjithatë, këta autorë nuk thellohen në lidhjet që paraja

mund të mbajë me fenomenet sociale.

Sipas sociologëve klasikë, paraja merr pjesë në një lëvizje të perezistueshme të racionalizimit. Kjo lejon zhvillimin e marrëdhënieve egalitare të bazuara në arsye dhe llogaritje, por edhe marrëdhënie jopersonale. Si agjenti kryesor i lirisë, paraja ka edhe efekte tjetërsuese dhe niveluese si dhe vlerëson marrëdhëniet shoqërore në dëm të marrëdhënieve të komunitetit, duke i lënë vendin “*ujërave të akullta të llogaritjes egoiste*” (Mauger 2017). Paraja do të ishte atëherë, së bashku me intelektin dhe ligjin, faktori kryesor në objektivizimin dhe homogjenizimin e jetës shoqërore, një intuitë e Georg Simmel, e analizuar së fundmi nga Perret (2021). Kjo supozon se paraja është një fenomen homogjen, se ka një dikotomi midis parasë dhe vlerave jomonetare dhe se monetizimi shoqëron një komodifikim të pashmangshëm të jetës shoqërore. Gjatë viteve të fundit një pjesë e madhe e kërkimeve empirike kanë eksploruar përdorimet sociale të parasë. Kjo ringjallje duket të jetë rezultat i të paktën dy zhvillimeve madhore: nga njëra anë, ndarja e shumë sociologëve ekonomistë nga kufijtë disiplinorë të vendosur më parë nga “Ndarja e Madhe” midis sociologjisë dhe ekonomisë dhe nga ana tjetër, përhapja e rezultateve dhe paradigmave, që shpesh vijnë nga antropologjia, dhe që lejojnë ose të reflektojnë mbi kuptimet dhe funksionet e parasë nga reflektimet mbi shkëmbimin dhe tregun ose mbi besimin; ose për të reflektuar mbi marrëdhënien midis besimit dhe parasë. Duke ringjallur interesin për shumëllojshmërinë dhe kompleksitetin e kuptimeve shoqërore të parasë, këto huazime kanë bërë të mundur vlerësimin e shumëllojshmërisë së kuptimeve kulturore të parasë. Këto hulumtime kanë nxjerrë gjetje të rëndësishme, por nuk kanë ekzaminuar në mënyrë empirike kuptimet sociale të parasë.

3. Qasja metodologjike

Studimet e fundit metodologjike nga analistë të historisë krahasuese kanë përgjithësuar rëndësinë e “varësisë ndaj tregut” për analizat socio-ekonomike (Mahoney, 2001). Studimet kanë treguar se rezultatet nuk mund të shpjegohen në afat të shkurtër të proceseve ose të një ekuilibri të vetëm. Pikat e nisjes janë “kushtet e mëparshme historike”, të cilat kushtëzuan disa opsione të vlefshme për aktorët në momentin kyç të vendimit. Kryqëzimet kritike kanë dy elemente: 1) Janë pika zgjedhjeje kur një opsion i caktuar miratohet midis dy ose më shumë alternativave. Nëse nuk ka zgjedhje midis alternativave, nuk ka lidhje kritike. 2) Kur zgjidhet një opsion i caktuar, bëhet më i vështirë kthimi në pikën fillestare kur alternativat e shumta ishin ende të vlefshme, por jo të gjitha pikat e zgjedhjes përfaqësojnë kryqëzime kritike.

Një zbulim i mrekullueshëm i “varësisë ndaj tregut” është ideja se është shumë e vështirë për aktorët të ndryshojnë efektet e zgjedhjeve të bëra gjatë momenteve kritike. Kjo rrit gjasat që vendet të ndjekin rrugë të veçanta zhvillimi. Kryqëzimet kritike e kanë këtë efekt sepse rezultojnë në krijimin e institucioneve që konvergojnë drejt soliditetit dhe nuk mund të ndryshohen. Disa institucione shpërndajnë kosto dhe përfitime dhe kur kjo të ndodhë, individët në pozita të ndryshme pushteti do të kenë konflikt interesi. Në këtë rast, një institucion mund të rezistojë edhe kur disa individë preferojnë ta ndryshojnë atë. Pra, një elitë që qeveris dhe merr përfitimet e një marrëveshjeje aktuale institucionale ka fuqi të mjaftueshme për t'i rezistuar këtij transformimi. Sekuencat reaktive janë zinxhirë ngjarjesh të renditura dhe të lidhura përkohësisht. Rezistenca kundrejt institucioneve aktuale është forca fillestare që fillon një reagim vijues. Kundër-reagimet kundër kësaj rezistence mund t'i çojnë aktorët në ngjarjet e mëposhtme. Mekanizmat që nxisin reaksionet sekuenciale janë të ndryshëm nga ata që karakterizojnë proceset e riprodhimit institucional. Një shembull: me institucionet që

mbështesin një elitë të vogël, reagimet e njëpasnjëshme mund të iniciohen kur grupet vartëse mobilizohen kundër marrëveshjeve të vendosura. Një qasje e “varësisë ndaj shtegut” shpjegon se si zgjedhjet e aktorëve krijojnë institucione në periudha të caktuara kritike, si këto institucione mund të ndryshojnë sjelljet e aktorëve dhe si kundërpërgjigjet e aktorëve zhvillojnë modele të reja institucionesh.

4. Gjetjet kryesore

4.1 Paraja si kredi

Për shkak të një zakoni të formuar nga kushtet tona sociale, ne mendojmë për paratë vetëm nga këndvështrimi i një agjenti ekonomik që i përdor ato për të blerë mallra në treg. Kjo është e lidhur pazgjidhshmërisht me ekuivalencën, e cila sqaron pse dhe në çfarë përmasash shkëmbehen mallrat; kjo përcakton vlerën ekonomike të atyre mallrave. Sipas pikëpamjes tradicionale, shkëmbimi, ose një lloj i veçantë reciprociteti, shërben si përkufizim i parasë. Kuptimi i parasë nuk është i kufizuar në atë që mund të bëjë. Është thelbësore që ajo të vendoset në kontekstin e përgjithshëm të qarkullimit të vlerës dhe të asaj që shoqëria “prodhon”, e cila nuk është domosdoshmërisht “dobishmëri”. Pra, paraja është si një mjet i riprodhimit shoqëror. Për këtë arsye Aglietta & Cartelier (1998) emancipojnë nocionin e parasë nga korniza shumë e ngushtë e tregut duke e konsideruar atë si një mjet për shlyerjen e përgjithshme të borxheve, domethënë si një “sistem pagese”. Përkufizimi i një borxhi shoqëror, i cili nuk është domosdoshmërisht konsiderata për transferimin e pronës dhe që mund të gjejë shprehje parësore në sakrificë, është në qendër të kësaj perspektive. Nëse paraja është forma në të cilën shprehet detyrimi për të paguar, ajo duhet kuptuar, duke ndjekur Simmel et al., (1987), si një pretendim që individët tërhiqen nga shoqëria në tërësi. Kjo për shkak se ajo buron nga një lidhje sociale që është më themelore se tregu – një lidhje që artikulon veprimin e agjentëve në tërësinë e organizuar të një shoqërie. Paraja nuk është aq efekti i tregut, sa kushti i ekzistencës së tij. Prandaj, shlyerja e borxheve ndërmjet agjentëve ekonomikë është e mundur vetëm nëse objektivizohet tërësia shoqërore, si garantues dhe si kreditor simbolik. Në ekonominë e njerëzve paraja nuk është aq instrument pagese sa ai i transferimit, qarkullimit apo dhuratës, qëllimi i së cilës është të prodhojë marrëdhënie shoqërore nëpërmjet të cilave ndërtohen marrëdhëniet shoqërore të njerëzve që jetojnë në një shoqëri riprodhuese. Paraja është e pranueshme nga të gjithë, vetëm sepse është e pranueshme nga gjithësecili: prandaj ekziston një dimension mbi-individual, një marrëdhënie vertikale me një parim organizues. Ashtu siç është absurde të thuhet se kemi shpikur gjuhën për të komunikuar, nuk ka kuptim të pretendojmë se kemi pasur idenë e parave për të shkëmbyer mallra më lehtë. Është vetëm brenda një jete shoqërore të strukturuar tanimë nga ndarja e punës dhe në të cilën agjentët janë në mënyrë konstituive të ndërvarur (që është në kundërshtim me postulatin fillestar të teorisë ekonomike ortodokse), se parimi i shlyerjes së borxhit në treg është i kuptueshëm. Paraja nuk është një ent ekonomik, është ajo që e bën ekonominë të mundshme dhe të mendueshme, dhe kjo mund të vijë vetëm nga një ekzistencë joekonomike diku tjetër. Paraja ka një heteronomi³ themelore në raport me tregun.

³ Heteronomia është fakti që një qenie jeton sipas rregullave që i imponohen, sipas një “ligji” që i nënshtrohet.

4.2 Paraja si normë sociale


Si paraja ashtu edhe mallrat mund të kuptohen si baza e flukseve të informacionit në tregje. Luhmann, (1979) duke u bazuar tek Simmel, (1907) thekson rolin e parasë në bërjen e mundshme të marrëdhënieve jopersonale midis njerëzve dhe në këtë mënyrë promovimin e individualizmit. Megjithatë, ai nuk zhvillon plotësisht një llogari të parave si një mjet komunikimi. Nocioni i Marksit për fetishizmin e mallrave është zhvilluar në këtë drejtim nga Lukács (1972). Si Lukács ashtu edhe Simmel krijojnë lidhje midis komodifikimit dhe asaj që Simmel e quan “karakterit llogaritës i kohëve moderne” (1907, fq. 443). Rrjedha e parave në transaksionet e njëpasnjëshme është në vetvete një formë komunikimi; monetarizimi hodhi bazën për një shtrirje të tregjeve që krijuan marrëdhëniet e tyre kuaternare jashtëzakonisht indirekte, pothuajse të padukshme. Megjithatë, dallimi midis komunikimit monetar në tregjet e mëdha dhe flukseve të informacionit të administruar po zvogëlohet pasi paratë bëhen gjithnjë e më shumë një version i informacionit të koduar elektronik. Përveç tregjeve, një sërë marrëdhëniesh joekonomike lehtësohen nga teknologjitë e reja. Për shembull, hobiistët mund të përdorin rrjete kompjuterike për të mbajtur kontakte, një lloj përdorimi gjysmë i administruar. Megjithatë, teknologjitë e reja kanë ndikimet e tyre më dramatike në lloje të ndryshme të rrjedhave të informacionit të administruara më plotësisht. Paraja si një normë sociale tregon një mospërputhje thelbësore. Normat përfaqësojnë sferën sociale, e cila përbëhet nga pritshmëri të pashprehura, vlera të përbashkëta dhe rregulla të pashkruara që drejtojnë jozyrtarisht se si sillen njerëzit (Lee, 2017). Nga ana tjetër, paratë krijojnë botën e tregjeve ekonomike, kostove dhe stimujve. Të dy fushat mbahen të ndara nga korpuset ligjore. Supozohet se paraja shërben si mjet këmbimi ose mjet për modifikimin e rezultateve të veprimeve të ndryshme. Paraja shërben si një nxitje, një sanksion dhe një pengesë kur përdoret për ta bërë sjelljen e dëshirueshme më të shtrenjtë dhe sjelljen e mirë më pak të kushtueshme.

5. Diskutim dhe përfundime

Në shoqëritë perëndimore, autoriteti politik në përgjithësi luan rolin e garantuesit institucional të besimit në para. Kjo garanci është edhe më efektive kur shtetet i japin vetes mjetet për të stabilizuar vlerën e parasë me kalimin e kohës duke monopolizuar në mënyrë progresive emetimin e parave dhe monedhave, një operacion që kontribuon në bërjen e sovranitetit monetar një komponent të sovranitetit politik. Kështu, duke e konsideruar monedhën si atribut qendror të sovranitetit të tyre, shtetet europiane pretendojnë që nga fundi i feudalizmit të kontrollojnë plotësisht hapësirën monetare kombëtare duke vendosur një monedhë të vetme, subjekt i një autoriteti të vetëm, brenda kësaj hapësire dhe duke eliminuar të gjitha burimet e tjera të emetimit monetar. Prandaj, monedhat kombëtare janë të përshtatshme në mënyrë ideale për të mbuluar të gjitha praktikatat monetare. Megjithatë, ky parim i ekskluzivitetit monetar kombëtar në fakt duket se është vazhdimisht i dëmtuar dhe kudo në botë ne vërejmë ekzistencën e mbështetjeve që përmbushin të gjitha ose një pjesë të funksioneve ekonomike që normalisht i atribuohen parasë: njësia e llogarisë, mjetet e pagesës, ruajtja e vlerës. Ata kanë të përbashkët se operojnë krahas monedhave kombëtare, por pa pretenduar se do t'i zëvendësojnë tërësisht, se në shumicën e rasteve nuk janë të konvertueshme në këto monedha kombëtare dhe se i shpëtojnë rregullimit bankar. Kështu, monedhat kombëtare nuk arrijnë kurrë në praktikë të ngopin fushën e praktikave monetare. Projekti i sovranitetit absolut monetar dështon dhe ideja e një monedhe që do të kishte karakter universal ose të pakufizuar, del gjithmonë kundër

realitetit të bashkëjetesës së një morie instrumentesh monetare. Paraja përvetësohet dhe transformohet brenda universeve shoqërore në të cilat qarkullon. Ajo shënohet nga origjina, destinacioni, njerëzit dhe institucionet nëpër të cilat kalon. Nëse prania e saj transformon marrëdhëniet shoqërore, ajo nuk i imponohet aktorëve pasivë: normat, ndalimet, praktikat dhe rregullimet familjare dëshmojnë ndërlikimin e parasë në jetën e përditshme dhe përpjekjet e bëra për ta zbutur atë (de Blic & Lazarus, 2021). Të kuptuarit e parasë si një fakt shoqëror çon në vënien e drejtësisë në dimensionet e saj politike, institucionale dhe morale njëkohësisht, në shumëllojshmërinë e përdorimeve të saj, me pak fjalë, për ta kuptuar atë në të gjithë thellësinë e saj.

Figura 2. Llojet e ndryshme të parasë



Shënim: (Adrian & Mancini-Griffoli, 2021)

Demokratizimi i përdorimit të internetit nga publiku i gjerë në vitet 1990 dhe më pas rritja e tregtisë elektronike prishi modelet tradicionale të këmbimit valutor dhe theksoi më tej dematerializimin e tij. Sot, konsumatorët po blejnë gjithnjë e më shumë në internet, monedha fizike po humbet terren dhe numri i zgjidhjeve dixhitale të pagesave online po shpërthen. Monedhat e reja digjitale janë në rritje. Përtej aspekteve faktike, aktorët e rinj dhe monedhat e reja dixhitale sfidojnë vizionin bashkëkohor të parasë pasi ato priren të çlirohen nga institucionet monetare dhe bankare. Mobilizimi i teorisë monetare më pas rezultoi në pashmangshëm sepse bëhet e nevojshme të sqarohet pyetja se si janë apo nuk janë paratë e reja monetare, apo edhe një formë e re parash. Në harkun kohor të disa viteve, bota e monedhave dhe pagesave ka pësuar trazira të konsiderueshme: zhvillimi i njëkohshëm apo edhe konkurrues i mjeteve të reja të pagesës, rritja e krypto-aseteve dhe shfaqja e monedhave dixhitale nga bankat qendrore dhe/ose private. Këto oferta të reja ngrenë shumë pikëpyetje dhe kanë ndikime makroekonomike, politike dhe ekologjike të përmasave themelore, ndër të cilat më kryesorja është çështja e sovranitetit të shtetit. Paraja ka padyshim një dimension sovran dhe interesi të përgjithshëm. A është e mundur, nëse jo e dëshirueshme, që ajo t'i shpëtojë kontrollit të shteteve dhe bankave qendrore? Ku qëndron e ardhmja e parasë?

Literatura

- Adrian, T., & Mancini-Griffoli, T. (2021). The rise of digital money. *Annual Review of Financial Economics*, 13, pp. 57-77.
- Aglietta, M., & Cartelier, J. (1998). Ordre monétaire des économies de marché. *La monnaie souveraine*, Paris, Éditions Odile Jacob.
- de Blic, D. & Lazarus, J. (2021). Conclusion. Dans : Damien de Blic éd., *Sociologie de l'argent* (pp. 107-108). Paris: La Découverte.
- Engels, F. (1884). From The Origin of the Family, Private Property and the State.
- Gajo, A. (2001) Shqipëria, Demokraci në Deficit, Botim i QKZH.
- von Hayek, F. A. (1931). The "Paradox" of Saving. *Economica*, (32), pp.125-169.
- Lee, J. Y. (2017). Money norms. *Loy. U. Chi. LJ*, 49, 57.
- Lukács, G. (1972). *History and class consciousness: Studies in Marxist dialectics*. mit Press.
- Mahoney, J. (2001). Path-dependent explanations of regime change: Central America in comparative perspective. *Studies in comparative international development*, 36, pp. 111-141.
- Mauger, G. (2017). Les eaux glaciales du calcul égoïste. *Savoir/Agir*, (4), 97-101.
- Perret, B. (2021). *Les nouvelles frontières de l'argent*. Seuil.
- Simmel, G. (1907). The philosophy of money (London and New York, Routledge).
- Simmel, G., Cornille, S., & Ivernel, P. (1987). Philosophie de l'argent. Paris: Presses universitaires de France.
- Steuart, J. (1767). An Inquiry Into the Principles of Political Oeconomy: Being an essay on the science of domestic policy in free nations. In which are particularly considered population, agriculture, trade, industry, money, coin, interest, circulation, banks, exchange, public credit, and taxes (Vol. 2). Publisher: A. Millar and T. Cadell.
- Zelizer, V. A. (1989). The social meaning of money: "special monies". *American Journal of Sociology*, 95(2), pp. 342-377.

Sfida e “Green Finance” në vendet në zhvillim Rasti i Shqipërisë

Elona Shehu^{a,4}, Orkida Ilollari^a

^aUniversiteti Mesdhetar i Shqipërisë, Tiranë

Përmbledhja

Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik është debati më i rëndësishëm i viteve të fundit në Shqipëri, ndërkohë, në vendet e zhvilluara ky koncept lidhet ngushtësisht me Financat Moderne ose “Green Finance”. “Green Finance” dhe evoluimi teknologjik janë të përdorur gjerësisht në vitet e fundit. Ky studim ofron një pasqyrë të zhvillimit financiar, akteve ligjore dhe rregullatore mbi Investimet e Huaja Direkte (IHD) të lidhura ngushtësisht me “Green Finance”. Ky fenomen mund të matet nëpërmjet kredisë bankare për sektorin privat dhe IHD-ve në vendin tonë. “Green Finance” mund të ndikojnë në rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe menaxhimin më të mirë të burimeve të energjisë.

Teorikisht, rritja ekonomike çon në konsum më të lartë të energjisë, gjë që rezulton në degradim të mjedisit dhe burimeve që shfrytëzohen. Politikëbërësit duhet të hartojnë politika mbështetëse për nxitjen e “Green Finance”, për të ulur ndotjen e ajrit dhe mjedisit në afatgjatë. Vendet në zhvillim përgjithësisht ndjekin politikat e vendeve të zhvilluara, por mungesa e kapaciteteve financuese nuk jep të njëjtin ndikim në investimet “Green” dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Ky punim merr në konsideratë të dhëna dhe publikime të institucioneve vendase dhe të huaja, si dhe punime të ngjashme shkencore që lidhen me “Green Finance”. Analiza do të fokusohet në nivelin e kredive për biznese në qytete të ndryshme të Shqipërisë si dhe nga natyra e kreditimeve. Gjithashtu, nëpërmjet tendencës së Investimeve të Huaja Direkte gjatë viteve të fundit do të mund të identifikohet tendenca për të rritur peshën e “Green Finance” në ekonominë e vendit tonë.

Fjalët kyç: Zhvillim i qëndrueshëm; green finance; financat moderne; investimet e huaja direkte; financim bankar

Abstract

Sustainable economic development is the most important debate in recent years, even in Albania. Energy consumption and the emission of greenhouse gases have increased considerably over the last two decades, and present a very real global challenge. As one of the primary inputs for industries and households alike, energy can be considered a prerequisite for economic activity. Improving green finance and promoting technological innovation are last year’s innovative concepts. This study provides an overview of financial development, institutional frameworks, and how foreign direct investment dictate the extent of green development. Financial development is measured through government initiatives for removable energy, bank credit to the private sector and foreign direct investment. Green finance can impact sustainable economic growth.

Economic growth leads to higher energy consumption, which results in degradation of the environment. Policy makers should include development of green finance policies and strong

⁴ KONTAKT: elona.shehu@umsh.edu.al

institutions governance, to lower environmental degradation in the long run. One of the driving forces for economic development is the financial sector. With a strong management system, even countries with limited financial resources are able to positively impact the output. Underdeveloped countries just follow policies that are needed to attain development.

Keywords: Sustainable development, green finance, foreign direct investments, bank loans

1. Hyrje

Një nga forcat lëvizëse për zhvillimin ekonomik është sektori financiar. Përdorimi efikas i burimeve financiare çon në risi në sektorin e financave, duke stimuluar rritjen ekonomike. Sipas një punimi të realizuar nga Sadorsky në vitin 2011 rezulton se ka korrelacione të forta ndërmjet sektorit financiar dhe zhvillimit ekonomik (Sadorsky, P. , 2011). Sektorët financiarë të mirëmenaxhuar janë më tërheqës për investitorët, duke stimuluar rritjen ekonomike; sektori financiar sipas Afzal në një punim mbi “Green Finance” në vitin 2022, inkurajon gjithashtu IHD-të (Afzal, A., et al, 2022).

Kreditimi dhe Investimet e Huaja Direkte do të jenë dy treguesit që do të analizohen për rastin e Shqipërisë dhe nivelit të “Green Finance”. Progresi i sektorit financiar inkurajon edhe thellimin e rritjes të financimit, duke ulur kështu kostot e financimit. Nga një punim i realizuar gjatë vitit 2018 nga Haseeb, rezulton se zhvillimi financiar ka një efekt të rëndësishëm në degradimin e mjedisit (Haseeb, A., et al., 2018). Kriza financiare e vitit 2008 dëshmoi se goditjet në sistemin financiar janë ndjerë në të gjithë ekonominë Globale dhe dihet që sektori financiar ka një rol të rëndësishëm në qëndrueshmërinë e një ekonomie. Ndërkohë, tregjet financiare dhe fokusi i tyre në zgjidhjen e krizës mjedisore bëhet më i madh dhe më i larmishëm, duke mbartur nocionin se kapitali mund të përdoret për të zgjidhur çështje përtej financimit, sigurimit të financimit dhe gjenerimit të fitimeve. Në këtë formë si kapitalizmi ashtu edhe financat moderne janë relativisht të reja; koncepti i “Green Finance” konsiderohet të ketë lindur në vitet 1950 me punimet e para të rëndësishme mbi teorinë moderne financiare (Mangram, M. E. , 1952).

Kapitalizmi dhe financat moderne mund të konsiderohen si një sistem efektiv dhe një mjet efikas për të nxitur potencialin ekonomik të kombeve, pavarësisht nga ndikimi i tyre në mjedis. Shekulli i XX (njëzetë) korrespondon gjithashtu me një periudhë të rritjes së madhe ekonomike dhe të përmirësimit të jashtëzakonshëm të kushteve njerëzore në ato vende që filluan proceset e tyre të industrializimit. Ngrohja globale dhe ndotja e mjedisit si pasojë e ngjarjeve ekstreme të motit të lidhura me klimën kanë funksionuar më pas si një thirrje zgjimi në kufijtë e çdo modeli ekonomik që nuk parashikon ruajtjen e mjedisit si një nga shtyllat e tij. Në këtë aspekt, financat e gjelbra përfaqësojnë përpjekjen e parë të strukturuar të komunitetit financiar global për t’iu bashkuar performancave financiare dhe ndikimit pozitiv mjedisor, dhe mund të shihet si një nga shenjat konkrete të përshtatjes së sistemit ekonomik ndaj sfidës globale mjedisore (Berrou, R., et al., 2019).

Vitet e fundit si forcë lëvizëse për rritjen ekonomike të diskutosh për stabilitet financiar është pothuajse e pamundur, pasi vendet mund të arrijnë qëndrueshmëri financiare dhe ekonomike, duke parandaluar gjithashtu degradimin e mjedisit. Tamazian dhe Rao, në vitin 2010, sugjeruan se cilësia institucionale dhe zhvillimi financiar së bashku përcaktojnë degradimin e mjedisit.

Gjithashtu në përgjigje të tërheqjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) nga Marrëveshja e Parisit në 2017, vendet e BE-së janë bashkuar më tepër për të frenuar ndryshimet klimatike dhe për të menaxhuar sfidat mjedisore.

Ngjarje të shumta të ndodhura vitet e fundit në mbarë globin, sic ishte Pandemia Covid-19 dhe Lufta Rusi-Ukraine mendohet se kanë ndikuar në rivlerësimin e treguesve ekonomikë dhe financiarë përkundëjt ndotjes së ajrit dhe mjedisit. Pandemia është një eksperiment i pakëndshëm natyror që ofron një mundësi të rrallë për të vlerësuar sektorin financiar.

Në vendet e Evropës, pati rritje eksponenciale në rastet e COVID-19 dhe epiqendra e pandemisë u zhvendos nga Kina në Evropë. Përhapja në shkallë të gjerë e kësaj sëmundjeje ndërpreu shumë biznese në të gjithë BE-në, pasi kufizimet u vendosën rreptësisht për muaj të tërë. Bizneset e këtyre vendeve u përpoqën të luftonin me sfidat financiare, përfshirë edhe ato teknologjike dhe mjedisore (Papajorgji, P. Ilollari, O. et al 2021).

Megjithatë, institucionet e forta duhet të kombinohen me politikat e “Green Finance” për të ndihmuar në uljen e dëmit mjedisor. I rëndësishëm konsiderohet niveli arsimor, i cili ka një lidhje të fortë negative me degradimin e mjedisit. Sa më e shkolluar të jetë një shoqëri, aq më i vogël do të jetë dëmi që i shkaktohet mjedisit (Mirza, N., et al., 2020).

Janë kryer tashmë studime të shumta dhe pritet të japin implikime të ndjeshme praktike, të cilat mund të përdoren për të udhëhequr zhvillimin e politikave në sektorin e financave moderne. Kjo, duke nxjerrë në pah llojet e ndryshme të dëmeve mjedisore dhe nevojave për investime “Green”. Gjithashtu, hulumtime të ndryshme, kanë në fokus rëndësinë e institucioneve në kufizimin e dëmeve mjedisore duke taksuar ose subvencionuar ndotësin mjedisor.

Lind nevoja për reforma institucionale në vendet me emetime të larta të Dioksidit të karbonit (CO₂), shkallë të lartë të konsumit të burimeve natyrore dhe përqendrim të lartë të përdorimit të energjisë, e cila arrihet vetëm nëpërmjet institucioneve publike të forta dhe të pakorruptuara. Kompensimi ekologjik i mbështetur nga qeveritë do të nxisë firmat vendase të bëjnë përpjekje për transformimin industrial dhe inovacionin teknologjik. Gjithashtu, edukimi nga ana e institucioneve arsimore mbi konceptin e mbrojtjes së mjedisit luan një rol të rëndësishëm dhe ndihmon në hartimin e politikave të përshtatshme. Të gjitha këto masa duhen ndërmarrë për të arritur tek ajo që quhet “Green Finance”.

2. Rishikim i literaturës

Investitorët po bëhen më të vetëdijshëm për vlerën e energjisë së gjelbër për mirëqenien mjedisore dhe kjo ka çuar në një rritje të financave të gjelbra. “Green Finance” ul rrezikun e kredisë sepse modelet e qëndrueshme të biznesit kanë më pak luhatshmëri në fitime. Huamarrësit me më pak rrezik kredie do të thotë që huadhënësit mund të përfitojnë nga provigjonet më të ulëta të humbjes së kredisë dhe kërkesat për kapital. Kjo ndihmon në arritjen e qëllimeve të sipërmarrjes dhe të mjedisit. Sektori i financave luan një rol të rëndësishëm për të ndihmuar bizneset të marrin burimet financiare që u nevojiten (Ji, X., et al., 2021).

Ai gjithashtu ofron mundësi fitimi për investitorët. Në këtë sektor, është e nevojshme të rritet “Green Finance” sepse opsionet tradicionale të financimit ka të ngjarë të ndikojnë negativisht në mjedis. Hulumtimet kanë zbuluar se “Green Finance” tejkalon aktivet e tjera. Megjithatë, rekomandohet kujdes sepse hulumtime të ndryshme konstatojnë se ka faktorë

dekurajues për investitorët që dëshirojnë të përfitojnë nga Investimet e Gjelbra (Naqvi, B., et al., 2021).

Marrëdhënia midis financave dhe mjedisit është dinamike dhe evoluon me kalimin e kohës. Në fazat fillestare, vendet janë shumë të varfëra për t'u fokusuar në ruajtjen e mjedisit, kështu që ata thjesht ndjekin politikën që nevojiten për të arritur zhvillimin. Pasi të arrijnë njëfarë stabiliteti, vëmendja fillon të zhvendoset në ruajtjen e burimeve natyrore dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Është e sigurt të supozohet se në fazat fillestare, degradimi i mjedisit mund të jetë më i shpejtë se miratimi i politikave të gjelbra. Ndërsa shqetësimet fillojnë të rriten për cilësinë e ajrit dhe ujit, ekonomitë fillojnë të kërkojnë zgjidhje në kompromis me mjedisin (Dinda, S., 2004).

Pao dhe Tsai në punimin e tyre në vitin 2011, kanë zbuluar se zhvillimi ekonomik dhe financiar fillimisht kontribuojnë në degradimin e mjedisit (emetimet e karbonit), por me kalimin e kohës, ky përkeqësim ngadalësohet dhe madje përmirësohet në disa raste. Ndërkohë, ekziston një marrëdhënie jo-lineare midis thellimit financiar dhe degradimit të mjedisit (konsumi i energjisë dhe emetimet e dioksidit të karbonit), në vende të ndryshme është i ndryshëm. Ata kanë zbuluar gjithashtu se IHD-të çuan në një rritje të degradimit të mjedisit. Ky fenomen është përshkruar nga disa studiues si hipoteza e strehimit të ndotjes. Zhvillimi financiar dhe ekonomik çon në emetime më të larta të CO₂, por pas një niveli të caktuar, emetimet e karbonit kontrollohen (Pao, H. T., & Tsai, C. M., 2011).

Hulumtime të ndryshme kanë nxjerrë në pah tre kanale të mundshme ndërmjet zhvillimit financiar dhe degradimit të mjedisit:

- (i) është vlerësuar se zhvillimi financiar dhe rritja e kreditimit në sektorë që nuk janë të mirëorientuar mund të ndikojë në degradimin e mjedisit nëpërmjet rritjes ekonomike;
- (ii) zhvillimi financiar tërheq IHD-të, si pasojë e kushteve më të favorshme për kreditim, të cilat inkurajojnë rritjen ekonomike;
- (iii) rritja ekonomike çon në konsum më të lartë të energjisë, gjë që rezulton në degradimin e mjedisit.

Ajo që ndodh kur tregjet financiare lulëzojnë, rrit kredinë në dispozicion të konsumatorëve, kjo rrit fuqinë blerëse dhe kërkesën për produkte me energji intensive. Kur produkte të tilla blihen dhe konsumohen në sasi më të mëdha, ndotja rritet. Rritja e konsumit, çon në rritjen e investimeve gjë që çon në konsum më të lartë të energjisë dhe prodhimi i energjisë është një kontribues kryesor në përkeqësimin e mjedisit. Në këtë kontekst, rritja ekonomike gjeneron rritje të kërkesës dhe konsumit të energjisë (Taghizadeh-Hesary, et al., 2021).

Punime të ndryshme shkencore konstatojnë se vendet që mbështeten shumë në burimet energjitike të pa rinovueshme përballen me zhvillim më të ulët financiar.

Kriza e vazhdueshme COVID-19 ka ndikuar negativisht në ekonomitë e mëdha dhe shumë tregje financiare. Gjithashtu u konstatua se performanca e fondeve të rinovueshme u përkeqësua gjatë pandemisë (Ilollari, O., Papajorgji, P., Civici, A. 2020).

Megjithatë, kjo krizë ka sjellë edhe disa efekte pozitive. Në fushën e mirëqenies mjedisore, emetimet e karbonit u frenuan gjatë gjysmës së parë të 2020 pasi u vendosën bllokime në të gjithë globin për të kontrolluar përhapjen e kësaj sëmundjeje. Këto kufizime çuan në pezullimin e transportit dhe operacioneve industriale, të cilat janë burimet kryesore të ndotjes së ajrit. Ndërsa kontrollat u lehtësuan në gjysmën e dytë të vitit, emetimet filluan të rriteshin përsëri. Pra, edhe pas pandemisë, emetimet e karbonit do të mbeten një çështje e rëndësishme. Më tej, në ekonomitë e zhvilluara investimet financiare luajtën një rol kyç në rritjen e projekteve të lidhura me “Green Finance” (Schumacher, K., et al., 2020).

3. Metodologjia e Kërkimit

Ky punim bazohet në analizën e dy treguesve kryesorë të cilët do të na japin një informacion se si po nxitet “Green Finance” në Shqipëri. Referuar këtij koncepti do të duhet të jemi në gjendje t’i përgjigjemi pyetjes së ngritur:

“Cilët janë faktorët dhe sfidat kryesore për iniciativat e “Green Finance” në Shqipëri?”

Burimi kryesor do të jenë informacionet nga literatura ekzistuese, studime dhe publikime shkencore vendase dhe të huaja mbi nismat e “Green Finance” në Shqipëri dhe në vendet e BE. Janë përdorur artikuj akademikë, raporte, dokumente politikash dhe burime të tjera përkatëse për identifikimie e “Green Finance” që janë përfaqësuese të llojeve të ndryshme të mekanizmave financues, sektorëve dhe madhësive të projekteve. Të dhënat e mbledhura për të identifikuar rastet e suksesit dhe sfidat për nismat e “Green Finance” në Shqipëri, i referohen nivelit dhe llojit të kreditimit në vendin tonë dhe përqëndrimit të IHD-ve sipas sektorëve të ekonomisë.

Gjithashtu, janë identifikuar faktorët që kontribuojnë në iniciativat e suksesshme të financave të “Green Finance”, të tilla si: kornizat rregullatore, stimujt financiar, angazhimi i palëve të interesuara, qëndrueshmëria e projekteve, sfidat që kufizojnë marrjen e iniciativave të financave të gjelbra, të tilla si aksesit i kufizuar në financa, mungesa e ekspertizës teknike dhe barrierat rregullatore. “Green Finance” është një koncept i kufizuar nga mungesa e legjislacionit të detyrueshëm dhe mungesa e informacionit mbi ndotjen e mjedisit në vendin tonë (Jorgji, E., & Gjika, A. (2022).

Ky punim ka në fokus identifikimin dhe thellimin e këtij koncepti në vendin tonë si dhe adresimin e sfidave për të promovuar suksesin e nismave të financave të gjelbra në Shqipëri. Duke ndjekur këtë metodologji, studimi mund të japë njohuri mbi faktorët që kontribuojnë në suksesin ose dështimin e nismave të “Green Finance” në Shqipëri dhe të japë rekomandime sesi të promovohet përvetësimi i këtij koncepti në vend.

4. “Green Finance”, rasti i Shqipërisë

Një sasi e madhe burimesh financiare, tashmë janë mobilizuar nga burime vendase dhe të huaja, private dhe publike për të ndjekur zhvillimin e qendrueshëm ekonomik pa shkaktuar rritje të ndotjes në mjedis. Zhvillimi i konceptit të “Green Finance” do të matet duke përdorur kredinë për biznesin dhe IHD në Shqipëri në vitet e fundit. Studime të ndryshme sugjerojnë se me rritjen e investimeve të huaja, vendet priren të lëvizin drejt niveleve më të larta të mbetjeve të karbonit.

Për shembull, financimi i zhvillimit të lidhur me klimën, i angazhuar në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë, përbën një të tretën e financimit total të zhvillimit për këtë sektor, shumë më i ulët se mesatarja globale. (Wu, S., et al, 2021).

“Green Finance” i referohen produkteve dhe shërbimeve financiare që promovojnë investime të qëndrueshme për mjedisin dhe mbështesin ekonominë me ndotje të ulët në mjedis. Në Shqipëri, zhvillimi i “Green Finance” është ende në fazat fillestare. Shqipëria mund të krijojë një kuadër rregullator për të mbështetur “Green Finance”, duke përfshirë udhëzimet dhe standardet për investimet e gjelbra, kërkesat e raportimit dhe stimujt për investimet e gjelbra. Baza rregullatore duhet të përfshijë krijimin e një kuadri rregullator për të mbështetur “Green

Finance”, i cili mund të përmbajë udhëzime dhe standarde për investimet e gjelbra, si dhe kërkesat e raportimit dhe stimujt për to. Autor i këtij kuadri rregullator është qeveria në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë⁵, dhe me organizata të tjera si Financial Sector Adviser Center (FinSAC)⁶. Gjithashtu sipas studimit “Buxheti i Gjelbër në Shqipëri” identifikohet se nuk ka ende një kuadër rregullator të detyrueshëm për zbatimin e buxhetimit të gjelbër në Shqipëri⁷. Programi i Përbashkët i OKB-së "Sustainable Development Goals" (SDG) synon të mbështesë financimin e SDG në Shqipëri, duke punuar në bashkëpunim të ngushtë me institucionet dhe nga ana tjetër institucionet financiare mund të inkurajohen të zhvillojnë produkte të reja për qeverinë dhe palët e tjera të interesuara⁸.

Nga ana e institucioneve financiare që mbështesin investimet e gjelbra, krijohen produkte si obligacionet e gjelbra, kreditë e gjelbra dhe sigurimet e gjelbra. Programet e asistencës teknike dhe ngritjes së kapaciteteve mund të zhvillohen për të mbështetur institucionet financiare dhe investitorët në kuptimin dhe vlerësimin e mundësive për investime të gjelbra (O. Ilollari, P. Papajorgji, A. Gere, R. Zemel., et al, 2019).

Kjo mund të arrihet nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit për financat e gjelbra dhe përfitimet e saj tek investitorët, institucionet financiare dhe publiku mund të ndihmojë në nxitjen e zhvillimit të financave të gjelbra në Shqipëri. Inkurajohet kështu bashkëpunimi ndërmjet palëve të interesuara, si institucionet financiare, investitorët, rregullatorët dhe organizatat e shoqërisë civile, duke nxitur zhvillimin e financave të gjelbra në Shqipëri. Duke adoptuar këto praktika, Shqipëria mund të zhvillojë një ekosistem të “Green Finance” që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm dhe kalimin në një ekonomi me ndotje të ulët (Shahini, E., Pacukaj, S., & Qarri, A. 2014).

Në Tabelën 1 paraqitet ndër vite shpërndarja e kreditimit të ekonomisë në Shqipëri për vitet 2017-2022. Përsa i përket nivelit të kredive të dhëna për të mbështetur projektet e energjisë së rinovueshme në Shqipëri, të dhënat janë të kufizuara (Naqellari, A., Pacukaj, S., & Shahini, E. (2014).

Nga të dhënat zyrtare të Shoqatës së Bankave dhe Bankës së Shqipërisë vihet re se portofili i kredisë përqëndrimin më të madh e ka në qarkun e Tiranës me mesatarisht 80% të gjithë portofolit të kreditimit të ekonomisë, pasuar nga Durrësi me 7% dhe më të ulët in e ka Korca dhe Lezha me 1%. Ky përqëndrim i nivelit të kreditimit bazuar edhe në konceptin e urbanizimit jep efektin e tij në natyrën e aktiviteteve të kredituara. Kryesisht sektori i ndërtimit është ai më i kredituari në Tiranë dhe sektori i tregëtisë në qytetet e tjera. “Green Finance” kërkon një riorganizim të kredive për bizneset duke kredituar më tepër biznese që në fokus kanë përdorimin e energjisë së rinovueshme ose alternative. Kjo pasi urbanizimi dhe tendenca e vendeve të zhvilluara për të ulur emisionin e CO₂ në ambient duhet të ndiqet edhe nga vendet në zhvillim.

Vihet re një rënie e lehtë e kreditimit në Tiranë gjatë vitit 2018, duke kredituar më shumë qytete si Fieri dhe Durrësi. Ajo që vihet re është një përqëndrim i vazhdueshëm i kreditimit në qytetet e mëdha duke mos sjellë asnjë plan zhvillimi për qytetet e vogla apo zhvillimin rural dhe projektet bujqësore.

⁵https://www.bankofalbania.org/Press/The_First_Deputy_Governor_of_the_Bank_of_Albania_attends_the_International_Conference_Green_Finance-Possibilities_for_the_financial_sector_in_Albania.html

⁶ <https://www.suerf.org/suer-policy-brief/63117/climate-risks-in-albania-and-their-relevance-to-the-central-bank>

⁷ https://www.wfd.org/sites/default/files/2022-09/EN_Green-Budgeting-in-Albania_Final.pdf

⁸ <https://albania.un.org/en/114509-strategic-policy-options-sdg-financing-joint-programme>

Tabela 1. Kreditimi në përqindje ndaj totalit në Shqipëri sipas qarqeve, 2017-2022

Qarku	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Tiranë	0.80	0.79	0.80	0.80	0.80	0.80
Durrës	0.07	0.08	0.07	0.07	0.07	0.07
Elbasan	0.02	0.02	0.02	0.02	0.02	0.01
Shkodër	0.02	0.01	0.01	0.01	0.02	0.01
Korçë	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01
Vlorë	0.02	0.02	0.02	0.02	0.02	0.02
Fier	0.02	0.02	0.01	0.01	0.01	0.01
Lezhë	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01	0.01
Të tjera	0.04	0.04	0.04	0.05	0.05	0.05

Shënim: Raportet e Stabilitetit Financiar Banka e Shqipërisë 2017-2022 (përpunimi i autorëve)

Në Tabelën 2 më poshtë shihet stoku i Investimeve të Huaja Direkte (IHD) në vendin tonë nga viti 2014 deri në vitin 2021. Gjatë viteve kur pandemia e Covid-19 dha edhe impakt më të madh në ekonomi shohim një rënie në nivelin e IHD-ve në Shqipëri dhe një lulëzim të tyre në vitin 2021. Niveli i IHD-ve në vend ka pësuar luhatje si pasojë e situatave të emergjencave të viteve të fundit, por tendenca ka qënë rritje e nivelit të investimeve të huaja. Mungesa e të dhënave mbi sektorët ku është investuar e bën akoma më të paqartë situatën lidhur me konceptin e “Green Finance”.

Tabela 2. Niveli i Investimeve të Huaja Direkte në Shqipëri, 2014-2021 (mijë euro)

Viti	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Ndryshimi ne vlere	-	418,180	695,560	778,830	999,060	518,920	506,450	1,057,230
Ndryshimi ne %	-	9.2%	14.0%	13.7%	15.5%	7.0%	6.4%	12.5%
Totali i ID-detyrime	4,563,520	4,981,700	5,677,260	6,456,090	7,455,150	7,974,070	8,480,520	9,537,750

Shënim: Banka e Shqipërisë 2014-2021

5. Përfundime

Ky punim kishte në fokus analizën e sfidave dhe mundësive të implementimit të “Green Finance” në Shqipëri. Shqipëria si vend në zhvillim duhet të përshtasë politika të përshtatshme të implementimit gradual të “Green Finance”, në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Të gjitha palët dhe grupet e interesit në këtë sektor kanë nevojë për edukim mbi konceptin e “Green Finance”, duke identifikuar sfidat dhe përparësitë që paraqesin këto tendenca të reja financiare.

Nga kjo analizë u vu re se mungonte kuadri rregullator i cili do të ndihmonte investimet e gjelbërta të kishin një orjentim më të mirë dhe mbështetje nga sektori financiar. Institucionet më iniciatore të kuadrit rregullator duhet dhe mund të jenë qeveria, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, dhe organizata të tjera si Financial Sector Adviser Center (FinSAC)⁹.

⁹ <https://www.worldbank.org/en/programs/financial-sector-advisory-center>

Ajo çfarë del nga ky studim është se kjo bazë rregullatore duhe të përmbajë udhëzime dhe standarde për investimet e gjelbra, si dhe kërkesat e raportimit dhe stimujt për këto investime. Gjithashtu lind nevoja që përveç akteve rregullative, institucionet në vend të implementojnë politika “Green Finance” për të thithur investimet e huaja në kuadër të rritjes së qëndrueshme ekonomike.

Aplikimi i Subvencioneve dhe lehtësive tatimore nga ana e qeverisë do të nxisë firmat vendase dhe të huaja të bëjnë përpjekje për transformimin industrial dhe inovacionin teknologjik. Institucionet financiare mund të inkurajohen të zhvillojnë produkte të reja financiare që mbështesin investimet e gjelbra, si obligacionet e gjelbra, kreditë e gjelbra dhe sigurimet e gjelbra.

Duhet të krijohen programe të asistencës teknike për të mbështetur institucionet financiare dhe investitorët në shfrytëzimin e mundësive për investime “Green”.

Nga të dhënat zyrtare vihet re se portofili i kredisë përqëndrimin më të madh e ka në qarkun e Tiranës me mesatarisht 80% të të gjithë portofolit të kreditimit të ekonomisë, dhe kryesisht të fokusuar në sektorin e ndërtimit.

Niveli i IHD-ve në vend ka pësuar luhatje si pasojë e situatave të emergjencave të viteve të fundit, por tendenca ka qënë rritje e nivelit të investimeve të huaja. Mungesa e të dhënave mbi sektorët ku është investuar e bën akoma më të paqartë situatën lidhur me konceptin e “Green Finance”.

Literatura

- Afzal, A., et al. (2022). Afzal, A., Rasoulinezhad, E., & Malik, Z. (2022). Green finance and sustainable development in Europe. *Economic Research-Ekonomska Istraživanja*, 35(1), 5150-5163.
- Berrou, R., Dessertine, P., & Migliorelli, M. (2019). An overview of green finance. The rise of green finance in Europe: opportunities and challenges for issuers, investors and marketplaces, 3-29. MacMillan.
- Dinda, S. (2004). Environmental Kuznets curve hypothesis: a survey. *Ecological economics*, 49(4), 431-455.
- Haseeb, A., Xia, E., Baloch, M. A., & Abbas, K. (2018). Financial development, globalization, and CO₂ emission in the presence of EKC: evidence from BRICS countries. *Environmental Science and Pollution Research*, 25, 31283-31296.
- IEA. (2021). https://iea.blob.core.windows.net/assets/deebef5d-0c34-4539-9d0c-10b13d840027/NetZeroBy2050-ARoadmapfortheGlobalEnergySector_CORR.pdf
- Iollari, I., Papajorgji, P., Gere, A., Zemel, R., Moskowitz, H., (2019) Using mind genomics to understand the specifics of a customer’s mind. *The European Proceedings of Social & Behavioural Sciences*.
<https://www.europeanproceedings.com/article/10.15405/epsbs.2019.10.02.17>
- Ji, X., Zhang, Y., Mirza, N., Umar, M., & Rizvi, S. K. A. (2021). The impact of carbon neutrality on the investment performance: Evidence from the equity mutual funds in BRICS. *Journal of Environmental Management*, 297, 113228.

- Jorgji, E., Gjika A., (2022). Determinants of Green Innovation: Firm-level evidence from Albania. *Circular Economy*, 2022.
- Mangram, M. E. . (1952). Mangram, M. E. (2013). A simplified perspective of the Markowitz portfolio theory. *Global journal of business research*, 7(1), 59-70.
- Mirza, N., Hasnaoui, J. A., Naqvi, B., & Rizvi, S. K. A. (2020). The impact of human capital efficiency on Latin American mutual funds during Covid-19 outbreak. *Swiss Journal of Economics and Statistics*, 156(1), 1-7.
- Naqvi, B., Mirza, N., Rizvi, S. K. A., Porada-Rochoń, M., & Itani, R. (2021). Is there a green fund premium? Evidence from twenty seven emerging markets. *Global Finance Journal*, 50, 100656.
- Pao, H. T., & Tsai, C. M. . (2011). Modeling and forecasting the CO₂ emissions, energy consumption, and economic growth in Brazil. *Energy*, 36(5), 2450-2458.
- Sadorsky, P. . (2011). Financial development and energy consumption in Central and Eastern European frontier economies. *Energy policy*, 39(2), 999-1006.
- Schumacher, K., Chenet, H., & Volz, U. (2020). Sustainable finance in Japan. *Journal of Sustainable Finance & Investment*, 10(2), 213-246.
- Shahbaz, M., et al. (2018). Economic growth, energy consumption, financial development, international trade and CO₂ emissions in Indonesia. *Renewable and Sustainable Energy Reviews*, 25, 109-121.
- Shahbaz, M., Hye, Q. M. A., Tiwari, A. K., & Leitão, N. C. (2013). Economic growth, energy consumption, financial development, international trade and CO₂ emissions in Indonesia. *Renewable and Sustainable Energy Reviews*, 25, 109-121.
- Shahbaz, M., Zakaria, M., Shahzad, S. J. H., & Mahalik, M. K. (2018). The energy consumption and economic growth nexus in top ten energy-consuming countries: Fresh evidence from using the quantile-on-quantile approach. *Energy Economics*, 71, 282-301.
- Shahini (Shehu), E., Pacukaj, S., & Qarri, A. (2014). Globalization and Economic Relations Perspective of Albania - Kosovo. *Academic Journal of Interdisciplinary Studies*, 3(4), 161. <https://www.richtmann.org/journal/index.php/ajis/article/view/3084>
- Taghizadeh-Hesary, F., Yoshino, N., & Phoumin, H. (2021). Analyzing the characteristics of green bond markets to facilitate green finance in the post-COVID-19 world. *Sustainability*, 13(10), 5719.
- Tamazian, A., & Rao, B. B. (2010). Do economic, financial and institutional developments matter for environmental degradation? Evidence from transitional economies. *Energy economics*, 32(1), 137-145.
- Wu, S., Zhang, H., Tian, Y., & Shi, L. (2021). Financial distress warning: an evaluation system including ecological efficiency. *Discrete Dynamics in Nature and Society*, 2021, 1-9.

Pse tregjet dështojnë? Kontributi i ekonomisë monetare moderne në interpretimin e krizave

Florjan Bombaj^{a,10}, Valter Hoxha^a, Majlinda Shehu^a

^a*Unversiteti Mesdhetar i Shqipërisë*

Përmbledhja

Ka më shumë se dy dekada që norma vjetore e rritjes ekonomike të Eurozonës ka mbetur në stagnacion, duke u prirur drejt zeros. Kësaj situatë të vështirë në vitet e fundit iu shtua pandemia COVID-19 dhe kriza gjeopolitike e energjisë, e cila ndikoi negativisht në rritjen ekonomike. Objektivi ynë është ta analizojmë këtë çështje duke analizuar komponentët e kërkesës agregate që ndikojnë në rritjen ekonomike të Eurozonës. Metoda e përdorur në analizën e produktit të brendshëm bruto është ajo e shpenzimeve. Të dhënat e përdorura për matjen e treguesve makroekonomikë që përbëjnë kërkesën agregate janë marrë nga bazat e të dhënave të OECD dhe EUROSTAT. Rezultatet kryesore tregojnë për një korrelacion të dobët të aplikimit të politikës monetare ekspansioniste dhe jokonvencionale. Gjithashtu, rritja e borxhit në sektorin privat ka frenuar investimet ku rritje të tyre kemi vetëm në asetet e teknologjisë së komunikimit dhe informacionit si dhe pronësinë intelektuale. Bazuar në gjetjet tona kryesore, dhe në kuadër të krizave të njëpasnjëshme, mund të konkludojmë se sektori privat ka nevojë për ndërhyrje të fuqishme të shtetit në ekonomi. Rritja ekonomike dhe frenimi i papunësisë mund të arrihen nëpërmjet një kombinimi të një teorie Kejnside dhe politikës monetare jokonvencionale.

Fjalët kyç: PBB; eurozona; norma e inflacionit; norma e papunësisë; investimet; shpenzimet qeveritare; punësimi

Abstract

It has been more than two decades that the annual economic growth rate of the Eurozone has remained stagnant, tending to zero. To this difficult situation, in the last years was added the COVID-19 pandemic and geopolitical energy crisis which negatively impacted economic growth. Our objective is to analyze this issue by analyzing the components of the aggregate demand that affect the economic growth for the Eurozone. The method used in the analysis of gross domestic product is that of expenditures. The data used to measure the macroeconomic indicators that compose the aggregate demand were taken from the databases of OECD and EUROSTAT. The main results show a weak correlation of the application of expansionary and unconventional monetary policy. Also, the increase of debt in the private sector has restrained investments where we have their growth only in the assets of communication and information technology as well as intellectual property. Based on our main findings, and in the context of successive crises, we can conclude that the private sector needs strong state intervention in the economy. Economic growth and curbing unemployment can be achieved through a combination of a Keynesian theory and unconventional monetary policy.

¹⁰ Kontakt: florjan.bombaj@umsh.edu.al

Keywords: GDP; eurozone; inflation rate; unemployment rate; investment; government spending; employment

1. Konteksti i kërkimit

Gjatë Depresionit të Madh të viteve 1930, teoria ekonomike e atëhershme në fuqi nuk ishte në gjendje të shpjegonte shkaqet e kolapsit të ekonomisë botërore dhe aq më pak të frymëzonte politikat publike që do të duhet të kishin bërë të mundur ringjalljen e prodhimit dhe punësimit. Ekonomisti britanik John Maynard Keynes revolucionarizoi mendimin ekonomik duke shkatërruar idenë e atëhershme dominuese se ekonomia e tregut siguronte automatikisht punësimin e plotë; me fjalë të tjera, kushdo që dëshironte të punonte gjente një punë nëse kërkesat e tyre për paga ishin fleksibël. Fija e zakonshme që kalon nëpër këtë teori, së cilës ai i dha emrin e tij, është se kërkesa agregate - shuma e shpenzimeve familjare, biznesit dhe qeveritare - është shtytësi kryesor i ekonomisë. Keynes më tej argumentoi se ekonomia e tregut nuk kishte mekanizma automatikë balancues për të siguruar punësim të plotë. Për Kejnsonianët, ndërhyrja e shtetit përmes politikave që synojnë arritjen e punësimit të plotë dhe stabilitetin e çmimeve është e justifikuar. Sipas tyre, tre parime kryesore shpjegojnë se si funksionon ekonomia: (1) Kërkesa agregate ndikohet nga shumë vendime ekonomike, publike apo private. Vendimet e sektorit privat mund të kenë rezultate të pafavorshme makroekonomike (për shembull, ulje të shpenzimeve të konsumatorëve gjatë një recesioni); (2) Çmimet, dhe veçanërisht pagat, i përgjigjen ngadalë ndryshimeve në ofertë dhe kërkesë, duke krijuar mungesa ose teprica periodike, veçanërisht në tregun e punës; (3). Efektet më të rëndësishme afatshkurtra të ndryshimeve, të parashikuara ose jo, në kërkesën agregate ndihen në prodhimin real dhe punësimin dhe jo në çmimet. Kejnsonianët besojnë se për shkak se çmimet janë disi të ngurtë, luhatjet në çdo komponent të shpenzimeve (konsumi, investimet ose shpenzimet qeveritare) ndryshojnë prodhimin.

Sipas analizës së shkollës së re klasike¹¹ (Sargent, 2022) politika monetare i kushtohet sigurimit të stabilitetit makroekonomik që mund të barazohet me mbajtjen e ekonomisë në rrugën e saj potenciale të rritjes, duke ditur që kjo normë rritjeje përcaktohet vetëm nga kushtet e ofertës në produkt dhe tregjet e punës, si ato që lidhen me llojin e progresit teknik dhe stimujt që e nxisin atë. Modelet e fundit të ekuilibrit të përgjithshëm stokastik dinamik të cilësuar si Kejnsonian janë pjesë e kësaj perspektive. Ata ishin në gjendje të çonin në këtë rezultat që disa e kanë quajtur një “rastësi hyjnore”, në këtë rast që marrja e çmimeve të qëndrueshme do të garantonte një reduktim të hendekut ndaj produktit potencial. Ky rezultat, i cili shërbeu si një justifikim teorik për praktikën e bankave qendrore, është gjithsesi i diskutueshëm. Përvoja e kohëve të fundit tregon se respektimi i këtij objekti të inflacionit mund të fshehë fare mirë disbalancat, nëse jo edhe t'i përforcojë ato (Gaffard, 2014). Kush mund t'a kishte vënë në pikëpyetje, në vitin 2007, strategjinë e rritjes së Shteteve të Bashkuara duke pasur parasysh normën e saj pothuajse zero të inflacionit, normën e saj historikisht të ulët të papunësisë, normën e saj jashtëzakonisht të lartë të rritjes? Kush mund të kishte parashikuar inflacionin e viteve të fundit të shkaktuar nga kriza sanitare dhe gjeopolitika e energjisë? Objektivi i inflacionit duket se garanton stabilitet dhe rritje. Megjithatë, ka lindur një krizë globale me

¹¹ Ajo vendos në pikëpyetje Kejnsonianizmin dhe i jep një vend thelbësor parimeve neoklasike të racionalitetit të agjentëve, neutralitetit të parasë dhe ekuilibrit të përhershëm të ofertës dhe kërkesës në tregje.

përmasa të mëdha. Treguesit e përdorur për të gjykuar ecurinë e ekonomisë dukshëm nuk janë të mjaftueshëm për të kuptuar natyrën e situatës, e cila mbi të gjitha karakterizohet nga një heterogjenitet i fortë.

Është e qartë se sistemi aktual ekonomik është përballur pra me një krizë të rritjes së ulët dhe kuazi-stagnimi të pagave, e cila nga ana e ofertës vjen nga revolucioni i informacionit dhe komunikimit, i cili po shkakton rënien e produktivitetit të kapitalit. “Zgjidhja” duket se është, së pari, rritja e pushtetit monopol dhe së dyti duke implementuar reforma neoliberales që synojnë uljen e pagave direkte dhe indirekte për të ruajtur një normë të kënaqshme fitimi (Pereira, 2019). Nga ana e kërkesës, stagnimi i pagave është një problem, jo një zgjidhje. Politikat Kejnsoniane mbeten themelore për zgjidhjen e problemit të kapitalit të tepërt në kohë krize ekonomike.

Këto dështime të ekonomisë së tregut ndonjëherë i shtyjnë autoritetet të miratojnë politika agresive, të tilla si një program stimulues fiskal. Kjo është arsyeja pse Kejnsonianët favorizojnë një ekonomi mikse, të udhëhequr kryesisht nga sektori privat, por pjesërisht të menaxhuar nga shteti. Hipoteza kryesore e diskutuar në këtë artikull është se në situatën aktuale ekonomike (rritje e ulët ekonomike, rritje e papunësisë, kërkesë e ulët për investime) dhe krizave të njëpasnjëshme në të cilën po përballen vendet perëndimore, ndërhyrja e shtetit mbi kërkesën efektive (të parashikuar) shihet si instrumenti kryesor i rimëkëmbjes ekonomike dhe zbutjes së papunësisë.

2. Kuadri teorik

Hulumtimet e fundit tregojnë se normat e interesit me rrezik zero kanë rënë gjatë dy dekadave të fundit, duke gjetur përgjigje me implikime të rëndësishme për ekonominë dhe kthimet që investitorët e tregut të aksioneve mund të presin në vitet në vijim (Kopecky & Taylor, 2020). Artikulli i tyre referohet kapitullit të fundit të librit të John Maynard Keynes të botuar në 1936, “Teoria e Përgjithshme e Punësimit, Interesit dhe Parasë”, të titulluar eutanazia e rentierit, i cili postulon se kur normat e larta të interesit të mos ekzistojnë më, aplikimi masiv i politikave monetare ekspansioniste do të sigurojë që klasa e mesme e kompanive të zhduket gradualisht dhe në mënyrë diskrete. Sipas këtyre autorëve, duket se kjo kohë ka ardhur. Çdo shpresë për të ardhura domethënëse nga depozitat bankare ose obligacionet e qeverisë ishte zbehur edhe përpara krizave aktuale sanitare dhe energjitike. Studime të tjera tregojnë gjithashtu se aplikimi i standardeve të interesit zero ose negativ ngre frikën e zhdukjes së efektivitetit të politikës monetare “konvencionale” bazuar kryesisht në vendosjen e një norme bazë. Në një kontekst ku norma efektive e inflacionit dhe norma e interesit e ekuilibrit të punësimit të plotë janë negative, dinamika makroekonomike mund të konvergojë në trajektore të nënpunësimit të përhershëm që është sinonim me “stagnimin laik” (Bergeaud et al., 2017).

Kriza aktuale ekonomike tregon se në mungesë të politikave të kompensimit, ekonomitë e zhvilluara industriale janë subjekt i stagnimit laik. Kjo ngre pyetje të thella në lidhje me politikën e ardhshme të stabilitetit makroekonomik. Arritja e niveleve të deficiteve dhe borxhit publik që përgjithësisht konsiderohen të dëshirueshme, ka të ngjarë të nënkuptojë norma reale neutrale negative në botën industriale perëndimore. Në vazhdim, politikëbërësit do të duhet të angazhohen në një kombinim të rritjes së tolerancës për deficitet fiskale, politikave monetare jokonvencionale dhe masave strukturore për të nxitur investimet private dhe për të absorbuar kursimet private nëse do të ruhet punësimi i plotë dhe duhet të përmbushen objektivat e inflacionit (Summers & Rachel, 2019). Prej 10 vitesh, ekonomia e vendeve perëndimore po

përballet me një rritje të dobët, e cila duket se pothuajse po hyn, sipas përkufizimit të Hansen (1939) të marrë nga Summers (2018), në një “stagnim laik” (Gordon, 2015). Në vitin 2013, pas recesionit të madh të vitit 2008, ekonomisti Lawrence Summers bëri një vëzhgim të ngjashëm për ekonominë amerikane me atë të Hansen në vitet 1930: për shkak të kërkesës së pamjaftueshme, ekonomia po përpiqet të arrijë një ekuilibër të karakterizuar nga rritje e ulët, inflacion i ulët, burimet e alokuara (produktiviteti i ulët) dhe papunësi e lartë.

Në vitet 1930, Hansen (1939) identifikoi si faktorë mbylljen e kufijve, ngadalësimin e inovacionit teknologjik dhe mbi të gjitha, një rënie të konsiderueshme të rritjes së popullsisë. Nga ana tjetër, për Haskel & Westlake (2017), kërkesa e dobët për investime dhe rritja e dobët e produktivitetit mund të shpjegohen me rritjen e peshës së aktiveve jo-materiale në ekonominë reale. Gjithashtu, revolucioni i katërt industrial (Schwab, 2017) dhe kriza sanitare COVID-19 (Schwab & Malleret, 2020) kanë ndikuar shumë në strukturën e prodhimit industrial dhe veçanërisht në tregun e punës për shkak të produktivitetit të ulët të këtij të fundit. Në të vërtetë, kriza e koronavirusit nuk klasifikohet si një goditje e ofertës ose kërkesës (Cochrane, 2020). Nëse situata ekonomike është në këto kushte, Summers (2018) mbron idenë e reagimit me një politikë fiskale duke nxitur investimet publike në veçanti për të mbështetur kërkesën. Në fakt, kërkesa e dobët për investime si dhe rritja e dobët e produktivitetit mund të shpjegohen me rritjen e peshës së aktiveve jo-materiale në ekonominë reale. Bazuar në hipotezën tonë fillestare, pyetja kërkimore e këtij artikulli është: Cili është rikonfigurimi makroekonomik aktual dhe cili do të jetë roli i shtetit si eliminues i dështimeve të tregut në këtë model ekonomik?

3. Qasja metodologjike

Metodologjia e kërkimit ndjek një logjikë të mbledhjes dhe modelimit të të dhënave sasiore dhe cilësore duke u përpjekur të zhvillojë skenarë makroekonomikë të së ardhmes. Metoda jonë ndjek tre hapa: 1) Kërkim bibliografik mbi krizën sanitaro-ekonomike për vendet perëndimore; 2) Mbledhja e të dhënave makroekonomike për tregues të tillë si Produkti i Brendshëm Bruto (PBB), norma e inflacionit, norma e papunësisë, norma e interesit të Bankës Qendrore Europiane (BQE); shpenzimet publike; investimet dhe punësimi 3) Analiza e rezultateve dhe diskutimi. Metoda që ne përdorim është një metodë statistikore që analizon seritë kohore për treguesit makroekonomikë të përfshirë në llogaritjen e PBB-së. Bazuar në metodat e llogaritjes së PBB-së, ne kemi analizuar komponentët e metodës së shpenzimeve. Kjo metodë bazohet në konceptin e kërkesës agregate, e cila i referohet shumës së shpenzimeve të bëra nga njerëz dhe organizata të ndryshme në të njëjtin territor për të blerë mallra dhe shërbime me çmimet e tregut. Formula e tij e llogaritjes është si më poshtë:

$$\text{PBB} = C + I + G + (X - M)$$

- C,** Konsumi: shpenzime të bëra nga familjet për qëllime jofitimprurëse ose fitimprurëse.
- I,** Investim: shpenzime të bëra nga njerëzit me qëllim të gjenerimit të fitimeve.
- G,** Shpenzimet qeveritare: shuma e të gjitha shpenzimeve të administratës publike.
- X,** Eksportet: të gjitha produktet ose shërbimet e shitura jashtë vendit.
- M,** Importet: të gjitha mallrat ose shërbimet që blihen jashtë vendit.


Për të testuar hipotezën tonë, ne u fokusuar vetëm në I (investime) dhe G (shpenzime qeveritare) duke analizuar as C (konsumin) dhe as eksportet neto (X - M). Ideja është që të shikohet evolucioni i këtyre treguesve në lidhje me PBB-në duke kryqëzuar dhe/ose krahasuar të dhënat nga seritë statistikore. Tregues të tjerë që tregojnë se teoria neoliberalë nuk shpjegon dot situatën aktuale janë ndikimi i normave të interesit në investime, marrëdhënia midis kursimeve dhe investimeve, evolucioni i prodhimit industrial dhe produktivitetit të punës, evolucioni i ofertës së punës dhe të ardhurat e punonjësve në sektorin publik dhe privat. Si burim të dhënash, ne përgjithësisht jemi mbështetur në EUROSTAT, OECD, BQE-së dhe databazën e Tradingeconomics, për një periudhë njëzetvjeçare, pra 1999-2021, periudhë kur kemi futjen e euros në ekonominë e eurozonës.

4. Gjetjet kryesore

4.1 Një ndikim pothuajse zero i politikës monetare të BQE-së

Duke korreluar seritë kohore të rritjes ekonomike ose PBB-së reale, për periudhën 1999-2021, me normat e interesit të BQE-së, konstatojmë se deri në vitin 2007 ka një rritje mesatare vjetore ekonomike prej 2 %, ndërsa norma e interesit ulet nga viti 2000 deri në vitin 2004 nga 4.75% në 2%, dhe rritet përsëri deri në vitin 2007, në 4.25% (Figura 1).

Figura 1. Ndryshimi në përqindje i normës vjetore të rritjes së PBB-së reale, 1999-2021




Shënim: Në grafik përfshihet Kina, SHBA dhe mesatarja e 19 vendeve të Eurozonës. Përpunuar nga autorët mbi bazën e të dhënave zyrtare të OECD (2022)

Prandaj, ne shohim se rritja ekonomike është pothuajse e pavarur nga norma e interesit. Gjatë këtyre dy dekadave, kemi pasur kriza të njëpasnjëshme, si ajo financiare e viteve 2007-2008, sanitare COVID-19 si dhe kriza gjeopolitike ruso-ukrainase, të cilat kanë destabilizuar ekonominë botërore. Në të parën ishte e nevojshme ndërhyrja e BQE-së me normën e saj të rifinancimit ose normën bazë, ndërsa për atë sanitare vërejtëm ndërhyrje të fuqishme të qeverive. Pavarësisht një politike monetare, konvencionale para krizës, dhe lehtësimit sasior jokonvencional, pas krizës së vitit 2008 kjo rritje është pothuajse konstante kur normat e interesit nga viti 2009 e deri më sot janë ulur me 1% në 0%.

Ndërhyrja e BQE-së duke ulur normën bazë në 0% duket se nuk ka funksionuar. Oferta monetare e derdhur në tregje nuk pati asnjë ndikim në këtë rritje ekonomike. Duket se tregjet

nuk po gjejnë ekuilibrin e tyre më të mirë makroekonomik dhe se teoria neoliberales nuk funksionon më.

Figura 2. Lidhja midis normës reale të rritjes së PBB-së dhe normës së interesit të BQE-së, 1999-2021




Shënim. Përpunuar nga autorët mbi bazën e të dhënave zyrtare të EUROSTAT dhe OECD (2022)

4.2 Kërkesa e pamjaftueshme efektive

Duke përdorur metodën e shpenzimeve, sipas të dhënave të EUROSTAT të vitit 2022, konstatojmë se shpenzimet e konsumit të familjeve dhe individëve (C) përbëjnë në përqindje pjesën më të madhe të PBB-së me një mesatare vjetore prej 55%, shpenzimet për investime (I, Formimi Bruto i Kapitalit Fiks) që zënë një mesatare vjetore prej 22%, shpenzimet qeveritare (G), arrijnë të njëjtat shifra përqindjeje si dhe investimet me një mesatare pothuajse 21%, por që pas krizës së 2008, ky shpenzim është rritur me 2% më shumë (Figura 3). Megjithatë, komponenti i fundit, bilanci i jashtëm i mallrave dhe shërbimeve, zë një përqindje shumë të ulët me një mesatare vjetore prej 3% të shitjeve pozitive.

Figura 3. Ndryshimi në përqindje të komponenteve përbërës të PBB për periudhën 1999-2021 në Zonën Euro




Shënim: Përpunuar nga autorët mbi bazën e të dhënave zyrtare të OECD (2022)

Bazuar në të dhënat e OECD-së të vitit 2022, shpenzimet konsumatore fillojnë të bien me 4% nga viti 2012 deri në vitin 2021. Kjo prijë rënësë në kërkesën efektive të konsumatorit shpjegohet edhe me një normë shumë të lartë mesatare vjetore të rritjes së dobët të Bashkimit

European. Për periudhën 1999-2021 rezulton të jetë vetëm 0.2% në vit. Kjo prirje rënëse e popullsisë dobëson gjithashtu kërkesën efektive, gjë që forcon teorinë e Hansen (1939). Për të analizuar më mirë këtë pyetje, ne kemi kombinuar shkallën vjetore të punësimit si përqindje e fuqisë punëtore dhe orët mesatare vjetore të përdorura nga punonjësit e burimeve njerëzore (Figura 4).


Figura 4. Ndryshimi në përqindje i kohëzgjatjes mesatare vjetore dhe normës së punësimit për Eurozonën, 1999-2021 (majtas)



Shënim: Përpunuar nga autorët mbi bazën e të dhënave zyrtare të OECD (2022)

Ky kombinim është një tregues i mirë për të parë se si po ndryshon dinamika e punësimit në eurozonë. Vërejmë se korrelacioni ndërmjet këtyre dy variablave është më i madh se 0.50. Koeficienti i përcaktimit (R^2) është 56%, që do të thotë se ekziston një marrëdhënie e moderuar midis këtyre dy variablave siç tregohet në Figurën 5.

Figura 5. Lidhja ndërmjet kohëzgjatjes mesatare vjetore dhe normës së papunësisë për Eurozonën, 1999-2021



Shënim. Përpunuar nga autorët mbi bazën e të dhënave zyrtare të OECD (2022)

Por nëse marrim parasysh normën e rritjes së përqindjes vjetore të popullsisë aktive, e cila sipas të dhënave të OECD-së në vitin 2022, ka tentuar drejt 0% në dhjetë vitet e fundit, shohim se kjo rritje e përqindjes së punësimit është thjesht artificiale sepse nga ana tjetër ka një ulje të kohës mesatare vjetore të punës.

Figura 6 tregon përqindjen e punësimit sipas sektorëve. Sektori tregtar përfaqëson më shumë se 60% të të punësuarve dhe që nga viti 2009 ka filluar të rritet, ndërsa sektorë të tjerë si industria dhe prodhimi zënë një mesatare vjetore përkatësisht 21% dhe 14%. Sektori i bujqësisë ka një peshë shumë të ulët. Ai punëson mesatarisht vetëm 3% të forcës aktive në vit.


Figura 6. Ndryshimi në përqindje i punësimit sipas industrisë për Eurozonën, 1999-2020



Shënim. Përpunuar nga autorët mbi bazën e të dhënave zyrtare të OECD (2022)

Pastaj kemi shpenzime për investime (I, Formimi Bruto i Kapitalit Fiks) të cilat zënë një mesatare vjetore prej 22%. Ky komponent i rëndësishëm rritet nga viti 1999 në 2007 nga 22.9% në 24% dhe fillon të bjerë në 22% në vitin 2021. Mesatarisht në vit për periudhën 1999-2021 kemi 58% të këtyre investimeve që shkojnë për kompanitë (Korporatat), 28% janë bërë nga familjet dhe 14% janë bërë nga qeveritë e Eurozonës. Kështu, vërehet një ngadalësim i këtyre investimeve, veçanërisht për individët dhe qeveritë (Figura 7).

Figura 7. Evolucionin në përqindje i shpërndarjes së investimeve I (Formimit Bruto të Kapitalit Fiks) sipas 5 grupeve, 1999-2021




Shënim. Përpunuar nga autorët mbi bazën e të dhënave zyrtare të OECD (2022)

Krahas sektorit të ekonomive familjare dhe shtetërore, konstatojmë se një pjesë e mirë e këtij investimi shkon në klasa asetesh si strehimi, teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK), ndërtesat dhe punimet e inxhinierisë civile, pajisje transporti, burime biologjike të kultivuara dhe produkte të pronësisë intelektuale. Në të vërtetë, ka një tendencë në rritje për klasat e asetëve të TIK-ut dhe produktet e pronësisë intelektuale prej 7% dhe 6% respektivisht që nga viti 1999.

Situata e re ekonomike para dhe pas krizave të njëpasnjëshme duket të jetë stopimi i kërkesës agregate nga agjentët ekonomikë (Figura 8). Kjo mosvazhdimësi mes modelit klasik

ekonomik të bazuar në rritje dhe ndërhyrjes së fortë të shtetit në treg dëshmohej edhe nga raporti mesatar borxh/suficit operativ bruto (EBITDA¹²) i sektorit privat, i cili është 4 herë më i lartë se EBITDA e tij vjetore. Kjo do të thotë se aftësia paguese e shoqërive jofinanciare kërcënohet sepse në përgjithësi, një raport më i madh se 2.5 herë konsiderohet i lartë. Ndërsa ne kemi borxh të sektorit privat, që janë detyrimet e papaguara të sektorëve të korporatave jofinanciare, familjarëve dhe institucioneve jofitimprurëse në shërbim të familjeve. Deri në vitin 2009, ka një rritje të këtij borxhi me 63% duke shkuar nga 104% në 167%. Më pas bie me 10% për të arritur në 150% në vitin 2020. Rritje të këtij borxhi në raport me PBB-në, kanë edhe qeveritë e eurozonës. Për këtë periudhë, sipas të dhënave të EUROSTAT-it, ato pësuan një rritje prej afro 30%, duke u rritur nga 71.6% në 97.7%.

Figura 8. Lidhjet ndërmjet borxhit të sektorit privat (% e PBB-së) dhe raportit borxh ndaj suficitit të firmave jo financiare, 1999-2021



Shënim. Përpunuar nga autorët mbi bazën e të dhënave zyrtare të EUROSTAT (2022)

5. Diskutim

De Nicolò et al., (2012) argumentojnë se burime të rëndësishme të dështimeve të tregut në sektorin financiar janë eksternalitetet e rrezikut nëpër institucionet financiare si dhe ndërmjet sektorit financiar dhe ekonomisë reale. Sipas tyre, të tilla eksternalitete nxiten nga 1) komplementaritetet strategjike: ndërveprimet strategjike të institucioneve financiare që shkaktojnë akumulimin e dobësive gjatë fazës së zgjerimit të një cikli financiar; 2) shitjet masive: shitja e përgjithësuar e aktiveve financiare që shkakton një rënie të çmimeve të aktiveve dhe një përkeqësim të bilanceve të ndërmjetësve; dhe 3) ndërvarësia: rreziku i infektimit të shkaktuar nga përhapja e goditjeve nga institucionet sistemike ose përmes rrjeteve financiare. Gjetja kryesore e analizës së tyre është se ekzistojnë mjete të shumta politike në dispozicion për të adresuar çdo eksternalitet. Për shembull, kufizimet në shpërndarjen e aktiveve bankare dhe kërkesat për kapital mund të zvogëlojnë efektet e jashtme të shkaktuara nga komplementaritetet strategjike të bankave. Kërkesat për kapital inkurajojnë bankat të thithin më shumë nga kostot që lidhen me huadhënien me rrezik. Kufizimet e shpërndarjes së aktiveve i ndalojnë bankat të marrin ekspozime të rëndësishme ndaj rrezikut.

¹² Earnings Before Interest, Taxes, Depreciation, and Amortization

Destabilizimi ekonomik për shkak të krizave të njëpasnjëshme, përforcon idenë se gjithnjë e më shumë qytetarë perëndimorë kuptojnë ndërhyrjen e nevojshme të shtetit për të përcaktuar dhe zhvilluar akset strategjike për të ardhmen (teknologjitë e informimit, energjitë e rinovueshme, etj.). Siç theksojnë studime të tjera, kriza aktuale sanitare dhe transformimi i kapitalizmit global po çon në një situatë të re të borxhit të lartë publik dhe privat dhe normave shumë të ulëta të interesit (Ragot, 2021; Palley, 2019). Sipas rezultateve tona, dallojmë se investimet, si në kompani private ashtu edhe në familje, janë ulur për shkak të borxhit të lartë të këtyre dy aktorëve ekonomikë, të cilët nuk mund të marrin hua për mungesë kolaterali. E vetmja mënyrë që kompanitë private të mbijetojnë ose të rrisin fitimet e tyre është të rrisin performancën e tyre duke rritur produktivitetin dhe duke minimizuar kostot. Kështu, duke zëvendësuar faktorin e punës (uljen e kostos) me faktorin kapital, kjo rezulton në një rritje të raportit kapital/punë ku puna zëvendësohet nga robotizimi dhe automatizimi. Rritja eksponenciale e borxhit privat dhe mungesa e garancive kanë reduktuar huamarrjen (siç vërejmë trendin e borxhit privat gjatë dhjetë viteve të fundit) edhe pse BQE-ja ka disa vite që e ka ulur këtë normë në zero.

Bankat e nivelit të dytë (BND) gjithashtu kanë një sasi të konsiderueshme likuiditeti për depozitat (depozitat që i shtohen BND-ve brenda 10 anuiteteve) dhe normat e interesit të tyre janë rreth 0%. Prandaj, kursimet (S) nuk shkojnë më në investime (I) dhe për rrjedhojë ka një tendencë rritëse të depozitave dhe një prirje rënëse në investimet private. Këtij problemi i shtohet kriza sanitare dhe lufta ruso-ukrainase, të cilat ndikojnë në sjelljen njohëse të sipërmarrësve dhe konsumatorëve, edhe pse kjo hipotezë mbetet për t'u verifikuar. Paratë janë në BND-të në dy forma: depozita dhe kapital bankar, të cilat deri më tani janë siguruar me kosto të ulët nga BQE-ja. Pra, mbetet të shkojmë drejt teorisë së Summers dhe Rachel (2019). Nëse duam që ekonomia të rritet dhe të mbajë punësimin e plotë, ne duhet të stimulojmë kërkesën agregate duke kombinuar teorinë e Milton Friedman dhe teorinë neokejnesiane (Galí, 2018; Kotarski, 2018). Pra, duke marrë masa strukturore në mënyrë që kursimet (S) në BND-të të mund të kanalizohen në investime private (I) dhe konsum (C), me një kombinim të politikës monetare jokonvencionale për të stimuluar (G) dhe (S). Objektivi kryesor i sektorit privat është të maksimizojë fitimin. Për t'a bërë këtë, ai duhet të rrisë produktivitetin duke investuar në kapital (I) dhe duke minimizuar koston e punës, e cila përkthehet në një ulje të faturës së pagave të punonjësve që punojnë në sektorin privat. Zëvendësimi i punës nga kapitali sjell një reduktim të konsumit (C) i cili duhet të mbulohet, pjesërisht nga kursimet (S) dhe pjesërisht nga ndërhyrja e qeverisë. Fenomeni tjetër pas kësaj situatë është rritja e papunësisë për shkak të konkurrencës me inteligjencën artificiale.

6. Përfundime

Eksperiencia e krizave të njëpasnjëshme dhe rikonfigurimi i politikave publike në nivel ekonomik tregojnë se planet për mbrojtjen e ekonomisë, duke ofruar mundësinë e shtyrjes së shlyerjes së kredive dhe taksave, për marrjen e një pjese të koston së punësimit apo sigurimeve shoqërore nga buxheti qendror dhe për dhënie të ndihmës shtetërore, paraqiten si modele nga qeveritë e shumë vendeve. Kriza shëndetësore dhe ndryshimi i paradigmës ekonomike kushtëzojnë një kërkesë të re globale të orientuar drejt investimit (I) në kualifikimin e lartë intelektual të kapitalit njerëzor. Aktualisht, kompania private po dixhitalizon njëkohësisht aktivitetin e saj dhe për këtë arsye ka nevojë për kapital njerëzor të kualifikuar në teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK). Ky investim do të mbulohet nga njëra anë nga

kursimet dhe nga ana tjetër nga ndërhyrja e shtetit nëpërmjet politikave mbështetëse të punësimit. Pandemia dhe lufta kanë çuar gjithashtu në rritjen e shpenzimeve për shëndetin dhe sigurinë publike, ashtu si pas Luftës së Dytë Botërore. Përdorimi i një politike monetare jokonvencionale për të mbuluar shpenzimet publike gjatë shlyerjes së borxhit publik do të ishte një instrument i përshtatshëm për të stimuluar kërkesën agregate, e cila mund të çojë në një revolucion të ri globalist Kejnsian duke ringjallur përsëri idenë e një shteti paternalist që rregullon dështimet e tregjeve.

Literatura

- Bergeaud, A., Cette, G. & Lecat, R. (2017). Croissance de long terme et tendances de la productivité: Stagnation séculaire ou simple trou d'air ? *Revue de l'OFCE*, 153, pp. 43-62. <https://doi.org/10.3917/reof.153.0043>
- Cochrane, J. H. (2020). 12 Coronavirus monetary policy. *Economics in the Time of COVID-19*, pp. 105.
- De Nicoló, M. G., Favara, G., & Ratnovski, M. L. (2012). *Externalities and macroprudential policy*. International Monetary Fund.
- Gaffard, J. (2014). Crise de la théorie et crise de la politique économique: Des modèles d'équilibre général stochastique aux modèles de dynamique hors de l'équilibre. *Revue économique*, 65, pp. 71-96. <https://doi.org/10.3917/reco.651.0071>
- Galí, J. (2018). The state of New Keynesian economics: a partial assessment. *Journal of Economic Perspectives*, Vol. 32. No. 3, pp. 87-112. <https://doi.org/10.1257/jep.32.3.87>
- Gordon, R. J. (2015). Secular stagnation: A supply-side view. *American Economic Review*, Vol. 105, No. 5, pp. 54-59. <https://doi.org/10.1257/aer.p20151102>
- Hansen, A. H. (1939). Economic progress and declining population growth. *The American Economic Review*, Vol. 29, No. 1, pp. 1-15.
- Haskel, J., & Westlake, S. (2017). *Capitalism without capital*. Princeton University Press. <https://doi.org/10.1515/9781400888320>
- Kopecky, J., & Taylor, A. M. (2020). The murder-suicide of the rentier: Population aging and the risk premium (No. w26943). National Bureau of Economic Research.
- Kotarski, K. (2018). The Eurozone's Crisis Conundrum and the Role of Macroeconomic Theory. *World Review of Political Economy*, Vol. 9, No. 4, pp. 477-506. <https://doi.org/10.13169/worlrevipoliecon.9.4.0477>
- Palley, T. I. (2019). The fallacy of the natural rate of interest and zero lower bound economics: why negative interest rates may not remedy Keynesian unemployment. *Review of Keynesian Economics*, Vol. 7. No. 2, pp. 151-170. <https://doi.org/10.4337/roke.2019.02.03>
- Pereira, L. (2019). Secular stagnation, low growth, and financial instability. *International Journal of Political Economy*, Vol. 48. No. 1, pp. 21-40. <https://doi.org/10.1080/08911916.2018.1550949>

- Ragot, X. (2021). Plus ou moins de dette publique en France? *Revue de l'OFCE*, (84).
- Sargent, T. J. (2022). Learning from Lucas. *Journal of Economic Methodology*, Vol. 29, No. 1, pg. 17-29. <https://doi.org/10.1080/1350178X.2021.1993307>
- Schwab, K., & Malleret, T. (2020). COVID-19: The Great Reset. Forum Publishing. ISBN: 978-2-940631-11-7
- Schwab, K. (2017). The fourth industrial revolution. Geneva, Portfolio Penguin.
- Summers, L. H., & Rachel, L. (2019). On falling neutral real rates, fiscal policy and the risk of secular stagnation. In *Brookings Papers on Economic Activity BPEA Conference Drafts*, March. Vol. 7, 66 pp.
- Summers, L. H. (2016). 2014: Us Economic Prospects: Secular Stagnation, Hysteresis, and the Zero Lower Bound. In *The Best of Business Economics* (pp. 421-435). New York, Palgrave Macmillan. https://doi.org/10.1007/978-1-137-57251-6_38
- Summers, L. H. (2018). Secular stagnation and macroeconomic policy. *IMF Economic Review*, Vol. 66. No. 2, pp. 226-250. <https://doi.org/10.1057/s41308-018-0056-6>

Vështrim teorik mbi metodat e reja në menaxhimin e projekteve

Ira Gjika^{a,13}

^a *Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, Tiranë*

Përmbledhja

Praktika e përditshme e bizneseve, institucioneve dhe individëve tregon se realizimi i punëve në formën e projekteve po shtohet në çdo fushë. Avantazhet që sjell kjo mënyrë e organizimit dhe dobishmëria e mjeteve dhe teknikave që përdor e kanë vendosur menaxhimin e projekteve në vëmendje të studjuesve dhe profesionistëve të fushës. Provohet që menaxhimi efektiv është vendimtar për arritjen e objektivave dhe përmbylljen me sukses të projekteve nga ana e organizatave. Shumëllojshmëria dhe diversiteti i projekteve kanë nxitur përpjekjet për të gjetur metodat e menaxhimit më të përshtatshme sipas llojeve të projekteve. Njohja e metodave të menaxhimit në këndvështrimin e zhvillimit historik të tyre mundëson evidentimin e situatave kur ato mund të përdoren duke përfituar nga avantazhet që ofrojnë. Këtij qëllimi i shërben ky punim, i cili paraqet metodat kryesore të menaxhimit të projekteve në ditët e sotme. Punimi synon të kontribuojë në pasurimin e literaturës në gjuhën shqipe për organizatat dhe prakticienët e angazhuar në projekte, duke ofruar një bazë teorike mbi metodat tradicionale dhe bashkëkohore të menaxhimit të projekteve.

Fjalët kyç: Menaxhim i projekteve; metoda të menaxhimit; cikli i jetës së projektit; teknologji e informacionit; metoda Agile

Abstract

The daily practice of businesses, institutions, and individuals shows that the realization of works as projects is increasing in all sectors. The advantages brought by this form of organization and the utility of tools and techniques used have placed project management in the attention of researchers and professionals in the field. It is proven that effective management is crucial for achieving the objectives and successful completion of projects by organizations. The variety and diversity of projects have stimulated efforts to find the most suitable management methods according to the types of projects. Recognition of the management methods from the perspective of their historical development enables the identification of situations when they can be used to profit from the advantages they offer. This paper presents the main current methods of project management. The paper aims to contribute to the enrichment of literature in the Albanian language for organizations and practitioners engaged in projects, providing a theoretical basis for traditional and present-day methods of project management.

Keywords: Project management; management methods; project life cycle; information technology; Agile method.

¹³ Kontakt: ira.gjika@umsh.edu.al

1. Hyrje

Historia e projekteve dhe menaxhimit të tyre daton që nga ndërtimi i piramidave të Egjiptit, Murit të madh Kinez, apo Ujësjellësve Romanë (Aqueduct) (Haughey, 2014). Rezultatet e këtyre projekteve ishin fryt i zbatimit të praktikave, parimeve, proceseve, mjeteve dhe teknikave të menaxhimit të projekteve nga drejtuesit dhe menaxherët në punën e tyre (PMBOK6, 2017).

Menaxhimi i projektit, si praktikë dhe si profesion, është ndikuar shumë nga zhvillimet në industrinë e ndërtimit dhe infrastrukturë. Në fillim, menaxhimi i projektit ishte i lidhur ngushtë me industrinë e ndërtimit dhe mbrojtjen (Wysocki, 2019). Duke e parë menaxhimin modern të projekteve si një qasje për të zgjidhur detyra komplekse, në afate të kufizuara kohe dhe me buxhet të përcaktuar mund të thuhet se menaxhimi i projekteve ishte një teknologji e re në vitet 1950-të me një potencial premtues, por zbatim të kufizuar. Në vitet 1960-të deri 1980-të përparoi shpejt duke ofruar një avantazh të ndjeshëm konkurrues, në vecanti në industrinë e aeronautikës dhe të hapësirës, industrinë e mbrojtjes dhe për projekte të infrastrukturës, por edhe për zhvillimin e produkteve të reja komplekse (Abasi & Jaafari, 2018). Situata është e ndryshme sot dhe menaxhimi i projekteve përfshin të gjitha industritë nga prodhimi, sistemet e informacionit, projektimi, financa, shërbimet, artet, media dhe fusha sociale (Westland, 2018).

Përhapja kaq e gjerë e ka bërë menaxhimin e projekteve një teknologji kyç (Kabeyi, 2018), që duhet ta njohin dhe të mund ta aplikojnë të gjithë drejtuesit dhe është pjesë e programeve të formimit në fushën e menaxhimit dhe lidershit.

2. Qëllimi dhe metodologjia

Projektet janë aktualisht pjesë e çdo sektori edhe në Shqipëri, që nga ndërtimi e infrastruktura, në industritë prodhuese dhe shërbimet, në aktivitetet artistike dhe në arsim në të gjitha nivelet, në shëndetësi, në pushtetin qendror e lokal dhe fusha të tjera (EUhub, AIDA, AKKSHI, ADF). Shumëllojshmëria e projekteve dhe shtrirja e tyre në shumë sektorë është shoqëruar me shtimin e rrethanave favorizuese, por edhe të sfidave me të cilat duhet të përballen menaxhimi i projekteve. Kjo sjell në vëmendje nevojën për më shumë njohuri në fushën e menaxhimit të projekteve për të gjithë institucionet, bizneset apo individët që përfshihen në projekte.

Literatura mbi menaxhimin e projekteve në gjuhën shqipe është e kufizuar dhe kryesisht e orientuar për qëllime mësimdhënieje në arsimin e lartë (Panariti, 2013), (Beqiri, 2015) ose në formën e udhëzuesve për aplikantët në projekte. Për më tepër, literatura ekzistuese nuk trajton metodat dhe qasjet më të reja që teoria dhe praktika e menaxhimit të projekteve ka evidentuar së fundmi.

Qëllimi i këtij punimi është të paraqesë metodat dhe modelet e menaxhimit të projekteve që përdoren në praktikën botërore dhe si përshtaten ato në varësi nga karakteristikat e projekteve. Zgjedhja dhe zbatimi i metodës më të përshtatshme kontribuon në arritjen e objektivave dhe rezultateve të pritshme të projekteve që realizohen edhe në mjedisin shqiptar.

Metodologjia për përgatitjen e këtij materiali është realizuar një studim me natyrë eksploruese dhe përshkruese, me objektiva:

- Të identifikojë metodat e menaxhimit të projekteve dhe karakteristikat e tyre, në veçanti për metodën Agile,

- Të parashtrijë ndryshimet ndërmjet metodave dhe
- Të evidentojë situatat e projekteve në të cilat këto metoda janë më të përshtatshme për t'u zbatuar.

Për të arritur objektivat e studimit është ndjekur metoda cilësore e hulumtimit, përmes kërkimit sistematik në literaturën e fushës së menaxhimit të projekteve. Kërkimi në literaturë ka përfshirë libra, tekste universitare, manuale dhe artikuj në revista shkencore të fushës së menaxhimit të projekteve. Në kushtet kur menaxhimi i projekteve po shndërrohet në një profesion, organizatat dhe institucionet që ofrojnë kualifikim dhe certifikime të njohura ndërkombëtarisht janë kontribues të rëndësishëm në pasurimin e literaturës së fushës. Vend të veçantë në këtë kërkim zenë edhe botimet dhe raportet e vëzhgimeve nga ana e këtyre njësive (PMI, PM, IAPM).

Kërkimi është përqëndruar në mënyrat se si menaxhohet cikli i jetës së projektit dhe është orientuar nga termat metodë, metodologji, qasje, model, filozofi. Sipas PMI (PMBOK7, 2021) meqë menaxhimi i projekteve është në evoluim, edhe terminologjia që përdoret vazhdon të ndryshojë. Megjithë avancimin e konsiderueshëm dhe unifikimin e shumë koncepteve brenda korpusit të dijes (Body of Knowledge) së menaxhimit të projekteve, një numër termash përdoren në mënyrë të ndërsjellë nga studjuesit dhe profesionistët e fushës.

Shqyrtimi i literaturës sjell në punim një paraqitje të strukturuar dhe njohuri mbi çështjet kryesore objekt i studimit, sipas autorëve dhe vëzhgimeve më të fundit. Faktorë kryesorë që kanë nxitur këtë studim janë nevoja për të plotësuar mungesat në literaturën në gjuhën shqipe dhe dëshira për të qartësuar se si njohuri të ndryshme, ndonjëherë edhe kontradiktore, mund të përdoren për zgjedhjen e metodës së menaxhimit më të përshtatshme për projektet që ndërmarrin organizatat.

Trajtimi vetëm në aspektin teorik i metodave të menaxhimit të projekteve, pa përfshirë masën e njohjes dhe përdorimit të tyre në Shqipëri, përbën një nga kufizimet e punimit. Kërkimi empirik në këtë drejtim mbetet i hapur për punë të ardhshme, ashtu si edhe çështje të tjera të përzgjedhjes së projekteve, menaxhimit të grupit të projektit apo të matjes së suksesit të projekteve në mjedisin shqiptar.

3. Metodatat e menaxhimit të ciklit të jetës së projekteve

3.1 Kuadri historik

Menaxhimi i projekteve konsiderohet si një nga disiplinat më të ndryshueshme në shkencat e menaxhimit gjatë viteve të fundit (Kabeyi, 2018). Vetëm pasi disiplina e menaxhimit të projektit u njoh si e tillë, studjuesit u thelluan në vëzhgime për të identifikuar zhvillimet historike dhe ngjarjet që kontribuan në zhvillimin e tij, si krijimi i grafikut Gantt (1915), krijimi i PMI (1969), apo hartimi i Manifestit Agile (2001). Përgjatë viteve, menaxhimi i projekteve është zhvilluar nga një qasje e thjeshtë e bazuar kryesisht në teknika, në një grup shumë-disiplinor mjetesh, teknikash dhe procesesh të krijuara për t'iu përshtatur të gjitha llojeve të situatave.

Tendencat kryesore të avancimit në menaxhimin e projekteve lidhen me gjerësinë e shtrirjes dhe përmirësimin e zbatimit të menaxhimit të projekteve në praktikë (Gemunden & Schoper, 2014). Detyrat më të cilat duhet të përballet menaxhimi i projekteve po bëhen shumë

komplekse. Kjo është rrjedhojë e tendencës së mega-globalizimit dhe urbanizimit, si dhe sistemeve teknologjike komplekse. “Mega projektet” po bëhen më të mëdhenj në vlerë dhe më të shumtë në numër (Flyvbjerg, 2014), (Flyvbjerg & Turner, 2017), (Schuster, 2018). Shumë nga këta mega-projekte dështojnë, prej nga lind pyetja se si mund të përmirësohet menaxhimi i tyre dhe se si duhet trajtuar kompleksiteti i tyre.

Në shekullin 21 studjuesit identifikojnë një tendencë të “projektizimit”, duke theksuar se prodhimi i vlerës nëpërmjet projekteve në ekonominë kombëtare rritet vazhdimisht (Flyvbjerg & Turner, 2017), (Jalocha & Cwikla, 2017). Projektizimi përfshin një numër aspektesh, si rritja e sasisë së punës që kryhet në formën e organizimit “projekt”, shtimi dhe pranimi i praktikave të menaxhimit të projekteve në shoqëri, përhapja e projekteve në variante të shumëllojshme, ndryshimi i kërkesave ndaj projekteve dhe menaxhimit të projekteve, ndryshimi i sistemit të menaxhimit të projekteve që është i fokusuar në tërësinë e projekteve të kryera nga një ose disa organizata (Gemunden & Schoper, 2014). Pasojë e kësaj tendence të projektizimit është rritja e larmisë së detyrave të projekteve dhe qasjeve të menaxhimit të projekteve.

Zhvillimi i TIK sidomos në dekadën e dytë të shek. 21 dhe pandemia e vitit 2020 kanë nxitur studjuesit dhe organizatat profesionale në parashikimin e tendencave të reja (pas 2020), kryesisht të ndikuara nga teknologjia e informacionit (PMI, 2021). Inteligjenca artificiale (IA) dhe automatizimi, metodologjitë hibride të menaxhimit të projekteve, virtualizimi dhe përforsimi i sigurisë kibernetike janë ndër drejtimet kryesore që profesionistët e menaxhimit të projekteve do të duhet të marrin parasysh për të ardhmen e fushës.

Profesionalizimi i menaxhimit të projekteve shoqërohet me një masë në rritje të përdorimit gjithëpërfshirës të praktikave të menaxhimit në lloje të ndryshme projektsh. Këtu merren në konsideratë projektet e veçanta, portofolet e projekteve dhe organizatat-projekt (Gemunden et al., 2017). Njohja e karakteristikave dhe mjedisit në të cilin janë më të përshtatshme të përdoren këto mënyra apo metoda ju vjen në ndihmë palëve të interesit në projekte.

3.2 Metodatat që përdoren në menaxhimin e projekteve

Projektet janë unike dhe deri diku i tillë është edhe modeli më i përshtatshëm për t’i menaxhuar ata. Pranohet gjerësisht se një model apo qasje unike “one-size-fits-all” nuk funksionon (Kuster et al., 2015), (PMBOK7, 2021), (Breyter, 2022). Është shumë më efektive të grupohen projektet bazuar në ngjashmëritë e tyre dhe të përdoret një qasje e menaxhimit të projektit e krijuar apo përshtatur posaçërisht për çdo lloj projekti (Wells, 2012). Ka kritere të shumta për klasifikimin e projekteve, që përfshijnë madhësinë (vlera, kohëzgjatja, shtrirja në strukturën e organizatës), natyrën e rezultatit që krijojnë, nivelin e kompleksitetit dhe pasigurisë, teknologjinë që përdorin, etj. Bazuar në llojin e projektit organizatat zgjedhin metodën e menaxhimit që ndjekin dhe në këtë zgjedhje menaxheri i projektit ka (ose duhet të ketë) rol vendimtar (Wysocki, 2019), (Meredith et al., 2017), (Ahsan et al., 2013). Megjithatë, sipas një vëzhgimi të PM (2022) ka një variacion të madh ndërmjet përdoruesve lidhur me metodën ose metodat që përdorin (Tabela1).

Studjuesit dhe profesionistët e fushës theksojnë se, edhe pse do të vazhdojë të ketë situata projektsh për të cilat mënyrat e vjetra janë të përshtatshme, ka një grup krejtësisht të ri projektsh (aplikacionesh) për të cilat organizatat kanë ose duhet të gjejnë metoda të reja për suksesin e projekteve (Wysocki, 2019). Për të shmangur keqkuptimet apo keqinterpretimet e termave, në vijim të punimit do të përdoret termi “metodë” e menaxhimit të projekteve (dhe jo metodologji, qasje, filozofi, apo mendësi, që ndeshet në autorë të ndryshëm, cituar më lart).

Tabela 1. Metodatat e menaxhimit të projekteve në përdorim

Metoda	Ujëvarë (waterfall)	Elastike (agile)	Hibride (waterfall & agile)	Asnjë metodë formale	Shumë stile brenda të njëtit projekt
Masa e përdorimit	14%	12%	39%	17%	18%

Shënim: (PM , 2021) përpunuar nga autori

a) Metoda tradicionale e menaxhimit të projekteve

E emërtuar edhe metoda “ujëvarë”, është më e zakonshme dhe e njohura për të planifikuar një projekt. Thelbi i saj qëndron në ndarjen, renditjen e detyrave që çojnë drejt rezultatit përfundimtar dhe në organizimin e punës për të realizuar ato sipas renditjes. Vetë emri ujëvarë vjen nga qasja nga lart-poshtë, që nënkupton realizimin e detyrave në mënyrë sekuenciale sipas një plani të hartuar që më parë. Plani i plotë i projektit bazohet në kërkesa dhe specifikime teknike, përcakton punët që do të kryhen për të përmbushur specifikimet, saktëson skedulimin dhe përlogarit burimet e nevojshme për realizimin e punëve. Metoda tradicionale, e quajtur edhe parashikuese (predictive), drejtohet nga plani dhe suksesi i projektit matet nga përputhja dhe dorëzimi sipas planit. Pikërisht ky planifikim përbën një nga avantazhet e metodës, sidomos për projektet që prodhojnë/ krijojnë objekte fizike dhe kur në të ardhmen mund të përsëriten projekte të ngjashme (Verzuh, 2016), (Stern, 2017).

Metoda tradicionale e menaxhimit të projekteve konsiderohet e përshtatshme për projektet kur ata kanë disa karakteristika të dallueshme:

- Qëllimi dhe mënyra e zgjidhjes së problemit janë të përcaktuara relativisht qartë.
- Kompleksiteti është i ulët dhe/ose kërkesat për ndryshim të specifikimeve janë të pakta.
- Teknologjia e punës është e njohur dhe grupet e projektit kanë njohuri e kompetenca.
- Risku është relativisht i ulët dhe grupet e projektit kanë eksperiencë dhe aftësi.

Megjithëse kjo konsiderohet si metoda më e thjeshtë për t'u kuptuar e zbatuar përgjatë ciklit të jetës së projektit, çdo ndryshim në kërkesat apo në kushtet e realizimit të projektit nga ana e palëve të interesuara, do të çënojë sekuencën e detyrave, duke e bërë të vështirë menaxhimin (Wysocki, 2019). Në ndihmë të menaxhimit efektiv, ka disa teknika të skedulimit që përshtaten me metodën tradicionale. Metoda e rrugës kritike (Critical path method /CPM) dhe Menaxhimi i zinxhirit kritik të projektit (Critical Chain Project Management /CCPM) fokusohen të rruga /rrugët kritike. Ato mundësojnë ri-skedulimin në mënyrë që të optimizohet puna e grupit të projektit dhe përdorimi i burimeve pa vonuar përfundimin e projektit (Meredith et al., 2017) (Kuster et al., 2015), (PMBOK, 2017).

b) Metoda Agile

Nën ndikimin e zhvillimeve të teknologjisë dhe sistemeve të informacionit, menaxhimi i projekteve është shtrirë në fusha ku objektivat e projektit nuk kuptohen mirë, afatet kohore janë të panjohura dhe buxhetet të papërcaktuara. Këto njihen edhe si “quasi-projects” (Meredith et al., 2017). Në projektet që karakterizohen nga ndryshime të kërkesave të klientëve, nga risk i lartë ose pasiguri e madhe, shpesh herë qëllimi (specifikimet teknike) nuk kuptohet qartë që në

fillim, ose zhvillohet gjatë projektit. Klientët kërkojnë përfshirjen integrale në prodhim dhe ulje të kostos dhe kohës njëkohësisht. Reagimi i shpejtë nga ana e konkurrentëve nxit përsheptimin e projektit dhe shkurtime të cikleve të prodhimit. Për t'iu përgjigjur situatave të tilla, sidomos në TIK janë krijuar metoda Agile të përdorura në zhvillimin e software-ve, që po aplikohen edhe në industritë e tjera (PMI, 2021). Me metodën Agile qëllimisht shpenzohet më pak kohë për të përcaktuar dhe për të rënë dakord për qëllimin në fazën e hershme të projektit dhe shpenzohet më shumë kohë për të krijuar procesin duke e zhvilluar dhe përsosur atë në vazhdimësi. Shumë projekte me kërkesa/ aplikime të reja zbulojnë se shpesh ka një mospërputhje midis kërkesave reale dhe kërkesave që biznesi ose klienti ka deklaruar fillimisht (Stare, 2013). Prandaj metoda Agile lejon të ndërtohen dhe rishikohen prototipet e produkteve dhe ekipet krijojnë variante në mënyrë që të saktësojnë dhe plotësojnë optimalisht kërkesat e projektit. Si rezultat, qëllimi përcaktohet dhe ripërcaktohet gjatë gjithë projektit, prej nga metoda merr edhe emërtimin “adaptive” (PMBOK6, 2017).

Metoda Agile (elastike) është një mënyrë e menaxhimit të projektit që zhvillohet si rrugë më fleksibël dhe efiçiente për të çuar produktet në treg. Fillimisht, në 2001, me publikimin e Agile Manifesto nga autorët e saj, u krijua si një mënyrë e re, më e mirë dhe më e shpejtë, për menaxhimin e zhvillimit të software-ve (Fowler & Highsmith, 2001). Më pas përdorimi i saj u shtri edhe në projekte në industri dhe aktivitete të tjera. Metoda Agile, sipas autorëve të saj, bazohet në 4 vlera dhe 12 parime për të organizuar projektet. Katër vlerat e ‘Agile Manifesto’, që paraqesin edhe thelbin e metodës Agile, janë:

- Individët dhe ndërveprimet kanë përparësi ndaj proceseve dhe mjeteve.
- Software që funksionon ka përparësi ndaj dokumentacionit gjithëpërfshirës.
- Bashkëpunimi me klientin ka përparësi ndaj negociimit të kontratës.
- Përgjigjet ndaj ndryshimeve kanë përparësi ndaj ndjekjes së planit.

Karakteristikë e metodës Agile është se ajo lejon një nivel të lartë të përfshirjes së klientit dhe përfshin rishikime të shpeshta të progresit, bashkë me grupin e projektit dhe klientin. Sipas Breyter (2022) në dallim nga metoda tradicionale e menaxhimit të projekteve, metoda Agile ndryshon qasjen e menaxhimit nga lart-poshtë (top-down) në poshtë-lart (bottom-up). Ajo ndryshon punën e menaxherëve nga ndarja e detyrave për stafin në mbështetjen e tyre për të eliminuar pengesat (vonesat, inefficiencat e procesit, sfidat e buxhetit, ose varësitë nga faktorët e jashtëm) dhe fuqizon vendimmarrjen e tyre.

Krahasimi me metodën tradicionale qartëson shumë nga elementët që e bëjnë funksionale metodën Agile (Tabela 2).

Tabela 2. Krahasim i metodave Tradicionale dhe Agile

Dimensioni	Metoda Agile	Metoda tradicionale
Planifikimi	Plane afat-shkurtër që përshtaten ndërkohë që projekti përparon	Përpjekje për t'i qëndruar planeve afatgjatë të hartuar më parë
Përfshirja e klientit	Përgjatë gjithë projektit	Në fillim dhe në fund të projektit
Zbatimi i projektit	I ndarë në faza rritëse (incremental), që quhen iteracione	Puna kryhet bazuar në një plan gjithëpërfshirës dhe shumë të strukturuar

Komunikimi	Inkurajohet komunikim hapur, i shpeshtë (ditor) ndërmjet palëve	Kryesisht për kontrollin e projektit
Info mbi rezultatet	Në fund të çdo iteracioni	Në fund të projektit
Struktura e punës	Grupe të integruara cross-functional	Anëtarët e grupit punojnë individualisht dhe mbështeten të menaxheri i projektit për koordinimin e detyrave
Lidershipi i projektit	Grupe që vetëmenaxhohen	Menaxheri i projektit ndan detyrat e punës për anëtarët
Pronësia e procesit	Grupi	Menaxheri i projektit
Eksperimentimi	Inkurajohet që të gjenden rrugë për të plotësuar sa më mirë kërkesat e klientit	Dekurajohet, në mënyrë që projekti të realizohet në afat dhe brenda buxhetit
Qëllimi	Elastik	I përcaktuar

Shënim: Meredith et al., përpunuar nga autori

Që nga vitet e para të paraqitjes së metodës Agile dhe sidomos në dhjetëvjeçarin e dytë të përdorimit të saj, një numër studjuesish kanë hulumtuar dhe analizuar përfitimet nga menaxhimi fleksibël i projekteve (Breyter, 2022). Përfitimet kryesore paraqiten më poshtë.

Kontakti i vazhdueshëm me klientin. Ky kontakt përgjatë gjithë procesit të krijimit mundëson njohjen saktë të kërkesave dhe bashkë me lëvrimet pjesore (iterative) sigurojnë që produkti final është sic i nevojitet klientit (Solinski & Petersen, 2016), (Wysocki, 2019).

Aftësia për tu përshtatur. Lejon që ndryshimet që kërkohen në secilën fazë të mund të përfshihen në projekt kur ato nevojiten dhe të realizohen me minimumin e kostove / kohës, pa prituri përfundimin e punës (Masood, Farroq, 2017).

Livrim më i shpejtë. Metoda lejon që grupi i projektit të ofrojë vazhdimisht produkt/ pjesë të përdorshme, pa prituri afatin përfundimtar. Klienti merr variante të përdorshme funksionale në intervale kohe më të shkurtëra (Wells, 2012), (PM, 2022).

Risk më i ulët i projektit. Zhvillimi i produkteve dhe marrja e informacionit (feedback) në vazhdimësi nga klienti minimizon riskun e dështimit të projektit. Është më e mundshme të detektohen herët probleme të vogla dhe të zgjidhen ato, se sa të detektohet një problem madhor në faza të vonshme, përpara përfundimit të projektit (Meredith et al., 2017), (Kurup & Sidharan, 2015). Sa më herët, aq më pak kohë e humbur dhe shpenzime.

Inovacion i vazhdueshëm. Bashkëpunimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm që Agile lejon shpie në inovacion dhe zhvillim produktesh e karakteristikash të reja (Masood & Farroq, 2017). Ekipet që punojnë sëbashku në të njëjtin vend dhe takimet ditore nxisin ‘brainstorming’ dhe lindjen e ideve të reja.

Karakteristikat dhe përfitimet e pritshme nga metoda Agile e bëjnë atë të përshtatshme për organizata dhe tipe projekti të tilla që:

- Evoluojnë ose që nuk kanë fushëveprimi dhe kërkesa të qarta në fillim.
- Punojnë në mjedise që ndryshojnë shpejt (fast changing), si në teknologji.
- që duhet të bashkëpunojnë ngushtë me klientët dhe palët e tjera gjatë gjithë jetës së projektit.
- Kanë parësore përmirësimin e proceseve dhe produkteve dhe janë vazhdimisht në kërkim të inovacionit.

- Janë me shumë punë të ndërlydhura ose që kërkojnë feedback të shpejtë nga palët e interesuara për çdo fazë (të produktit) përpara se të kalojnë në fazën tjetër.
- Janë procese “management-in-the-small”, ku mekanizmat e koordinimit, kontrollit dhe komunikimit aplikohen në grupe projekti të vogla ose të mesme. Në rastin e grupeve të mëdha linjat e komunikimit dhe takimet e shpeshta informale janë të vështira dhe kjo çon në ulje të efektivitetit (Turk et al., 2002).

Si çdo metodë menaxhimi, edhe Agile nuk është perfekte. Nëse nuk përdoret siç duhet, edhe avantazhet e saj të brendshme mund të kthehen në pengesë për grupin e projektit. Disavantazhet dhe sfidat e metodës Agile janë identifikuar që në fillimet e saj (Turk et al., 2002) dhe janë vëzhguar e analizuar më pas në situata projektesh të ndryshme. Sipas studjuesve të fushës, disa prej kryesoreve parashtrihen më poshtë.

Paparashikueshmëria. Elasticiteti që qëndron në themel të Agile nga ana tjetër do të thotë që niveli i parashikueshmërisë është i ulët (Kurup & Sidharan, 2015). Kjo nënkupton më pak saktësi në vlerësimin/ llogaritjen e kohës dhe sasisë së burimeve të nevojshme për përfundimin e projektit (Masood & Farooq, 2017). Grupet e projektit i tremben kësaj pasigurie dhe kjo mund të cojë në vendimmarrje të gabuara.

Më shumë kohë dhe angazhim. Komunikimi i vazhdueshëm dhe takimet e shpeshta, megjithëse të dobishme, konsumojnë kohë dhe energji të personave të përfshirë në grupin e projektit. Kështu mund të vështirësohet monitorimi dhe kontrolli i projektit në aspektin e fushës së veprimit të tij. Për më tepër, inkurajimi i ndryshimeve të shumta në specifikimet e projektit mund të sjellë rritje të ndjeshme të kostos dhe kohës (Solinski & Petersen, 2016).

Më shumë kërkesa për zhvilluesit dhe klientët. Që menaxhimi i projektit të jetë efektiv nevojitet angazhim dhe pjesëmarrje nga secila prej palëve. Në të kundërt çenohet cilësia e projektit. Gjithashtu vështirësohet sigurimi dhe kontrolli i cilësisë për shkak të mungesës së specifikimeve dhe treguesve të referencës (Kurup & Sidharan, 2015).

Mungesa e dokumentimit të nevojshëm. Në kushtet kur punët kryhen në momentin që nevojiten për zhvillim, dokumentimi i tyre mund të jetë jo i plotë, duke sjellë paqartësi dhe keqkuptime në vazhdim. Nga ana tjetër, tendenca për të minimizuar format e strukturuar të komunikimit dhe vendimmarrjes bën që një pjesë e njohurive të projektit nuk arrijnë të dokumentohet (Sharma et al., 2012), (Masood & Farooq, 2017). Ajo mbetet vetëm në mendjen e anëtarëve të grupit të projektit dhe nuk transferohet tek organizata.

Projektet mund të devijojnë lehtësisht. Duke qenë më pak të strukturuar dhe të përcaktuar, projektet mund të dalin jashtë qëllimit fillestar dhe të shkojnë në rrugë të gabuar (Masood & Farooq, 2017).

c) Metoda hibride

Veçoritë e shumë projekteve bëjnë që cikli i jetës së tyre të jetë një kombinim i cikleve parashikuese (predictive) dhe përshtatëse (adaptive). Elementët e projektit që janë të njohur ose të përcaktuar ndjekin rrugën parashikuese, ndërsa ata që janë duke u zhvilluar dhe saktësuar ndjekin variantin adaptiv. Mbi këtë bazë mbështetet metoda hibride e menaxhimit të projekteve, si kombinim i elementëve të dy metodave të lart-përmendura (PMBOK7). Përfitimi nga avantazhet e secilës prej metodave duke minimizuar ndikimin negativ respektiv i jep vlerë kësaj qasjeje. Grupi i projektit mund të përdorë disa elementë të metodës tradicionale si ngritja e një strukture projekti formale dhe dokumentimi i punëve të projektit të kombinuara me praktikën iterative Agile, duke bërë më efektiv menaxhimin e cilësisë, kohës dhe të njohurive

(Denning, 2018). Për ilustrim, shembujt përfshijnë përdorim të teknikave të analizës së biznesit për menaxhimin e kërkesave të kombinuara me praktikën iterative ose rritëse (incremental) për dorëzimin e produkteve (PMBOK7).

Kjo metodë është e dobishme kur ka pasiguri dhe rrezik lidhur me kërkesat e projektit. Është e përshtatshme edhe kur livrimi i rezulttit të projektit mund të bëhet me pjesë, ose kur ka produkte që mund të zhvillohen nga grupe të ndryshme të projektit. Metoda hibride anon më shumë nga metoda adaptive se sa nga ajo parashikuese.

Theksohet fakti që roli i menaxherit të projektit mbetet i rëndësishëm në cilëndo metodë që organizata zgjedh ose përshtat. Për të qenë i sukseshëm në përdorimin e metodave adaptive, menaxheri i projektit duhet të njohë teknikat dhe mjetet që të mund t'i përdorë ato në mënyrë efektive (Kuster et al., 2015), (Meredith et al., 2017).

d) Qasje të tjera

Një pjesë e autorëve përfshijnë në klasifikimin e metodave të menaxhimit edhe mënyra të tjera, si qasje për situata specifike, por që po shtohen (Wysocki, 2019). Kur qëllimi dhe rezultati që kërkohet të arrihet janë jo të njohura ose jo të mirë-përcaktuara, rekomandohet qasja e menaxhimit ekstrem (Extreme PM /xPM) (Decarlo, 2004). Kjo metodë është ideuar për raste projektesh në kërkim- zhvillim të teknologjisë, produkteve të reja, përmirësimeve në të cilat ka risk shumë të lartë, ndryshime të shpeshta dhe shpejtësi të lartë avancimi (vaksina COVID-19 mund të jetë shembull tipik).

Wysocki (2019) përshkruan edhe një qasje tjetër, të quajtur Emertxe (Extreme e shkruar mbrapsht). Faktikisht MPx është një projekt ekstrem, i realizuar në të kundërt: në vend që të kërkohet dhe krijohet rezultati, kërkohet qëllimi i përdorimit të tij. Situatat kur është shpikur një teknologji e re por nuk dihet ku/si të aplikohet, apo kur ka një zgjidhje dhe kërkohet problemi për të cilin ai shërben, bien në këtë kategori projektesh.

Pavarësisht trajtimit të këtyre qasjeve nga disa autorë, ato ende nuk janë njohur institucionalisht si metoda dhe nuk referohen në manualët zyrtarë. Edhe botimi i fundit i PMBOK7 (2021) përdor termat Agile, adaptiv dhe menaxhim projekti i orientuar nga ndryshimi (change-driven PM).

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, është ajo që ndodh në praktikë, ku me menaxhimin e projekteve merren një numër i madh personash, me dhe pa njohuritë dhe kualifikimin e nevojshëm. Megjithëse kuadri teorik pranohet gjerësisht nga profesionistët, vëzhgimet tregojnë se komuniteti i praktikuesve përdor në masë të madhe një menaxhim projekti “Do It Yourself”, ku pjesa më e madhe është joformale, ndoshta spontane dhe jo në përputhje me praktikën e pranuar (Wysocki, 2019), (PM, 2022).

4. Përfundime

Menaxhimi i projektit nuk është i ri në aspektin më të gjerë të praktikës së menaxhimit, pasi ai ka shoqëruar realizimin e projekteve që në kohët e lashta. Ndërsa historia e menaxhimit të projektit është relativisht e re dhe është zhvilluar me hapa të shpejtë sidomos në dekadat e fundit, e mbështetur nga avancimet teknologjike dhe zhvillimet globale. Punimi i është kushtuar paraqitjes së metodave të njohura dhe të reja të menaxhimit të projekteve dhe përfitimeve e sfidave që i shoqërojnë ato.

Metoda tradicionale (ujëvarë) është më e njohur dhe e lehtë për t'u kuptuar (por jo

gjithmonë e tillë për t'u zbatuar), me karakteristikat dhe situatat e projekteve në të cilat ajo rekomandohet si më e përshtatshme.

Metoda e re Agile, që daton nga viti 2001, përshkruhet më hollësisht, në mënyrë që të qartësohet thelbi, karakteristikat dhe rastet e projekteve që mund të menaxhohen me efektivitet përmes saj.

Metoda hibride, si kombinim i metodës tradicionale dhe asaj Agile, ju mundëson organizatave dhe grupeve të punës të përfitojnë nga parashikueshmëria e të parës dhe nga fleksibiliteti i metodës së dytë. Gjithashtu ofron një diapazon të gjerë kombinimesh në funksion të strukturës organizative dhe objektivave strategjike të organizatave të angazhuara në projekte.

Kontributi modest i këtij hulumtimi qëndron në prezantimin e bazuar teorikisht dhe të strukturuar të njohurive mbi metodat e menaxhimit të projekteve në periudhën aktuale. Ndërkohë, situata konkrete e përdorimit të këtyre metodave në mjedisin shqiptar dhe ndryshimet e pritshme nën ndikimin e teknologjisë së informacionit mbeten fusha kryesore për t'u eksploruar në të ardhmen.

Literatura

- Abbasi A., Jaafari, A. (2018). Evolution of project management as a scientific discipline. *Data and Information Management*. No.2 (2), pp. 91-102. <https://doi.org/10.2478./dim.2018>
- Ahsan K., Ho M. Khan S. (2013). Recruiting project managers: a comparative analysis of competencies and recruitment signals from job advertisements. *Project Management Journal*, Vol. 44, No. 5, pp. 36–54 (wileyonlinelibrary.com). DOI:10.1002/pmj.21366
- Beqiri E., (2015). Zhvillimi dhe menaxhimi i projekteve (ligjerata të autorizuara) Universiteti i Pejes “Haxhi Zeka” Kosovë. <https://www.researchgate.net/profile/Edmond-Beqiri/publication/288181725>
- Bredillet, C. N. (2002). Mapping the dynamics of project management field: Project management in action. Proceedings of Project Management Research Conference, pp. 157–169, USA.
- Bredillet, C. N. (2006). The future of project management: Mapping the dynamics of project management field in action. In D. I. Cleland and R. Gareis (Eds.), *Global project management handbook*, 2nd edition, pp. 13-24.
- Breyter M., (2022). *Agile Product and Project Management*, Apress USA. https://doi.org/10.1007/978-1-4842-8200-7_3
- Decarlo D., (2004). *eXtreme Project Management: Using Leadership, Principles & Tools to Deliver Value in the Face of Volatility*. Jossey-Bass, USA.
- Denning, S., (2018). Succeeding in an increasingly Agile world. *Strategy & Leadership*, 46(3), pp. 3-9.
- Flyvbjerg, B. (2014). What You Should Know About Megaprojects and Why: An Overview. *Project Management Journal*, 45, pp. 6–19.
- Flyvbjerg B., Turner J.R., (2017). Do classics exist in megaproject management? *International*

Journal of Project Management. <http://dx.doi.org/10.1016/j.ijproman.2017.07.006>

- Fowler M. and Highsmith J., (2001). The Agile Manifesto. *Software Development* 9, No. 8, August 2001: 28–32.
- Gemunden H.G., Schoper Y-G., (2014). Future trends in project Management The German Project Management Association (GPM).
- Gemunden H.G., Lehner P., Kock A., (2017). The project-oriented organization and its contribution to innovation, *International Journal of Project Management*.
<http://dx.doi.org/10.1016/j.ijproman.2017.07.009>
- Geraldi, J. & Morris, P.W.G. (2011). Managing the institutional context for projects. *Project Management Journal*, 42 (6), pp.20-32. <http://doi.org/10.1002/pmj.2071>
- Haughey, D. (2014). A brief history of project management. Project Smart.
<https://www.projectsmart.co.uk/brief-history-of-projectmanagement.php>
- Jałocha, B. & Cwikła, M. (2017). Addicted to projects: cultural policies in times of projectification. Proceedings of 21st International Research Society on Public Management Conference, Budapest April 2017.
- Kabeyi M., (2018). Evolution of Project Management, Monitoring and Evaluation, with Historical Events and Projects that Have Shaped the Development of Project Management as a Profession. *International Journal of Science and Research (IJSR)* ISSN: 2319-7064
- Kurup, D., Sidhardhan S., (2015). Agile project management: Benefits and challenges. Academia.
https://www.academia.edu/19888935/Benefits_and_Challenges_of_Agile_Project_Management
- Kuster J., Huber E., Lippmann R., Schmid A., Schneider E., Witschi U., Wust R. (2015). *Project Management Handbook*, Springer, Germany.
- Masood Z.A., Farooq S., (2017). The benefits and key challenges of Agile project management under recent research opportunities *International Research Journal of Management Sciences*. Vol., 5 (1), 20-28, 2017 <http://www.irjmsjournal.com>
ISSN 2147-964X.
- Meredith J.R., Shafer S.M., Mantel S.J., (2017). *Project Management in Practice*. 6th edition. Wiley, ISBN: 978-1-119-29885-4.
- Panariti S., (2013). *Manaxhim Projekti*, Adelprint Tiranë.
- Paterek P., (2019). Agile transformation changes from the perspective of project team values. *Project Management Development – Practice and Perspectives*, 8th International Scientific Conference on Project Management in the Baltic Countries April 2019, Riga, University of Latvia, e-ISSN 2501-0263.
- PMI (2017). *PMBOK Guide*, 6th ed. A Guide to the Project Management Body of Knowledge, USA. ISBN: 978-1-62825-184-5

- PMI (2021). PMBOK Guide, 7th ed. A Guide to the Project Management Body of Knowledge and the Standard for Project Management, USA, PMI 99-001-2021.
- PMI (2021). AI innovators cracking the code project performance
<https://www.pmi.org/-/media/pmi/documents/public/pdf/learning/thought-leadership/pulse/>
- PMI (2020). <https://www.selecthub.com/project-management/project-management-trends/>
- PM (2022). Global trends in project Management, www.projectmanager.com/
- Schuster A., (2017). Exploring projectification in the Public Sector. The iron triangle revisited. Intl. Research Society on Public Management Conference, Cranfield University.
<https://www.academia.edu/33314128/>
- Sharma, S., Sarkar, D., & Gupta, D. (2012). Agile processes and methodologies: A conceptual study. *International Journal of Computer Science and Engineering*, 4(5), pp. 892-898.
- Solinski, A.; Petersen, K., (2016). Prioritizing agile benefits and limitations in relation to practice usage. *Software Quality Journal*, 24(2), pp. 447-482.
- Stare, A. (2013). Agile project management: A future approach to the management of projects? *Dynamic Relationships Management Journal*, 2(1), pp. 43-54.
- Stern T.V., (2017). Lean and Agile Project Management. CRC Press, USA.
- Turk D., France R., Rumpe B. (2002). Limitations of Agile Software Processes. In: Third International Conference on Extreme Programming and Flexible Processes in Software Engineering, XP2002, May 26-30, Alghero, Italy, pp. 43-46.
- Verzuh E. (2016). The fast forward MBA in project management 5th edition. John Wiley & Sons, Inc, SHBA. ISBN 978-1-119-08667-3.
- Wells, H. (2012). How effective are project management methodologies. An explorative evaluation of the benefits in practice. *Project Management Journal*, 43(6), 43- 58.
- Westland, J. (2018). History of project Management. Project Manager. May 24, 2018.
<https://www.projectmanager.com/blog/history-projectmanagement>
- Wysocki R.K., (2019) Effective Project Management: Traditional, Agile, Extreme, Hybrid, 8th Edition, John Wiley & Sons.

Faqe zyrtare:

<https://www.aida.gov.al/sq/projekte-ne-nvm>

<https://www.albaniandf.org/projekte/>

<https://www.eupolicyhub.eu/projekte/>

<http://nasri.gov.al/>

<https://ipma.world/>

Roli i marketingut digjital në biznesin e vogël në Shqipëri

Morena Boja ^{a, 14}

^aUnversiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Përmbledhja

Digjitalizimi është bërë pjesë e realitetit të biznesit shqiptar. Ai ka ndryshuar mënyrën se si individët dhe bizneset reagojnë ndërmjet tyre. Ky studim analizon rolin e marketingut digjital në biznesin e vogël në Shqipëri, duke përfshirë të gjithë sektorët e ekonomisë. Personat e intervistuar për këtë studim janë të gjithë pronarët e bizneseve të vogla ose individë të tjerë të cilët drejtojnë biznesin e vogël, por ligjërisht nuk janë pronarë. Të intervistuarit për këtë studim janë 185 pronarë bizneseve ose individë që i drejtojnë ato dhe pyetësi iu është dërguar në mënyrë të rastësishme. Të dhënat që do të analizohen në këtë studim janë mbledhur nga një pyetësor i cili përmban disa kategori pyetjesh. Rezultatet tregojnë që tendencat e përdorimit të marketingut digjital janë në rritje duke e konsideruar këtë si një formë për të rritur gjithashtu performancën e shitjes së produkteve ose shërbimeve. Faktorët që ndikojnë në përdorimin e mjeteve inovative në biznes për qëllime marketingu janë konsideruar si element përcaktues të biznesit të vogël. Ky studim ka për qëllim të ofrojë informacion mbi impaktin e inovacionit dhe përdorimit të marketingut digjital.

Fjalët kyçe: Digjitalizim; marketing digjital; biznesi i vogël

Abstract

Digitalization has become part of our daily routine. It has changed the way businesses and individuals are reacting to each other. This study analyzes the role of digital marketing in small business in Albania, including all sectors of the economy. Interviewed persons for this study are all small business owners or other individuals who run small businesses but are not owners. The respondents for this study are 185 business owners or individuals who run them, the questionnaire has been sent randomly. The data to be analysed in this study were collected from a questionnaire which contains several categories of questions. The results show that digital marketing trends are on the rise, considering this as a form to increase the performance of the sales of products or services. Factors that affect the use of innovative equipment in business marketing purposes are considered as determining the financial elements of small business and knowledge of technology and business owner networks. This study aims to provide Information on the impact of digital marketing and marketing.

Keywords: Digitalisation, Digital Marketing, small businesses

¹⁴ KONTAKT: morena.boja@umsh.edu.al

1. Hyrje

Sot tregjet në mbarë botën po ndryshojne me një shpejtësi të papërcaktuar më parë. Fenomene të ndryshme si globalizimi dhe ndërkombëtarizimi i tregjeve, zhvillimi i inovacionit dhe teknologjisë 4.0 po përcaktojnë jo vetëm mënyrën se si ne blejmë produkte ose shërbime, por dhe preferencat tona për to. Patjetër që marketingu u prek dhe u ndikua nga ky proces. Edhe pse këto ndryshime innovative mund të praktikohen dhe të përshtaten në kompanitë e mëdha multinacionale, bizneset e vogla në mbarë botën kanë ritme më të ngadalta të përshtatjes e kjo lidhet dhe me kostot. Por referuar shumë studimeve për biznesin e vogël përdorimi i marketingut digjital, internetit dhe rrjeteve me qëllim promovimin e produkteve dhe shërbimeve nga shumë këndvështrime konsiderohet si një mundësi shumë e mirë pasi ka shumë më pak kosto se marketingu tradicional, i cili është i paaksesueshëm nga shumë biznese të kësaj kategorie, të cilat nuk mund të përdorin marketingun masiv, reklamat në tv, radio apo në kanale të tjera. Në ditët e sotme sipërmarrjet e vogla nuk e kanë në planin e tyre të zhvillimit marketingun tradicional, ato janë të fokusuar në marketingun digjital, në përdorimin e e-tregtisë, rrjeteve sociale apo internetit dhe aplikacioneve të tjera me të cilat ato mund të konkurojnë jo vetëm në tregje lokale dhe rajonale por dhe në ato ndërkombëtare (Rezvani, M., & Colabi, A, 2012). Përdorimi i rrjeteve sociale dhe digjitalizimi kanë ndryshuar preferencat e konsumatorëve nga njëra anë, por nga ana tjetër kanë ndryshuar dhe ndikuar tek bizneset edhe markat që ato përfaqësojnë (Muntiga et al, 2011).

Konsumatorët sot po shpenzojnë gjithnjë e më shumë kohë duke përdorur telefonat e lidhur me internet apo pajisje të tjera nëpërmjet të cilave ato kanë akses në internet. Ato janë të prirur të kërkojnë çfarëdolloj informacioni në Google apo në motorë të tjerë kërkimi. Është e pranueshme tashmë se përdorimi i marketingut digjital është një domosdoshmeri për bizneset e vogla nëse ato duan të jenë konkurese dhe të zhvillohen në treg.

Në këtë studim kërkojmë t'i përgjigjemi dy pyetjeve:

1-Si ndikon marketingu digjital në biznesin e vogël në Shqipëri?

2-Cilët janë faktorët që përcaktojnë përdorimin e marketingut digjital?

Për t'ju përgjigjur pyetjeve të mësipërme kërkimore ky studim është strukturuar si më poshtë: Rishikimi i literaturës, metodologjia, analiza e të dhënave, konkluzione dhe rekomandime.

2. Rishikim literature

Përkufizimi i biznesit të vogël ndryshon në varësi të legjislacionit të vendit. Referuar përcaktimit ligjor, biznes i vogël në Shqipëri quhet ai biznes që ka më pak se dhjetë punonjës dhe një kapital më të vogël se 5 milion lekë. Studime të ndryshme pohojnë se procesi i digjitalizimit dhe marketingu digjital është i lidhur pozitivisht dhe me biznesin e vogël. Marketingu digjital përkufizohet si përdorimi i teknologjisë për qëllime marketingu. Përdorimi i marketingut digjital i jep mundësi biznesit të vogël të tërheqë klientët në mënyrë të shpejtë dhe efektive, të targetojë grupin e klientelës që ka në fokus pa shumë kosto dhe shpenzime (Shideler, 2012).

Përdorimi i rrjeteve sociale për qëllime marketingu është kthyer në një metodë dhe strategji shitjeje për shumë biznese sot. Rrjetet sociale apo të quajtura ndryshe Web 2.0 veprojnë si një

faktor shumë i rëndësishëm në biznese sot në të gjithë botën. Ndikimi i rrjeteve sociale në mënyrën e organizimit të biznesit apo në strategjitë e tyre të shitjes është shumë i madh (Kaplan, A.M & Haenlein, M, 2010).

Studime të ndryshme kanë arritur në perfundime se bizneset e vogla sot shpenzojnë 4-5 orë në ditë në rrjetet sociale. Interaktiviteti në këto platforma i ndihmon bizneset në drejtime të ndryshme; ai ka një impakt pozitiv në forcimin e marrëdhënieve me konsumatorët, forcimin dhe promovimin e markës, menaxhimin e kanalit të shitjeve. Nga ana tjetër ka efekte pozitive edhe për konsumatorët. Studime të ndryshme në kontekstin global arrijnë në konkluzionin se duke përdorur platformat e rrjeteve sociale konsumatori mund të gjejë menjëherë produktin ose shërbimin e dëshiruar dhe mund të zgjedhë ndërmjet markave të ndryshme, pa shpenzuar kohë dhe pa lëvizur, por i blen ato nga telefoni, kompjuteri apo pajisje të tjera në të cilat ka akses në këto platforma. Strategjia e bizneseve për të vazhduar aktivitetin e tyre të marketingut në rrjete sociale njihet si “social media marketing” SMM (Shareef et al. Mukerji, 2018).

Rrjetet sociale përfshijnë aktivitete të ndryshme si blog, podcast, moblogs, e-mail etj. Referuar literaturës, ka disa faktorë që nxisin përdorimin e rrjeteve sociale nga bizneset e vogla. Në shumë vende përdorimi i rrjeteve sociale si një formë e tregtisë elektronike sjell më shumë të ardhura për biznesin e vogël duke zhvilluar dhe rritur atë. Studime të tjera pohojnë se marrëdhënia e drejtpërdrejtë që krijohet në rrjete sociale mes klientit dhe biznesit i ndihmon ato të kenë një menaxhim më të mirë të portofolit të klientëve, ti propozojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë, të menjëhershme dhe pa kosto extra produktet dhe shërbimet e reja. Përdorimi i rrjeteve sociale është i thjeshtë dhe nuk ka nevojë për njohuri të avancuara në teknologji edhe pse studime të tjera pohojnë që niveli i njohurive që zotëron pronari i biznesit ndikon në përdorimin e rrjeteve sociale për qëllime biznesi. Studime të tjera pohojnë se mungesa e burimeve njerëzore dhe financiare i drejton bizneset e vogla drejt përdorimit të marketingut digjital si një formë ku kursejnë kohë dhe para dhe kanë efekte pozitive në shitje dhe i lehtëson kushtet e tregtisë. Social media manager konsiderohet si një element i dobishëm për bizneset sot e veçanërisht për biznesin e vogël. Avantazhet e përdorimit të rrjeteve sociale për biznesin janë: rritja e shitjeve, rritja e numrit të klientëve, nxitje e kreativitetit, marrëdhënie të mira dhe pozitive me klientët. Referuar disa studimeve, kosto ka efekt në përdorimin e teknologjisë nga bizneset e vogla dhe të mesme (Wang, 2010).

Studime të tjera të mëvonshme tregojnë se ka një lidhje rastësore mes koston dhe përdorimit të teknologjisë në biznese të mesme dhe të vogla (Kim, 2015); sipas tyre kostoja që ka përdorimi i teknologjisë nuk ndikon plotësisht në implementimin e saj.

Literatura tregon gjithashtu se biznese të vogla nxiten të përdorin Social Media Manager edhe për shkak të lehtësisë që jep ky kanal në procesin e shitjeve. Edhe nëse pronari ka pak ose shumë pak njohuri në përdorimin e platformave, tendencat janë që të nxitet drejt përdorimit dhe trajnimit të platformave të rrjeteve sociale.

Studime të tjera mbështesin dobishmërinë në përdorim të SMM duke e konsideruar gjithashtu si një faktor që nxit përdorimin. Sipas (Kim T. &, 2019), dobia e perceptuar ka një marrëdhënie pozitive me përdorimin e teknologjisë, pronarët e bizneseve e kuptojnë dhe perceptojnë qartë përfitimet që sjell përdorimi i teknologjisë.

Lehtësia në përdorim është një faktor tjetër me ndikim në përdorimin e teknologjisë, por gjithashtu dhe një faktor përcaktues në përdorimin e rrjeteve sociale për qëllime marketingu nga biznese të vogla. Literatura të ndryshme tregojnë një marrëdhënie pozitive dhe një lidhje mes këtyre dy elementëve. Sipas Ware (2018), nëse inovacioni është i lehtë në përdorim dhe kuptohet, individët janë më të motivuar për ta përdorur atë.

3. Metodatat e kërkimit

Për t'ju pergjigjur pyetjeve kërkimore dhe hipotezave të ngritura në këtë studim janë përdorur të dhëna parësore dhe dytësore, si dhe është hartuar një pyetësor i strukturuar me pyetje mbi tipologjinë e biznesit, pyetje që lidhen me të dhëna demografike të pronarit, për të kuptuar sa ndikojnë këto faktorë në përdorimin e SMM. Një grup tjetër pyetjesh janë mbi marketingun digjital dhe faktorët që janë marrë në analizë. Ky pyetësor u plotësua nga 185 pronarë biznesesh ose persona që deklarojnë se ligjërisht nuk janë ata pronarët, por praktikisht biznesi drejtohet dhe menaxhohet prej tyre. Të dhënat e pronarëve u morën nga QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit). Pyetësori është shpërndarë elektronikisht dhe është dërguar në mënyrë rastësore. Qytetet që kanë dhe % më të lartë të personave të intervistuar janë Tirana dhe Durrësi, kjo dhe për faktin që numri më i madh i bizneseve në vend është përqendruar në këto qytete. Referuar INSTAT, njësitë e biznesit janë përqendruar kryesisht në qarqet Tiranë dhe Durrës me 54,4% të numrit të përgjithshëm të njësive lokale aktive. Analiza e pyetësorëve është e kushtëzuar vetëm në biznesin e vogël. Janë përdorur modele të ndryshme statistikore për të analizuar lidhjen mes variablave. Hipotezat e ngritura janë:

H₁: Kosto ka një impakt në përdorimin e rrjeteve sociale për shitje.

H₂: Lehtësia në përdorim ka një impakt pozitiv në përdorimin e rrjeteve sociale.

H₃: Marketingu digjital ka një impakt pozitiv në të ardhurat e biznesit të vogël.

4. Analizë e të dhënave

Për të kuptuar faktorët që ndikojnë në përdorimin e marketingut digjital në biznesin e vogël në Shqipëri është hartuar një pyetësor i cili ka për qëllim të mbledhë informacionin e duhur në funksion të pyetjeve kërkimore dhe hipotezave të ngritura. Personat e intervistuar përfaqësojnë biznese të vogla si në sektorin e shërbimeve ashtu dhe në atë të tregtimit të produkteve. Pyetësori është plotësuar online dhe të dhënat janë analizuar në SPSS. Është zgjedhur biznesi i vogël, sepse studimet janë më shumë të fokusuara në biznesin e madh duke qenë se ka kapacitete financiare dhe njerezore për të investuar në teknologji, ndërsa ky studim në biznesin e vogël do i shërbejë çdo sipërmarrjeje të vogël për të marrë informacion në lidhje me mundësitë dhe avantazhet që ofron marketingu digjital.

Në Tabelën 1 paraqiten të dhëna për llojin e biznesit, sipas formës ligjore dhe legjislacionit vendas.

Tabela 1. Lloji i biznesit

Lloji i biznesit	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
I vogël	178	96.2	96.2	96.2
I mesëm	3	1.6	1.6	97.8
I madh	4	2.2	2.2	100
Gjithsej	185	100	100	

Pasi u mor lista e bizneseve të vogla nga QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit), u shpërnda pyetësori në 200 biznese në total, por vetëm 185 prej tyre u pergjigjën. Referuar Tabelës 2, tre

nga të anketuarit kanë deklaruar se janë biznes i mesëm dhe katër prej tyre i madh, ndryshim i cili në të dhënat që u morën në QKB nuk ishte vendosur. Analiza do të kryhet vetëm për 178 biznese të cilat i janë përgjigjur pyetësorit si biznese të vogla. Siç shihet dhe nga Tabela 2, 99 nga të intervistuarit janë femra, ku ato deklarojnë se janë pronare të një biznesi të vogël si në sektorin e tregimit të produkteve ashtu dhe në atë të ofrimit të shërbimeve.

Tabela 2. Shpërndarja e ndërmarrjeve të anketuara sipas llojit të aktivitetit dhe gjinisë së pronarit

Gjinia	Lloji i aktivitetit		Gjithsej
	Shërbime	Produkte	
Meshkuj	30	49	79
Femra	52	47	99
Gjithsej	82	96	178

Referuar Raportit të Regjistrimit të Biznesit për vitin 2021 rezulton që 31.1% e ndërmarrjeve drejtohen nga femra (Instituti i Statistikave).

Hipotezat që do të testohen janë si më poshtë:

H₁: Kosto ka një impakt në përdorimin e rrjeteve sociale për shitje.

Përdorimi i marketingut digjital ka një kosto të pakrahasueshme për biznesin e vogël në krahasim me atë tradicional. Platformat e ndryshme sociale si Facebook, Instagram, Tik Tok, Pinterest, LinkedIn, Whatsapp Business janë të aksesueshme pa pagesë. Bizneset mund të reklamojnë produktet e tyre falas ose mund ti promovojnë nëpërmjet reklamave që mund të sponsorizohen për tu bërë të dukshme në profile të ndryshme. Kosto që paguhet për këto reklama në rrjetet sociale është e ulët dhe varet nga target grupi që do të arrish. Në tabelën e mëposhtme kemi përdorimin e rrjeteve sociale dhe kostot e përdorimit.

Referuar tabelës 3, të intervistuarit deklarojnë se do ta përdornin marketingun digjital, rrjetet sociale për promovim edhe nëse ky promovim do kishte një kosto financiare, pasi kosto që ka përdorimi i rrjeteve sociale është shumë e ulët në krahasim me koston që ka marketingu tradicional. Sipas Derham (2011), rrjetet sociale janë shumë të përshtatshme për bizneset e mesme dhe të vogla për shkak të kostove shumë të ulta dhe nuk ka barriera për t'u bërë pjesë e këtyre platformave.

Tabela 3. Nëse përdorimi i rrjeteve sociale për shitje do kishte kosto, do e përdornit?

Përgjigjshmëria	Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Po	117	63.2	65.7	65.7
Jo	61	33.0	34.3	100.0
Total	178	96.2	100.0	
Pa përgjigje	7	3.8		
Gjithsej	185	100.0		

Në Tabelën 4, tregohet rezultati i analizës ANOVA dhe siç shihet nga të dhënat vlera e rëndësisë është 0.614 dhe 0.880, më e madhe se 0.5, pra rritja e kosto së përdorimit të SM nuk

ndikon tek bizneset e vogla pasi ato do i përdorin gjithësesi rrjetet sociale.

Tabela 4. ANOVA^a H1

Model		Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
1	Regression	0.032	1	0.032	0.255	.614 ^b
	Residual	22.17	176	0.126		
	Total	22.202	177			
2	Regression	0.032	2	0.016	0.128	.880 ^c
	Residual	22.17	175	0.127		
	Total	22.202	177			

a. Dependent Variable: A perdorni SM per shitje

b. Predictors: (Constant), A perdorni rrjete sociale per biznesin tuaj

c. Predictors: (Constant), A perdorni rrjete sociale per biznesin tuaj , Nese perdorimi i SM per shitje do kishte kosto do e perdornit?

Tabela 5. H₁ Coefficients^a

Model		Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients	t	Sig.
		B	Std. Error	Beta		
1	(Constant)	0.141	0.028		4.963	0
	A perdorni rrjete sociale per biznesin tuaj	0.041	0.081	0.038	0.505	0.614
2	(Constant)	0.140	0.035		4.059	0
	A perdorni rrjete sociale per biznesin tuaj	0.041	0.081	0.038	0.504	0.615
	Nese perdorimi i SM per shitje do kishte kosto do e perdornit?	0.003	0.056	0.004	0.050	0.960

^a. Dependent Variable: A perdorni SM per shitje

H₂: Lehtësia në përdorim ka një impakt pozitiv në përdorimin e rrjeteve sociale.

Shumë studime arrijnë në përfundim se lehtësia në përdorim e rrjeteve sociale është një nga faktorët që nxit bizneset e vogla dhe të mesme të jenë prezente në këto platforma.

Në tabelën e mëposhtme shohim lidhjen midis përdorimit të rrjeteve sociale nga bizneset e vogla dhe lehtësisë në përdorim.

Tabela 6. A përdorni rrjete sociale për biznesin tuaj / A janë të lehta në përdorim rrjetet sociale?

		A janë të lehta në përdorim rrjetet sociale?		Gjithsej
		Po	Jo	
A përdorni rrjete sociale për biznesin tuaj?	Po	135	21	156
	Jo	19	3	22
	Gjithsej	154	24	178

Nga të dhënat ne Tabelen 6 shohim që 135 nga bizneset e intervistuar deklarojnë që platoformat e rrjeteve sociale janë të lehta në përdorim.

Tabela 7. H₂ ANOVA A përdorni rrjete sociale për biznesin tuaj?

	Sum of Squares	df	Mean Square	F	Sig.
Between Groups	0.000	1	0.000	0.000	0.982
Within Groups	19.281	176	0.110		
Total	19.281	177			

Nga rezultatet e Tabelës 7 shohim që vlera e rëndësisë është 0.982, më e madhe se 0.5, që do të thotë që nuk ka një lidhje midis variablave të marra.

H₃: Marketingu digjital ka një impakt pozitiv në të ardhurat e biznesit të vogël.

Tabela 8. Nga 1-5 sa janë rritur shitjet në biznesin tuaj nga përdorimi i marketingut digjital?

Përgjigjja	Frequency	Percent	Percent	Cumulative Percent
Shumë pak	2	1.1	1.3	1.3
Mjaftueshëm	32	17.3	20.9	22.2
Shumë	78	42.2	51	73.2
Mesatarisht shumë	41	22.2	26.8	100
Total	153	82.7	100	
Pa përgjigje	32	17.3		
Gjithsej	185	100		

Nga të dhënat rezulton që rrjetet sociale dhe marketingu digjital ndikojnë në rritjen e nivelit të shitjeve në biznesin e vogël.

Tabela 9. One-Sample Test

	Test Value = 0					
	t	df	Sig. (2-tailed)	Mean Difference	95% Confidence Interval of the Difference	
					Lower	Upper
A përdorni SM për shitje	5.502	177	0	0.1461	0.094	0.198
Nga 1-5 sa janë rritur shitjet në biznesin tuaj nga përdorimi i marketingut digjital.	68.4	152	0	4.033	3.92	4.15

Nga të dhënat e tabelave të mësipërme arrijmë në përfundim që përdorimi i rrjeteve sociale për shitje ndikon në rritjen e nivelit të shitjeve.

5. Rezultate dhe Rekomandime

Ky studim analizoi koston, lehtësinë e përdorimit, dobishmërinë, avantazhet që rrjetet sociale ofrojnë për biznesin e vogël si faktorë që ndikojnë dhe nxisin përdorimin e platformave dhe rrjeteve sociale. Bazuar në rezultatet e të dhënave mbi faktorët që kemi marrë në analizë arrijmë në përfundim që prezenca e bizneseve të vogla në rrjete sociale rrit performancën e shitjeve. Gjithashtu shitjet e bëra nëpërmjet platformave të rrjeteve sociale i ndihmojnë bizneset të kenë një portofol elektronik, digjital të menaxhimit të klientëve dhe preferencave të tyre. Kjo i jep mundësi që ti përdorin këto të dhëna dhe për qëllime marketingu apo të fushatave promovionale. Kostot që kanë bizneset në promovimin e produkteve apo shërbimeve që ato ofrojnë duke përdorur marketingun digjital dhe rrjetet sociale janë shumë të vogla ndaj rritja e kostove që ka përdorimi i marketingut digjital nuk ndikon në përdorimin e platformave të rrjeteve sociale nga bizneset e vogla. Gjithashtu lehtësia në përdorim nxit prezencën e bizneseve të vogla në rrjete sociale. Të ardhurat që merr biznesi i vogël nga promovimi i produkteve apo shërbimeve nëpërmjet marketingut digjital janë një ndër faktorët kryesor që cojnë bizneset në përdorimin e këtyre platformave.

Bizneset e vogla duhet ta shohin përdorimin e rrjeteve sociale dhe marketingut digjital si një mënyrë për të qënë prezente në tregje kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare me kosto shumë të ulëta, por me propabilitet të lartë për shitje të produkteve ose shërbime në tregje të huaja. Gjithashtu trajnimi dhe përshtatja me metodat e reja të funksionimit të rrjeteve sociale në llogaritë e bizneseve i ofron atyre avantazhe në shitje në krahasim me konkurrentët.

Literatura

Derham, R. C. (2011). Creating value: an SME and social media. *PACIS*.

Instituti i Statistikave. (n.d.). Instituti i Statistikave. Retrieved 2022, from

<https://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%3%ABrbimet/regjistrat-e-biznesit/publikimet/2022/regjistrat-e-biznesit-2021/>

Kaplan, A.M & Haenlein, M. (2010). Users of the world, unite! The challenges and opportunities of Social Media. *Business Horizons*, 53(1), 59–68. <https://doi.org/10.1016/j.bushor.2009.09.003>.

Kim, K. &. (2015). An acceptance model for smart watches: implications for the adoption of future wearable technology. *Internet Research*, 25(4), 527–541. <https://doi.org/10.1108/IntR-05-2014-0126>.

Kim, T. &. (2019). Consumer acceptance of sports wearable technology: The role of technology readiness. *International Journal of Sports Marketing and Sponsorship*, 20(1), 109–126. <https://doi.org/10.1108/IJSMS-06-2017-0050>.

Muntiga et al. (2011). “Introducing COBRAs: Exploring motivations for brand-related social media use”. *International Journal of Advertising*, Vol. 30 No.1, pp.13-46.

Rezvani, M., & Colabi, A. (2012). Conceptualize of entrepreneurial strategies in food industries’ SMEs. *Journal of Business Management*, 10, 137–158.

- Shareef et al. Mukerji, B. A. (2018). Advertisements on Facebook: Identifying the persuasive elements in the development of positive attitudes in consumers. *Journal of Retailing and Consumer Services*, 43, 258-268.
- Shideler, D. .. (2012). "Broadband impact on small business growth in Kentucky". *Journal of Small Business and Enterprise Development*, Vol. 19 No.4, pp.589- 606.
- Wang, Y. &. (2010). Understanding the determinants of RFID adoption in the manufacturing industry. *Technological Forecasting and Social Change*, 77(5), 803–815.
<https://doi.org/10.1016/j.techfore.2010.03.006>.
- Ware, J. (2018). Wearable technologies and journalism ethics: Students' perceptions of Google glass . *Teaching Journalism & Mass Communication*, 8(1), 17–24. https://doi.org/10.1007/978-3-319-25684-9_25.

Analiza e faktorit njeri si kërcënim i brendshëm ndaj sigurisë së një organizate

Besmir Kanushi^{a,15}, Grigorina Boçe^a, Frida Zisko^a
^a*Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, Tiranë, Shqipëri*

Përmbledhja

Gjatë viteve të fundit, me rritjen e intensitetit të përdorimit të internetit, kërcënimet dhe llojet e tyre janë në rritje, ku sulme dhe incidente të ndryshme identifikohen çdo ditë dhe një pjesë e tyre kanë sjellë humbje dhe pasoja në jetën dhe ekonominë e njerëzve dhe organizatave publike dhe private. Kërcënimet në vetvete janë të brendshme dhe të jashtme dhe secili prej tyre ka efektet e tij tek mbarëvajtja e organizatës. Por, sipas studimeve të fundit, aktualisht kompanitë ndihen të kërcënuara më tepër nga sulmet e brendshme se sa nga sulmet e jashtme. Kjo për vetë faktin se këto kërcënime nuk mund të eliminohen asnjëherë plotësisht për sa kohë njeriu është faktori kryesor si kërcënim i brendshëm ndaj sigurisë së një organizate.

Ky artikull ka në fokus punonjësin e privilegjuar si kërcënim të brendshëm në një organizatë. Qëllimi kryesor është të nxjerrë në pah kërcënimet e brendshme të sigurisë si dhe të prezantojë disa mënyra se si këto kërcënime mund të minimizohen. Ky qëllim është arritur nëpërmjet politikave dhe implementimit të një zgjidhjeje praktike për monitorimin e sesionit të privilegjuar, të cilat janë reflektuar në fund të artikullit.

Fjalët kyç: Akses; informacion; kërcënim; politika; punonjës; siguri; sistem; sulm

Abstract

During the last years, with the increase in the intensity of the use of the Internet, threats and their types are increasing, where different attacks and incidents are identified every day and a good part of them have brought losses and consequences to people's lives and the economy and public and private organizations. The threats themselves are internal and external and each of them has its own effects on the functioning of the organization. But, according to recent studies, companies currently feel more threatened by internal attacks than by external attacks. This is due to the very fact that these threats can never be completely eliminated as long as the person is the main factor as an internal threat to the security of an organization.

This article focuses on the privileged employee as an insider threat in an organization. The main goal is to highlight internal security threats and present some ways in which these threats can be minimized. This goal has been achieved through the policies and implementation of a practical solution for monitoring the privileged session which are reflected at the end of the article.

Keywords: Access, information, threat, policy, employee, security, system, attack

¹⁵ **KONTAKT:** besmir.kanushi@umsh.edu.al

1. Hyrje

Në dekadën e fundit, kërcënimet e brendshme janë kthyer në problem kryesor për kompanitë. Kjo për vetë faktin se aktorët që bëjnë pjesë janë persona të brendshëm të organizatës, kryesisht personel IT. Nga kjo lindin disa probleme. Si fillim, duke qënë të brendshëm, këta punonjës kanë akses në sistemet më kritike të kompanisë dhe nëse do të ndodhte një sulm, mbrojtje e gabuar apo neglizhencë, pasojat do të ishin fatale. Gjithashtu, duke qënë persona të brendshëm me aftësi të mira, reflektojnë kjo në faktin që u janë dhënë pozicione të atilla pune që kërkojnë llogari me akses të pakufizuar, ata mund të fshehin me elokuencë gjurmët e veprimeve të tyre ditore në kohë reale. Ky artikull do të ketë në fokus punonjësin e privilegjuar si kërcënues të brendshëm në një organizatë (Hunke and Probst, 2011).

Ky punim ka si qëllim kryesor të nxjerrë në pah kërcënimet e brendshme të sigurisë, aktorët kryesorë të këtyre kërcënimeve si dhe të prezantojë disa mënyra se si këto kërcënime mund të minimizohen. Ky qëllim është arritur nëpërmjet politikave si dhe implementimit të një zgjidhje praktike për monitorimin e sesionit të privilegjuar.

Përtej evidentimit të kërcënimeve të brendshme, aktorëve dhe mënyrave si sugjerohet të minimizohen kërcënimet, ky punim ka disa objektiva të cilat janë realizuar. Këto objektiva janë:

- Të analizohen dallimet midis kërcënimeve të brendshme me ato të jashtme;
- Të shpjegohet koncepti i punonjësve të privilegjuar si dhe të klasifikohen zgjidhjet për problemin e keqpërdorimit të të drejtave të privilegjuara
- Të demonstron në mënyrë praktike kontrolli dhe monitorimi i sesionit të përdoruesve të privilegjuar.

2. Rishikim i literaturës

Në këtë artikull përmenden disa nga punimet dhe literaturat ekzistuese në lidhje me faktorin njeri dhe konkretisht punonjësin si kërcënues të brendshëm në një organizatë. Megjithatë, vlen për tu theksuar se njeriu si faktor kërcënues ka nisur të merret në konsideratë vetëm vitet e fundit nisur nga raportet vjetore të këtyre viteve.

Sipas një deklaratë (McCauley-Bell & Crumpton, 1998) mbi faktorin njeri si rrezik për sigurinë e informacionit, duke qënë se teknologjia është futur thellë në jetët dhe proceset tona, tashmë veprimtaritë e njeriut kanë filluar të kufizohen. Pavarësisht se hartohen kontrole dhe masa teknike për sigurinë e informacionit, përsëri vazhdon të shtohet numri i sulmeve. Kjo do të thotë që siguria është e lidhur ngushtë me faktorin njeri (Schultz, 2005). Aksesi i paautorizuar në infrastrukturën e kompanisë jo gjithmonë është i qëllimshëm, por me raste mund të jetë rezultat i gabimeve. Këtu përmenden përveç gabimeve njerëzore edhe fatkeqësitë natyrore.

Pavarësisht se sa një kompani investon në teknologji mbrojtëse ndaj kërcënimeve dhe sulmeve, hallka më e rëndësishme për t'u investuar është njeriu. Kjo për vetë faktin se mund të investohet shumë në teknologjitë më të fundit, por nëse nuk janë njerëzit e duhur për t'i menaxhuar dhe përdorur atëherë nuk do arrihen objektivat e sigurisë dhe këto teknologji nuk do të shfrytëzohen siç duhet.

3. Metodologjia

Mënyra e hulumtimit dhe punimit të këtij artikulli, është bazuar në burime sekondare. Burimet e informacionit kanë qënë prej internetit, raporte zyrtare të organizatave ndërkombëtare, faqe zyrtare të autoriteteve dhe organizmave që kanë ndërrmarë studime në këtë fushë, artikuj shkencorë në revista dhe buletine të ndryshme të botuara nga autorë dhe teoricienë të huaj në lidhje me Sigurinë dhe Cyber Security.

4. Kërcënimet e sigurisë

Pavarësisht se sa me kujdes është krijuar dhe dizenuar një sistem, për sa kohë që njeriu ndërvepron me të gjithmonë do ketë një mundësi për dështim, mosfunksionim apo keqpërdorim të sistemit dhe komponentëve të tij (Gohari, 2012). Kjo për vetë natyrën e njeriut si komponent i sistemit. Përveç kësaj, shumë sisteme në kompani mbartin dobësi që në krijimin dhe dizenjimin e tyre, duke i bërë kështu vulnerable ndaj kërcënimeve dhe sulmeve. Përsa i përket kategorive të dëmeve që mund të shkaktohen kundrejt një sistemi, mund të rendisim klasat si më poshtë (Nikolakopoulos, 2009).

Ndërhyrja. Ndërhyrja nënkupton që një palë jo e autorizuar ka fituar akses mbi një aset. Problemi në këto raste qëndron në faktin se jo gjithmonë zbulohet në momentin që ndërhyrja ndodh.

Ndërprerja. Humbja, padisponueshmëria apo kthimi i një komponenti në gjendje të pa përdorshme nënkupton ndërprerjen e një sistemi.


Modifikimi. Modifikimi i komponentëve të sistemit nis me një ndërhyrje por shkon përtej saj, ku përveçse fitohet akses i paautorizuar gjithashtu modifikohen komponentët e aksesuar.

Fabrikimi. Fabrikimi ose falsifikimi konsiston në shtimin e objekteve ose moduleve në sistem nga palët e paautorizuara si dhe përdorimin e tyre.

4.1 Faktori njeri

Mjafton që njeri nga komponentët përbërës të sistemit të organizatës të komprometohet dhe një ose disa nga objektivat e sigurisë dështojnë. Gjatë këtij punimi do trajtohet dhe shqyrtohet njeriu si shkaktues i dështimeve në arritjen e sigurisë së sistemeve. Për të kuptuar pozicionin e njeriut në një sulm, skematikisht dhe logjikisht paraqitet në Figurën 1.

Figura 1. Pozicionimi i njeriut në një sulm



Shënim: Nikolakopoulos (2009)

Duke qënë se përdoruesi ka akses në komponentët teknologjikë të sistemit, mund të bëhet vetë shkak i dështimeve si rezultat i gabimeve apo veprimeve të qëllimshme por, gjithashtu mund të përdoret nga një sulmues jashtë sistemit për të kompromentuar sistemin (Brdiczka, 2018). Kështu, neglizhenca e pikave vulnerabel përbën një kërcënim për sistemin e informacionit në një kompani (Nikolakopoulos, 2009). Disa nga problematikat që krijojnë faktori njeri në sigurinë e brendshme të një organizate janë (Gogan, 2017):


- Shkelja e besimit.
- Mosrespektimi i politikave dhe procedurave.
- Keqpërdorimi i privilegjeve.
- Neglizhenca ose keqinformimi.
- Faktorët emocionalë dhe motivimi i dobët.
- Veprimet e brendshme keqdashëse.

4.2 Kërcënimet e sigurisë së një sistemi

Detyra më e rëndësishme e skuadrës së sigurisë në një organizate është mbrojtja e aseteve. Duke qënë se aset i përbën vlerë për kompaninë, dëmtimi, shkatërrimi, humbja apo modifikimi tyre shkakton dëm dhe humbje. Kështu, mbrojtja e tyre shndërrohet në domosdoshmëri. Por, zhvillimi i eventeve të ndryshme, qofshin këto të qëllimshme ose jo, përbën rrezik për asetet dhe mbrojtjen e tyre (Australian Computer Society, 2016). Shpesh, këto asete nën shënjestër i nënshtrohen presionit të vazhdueshëm nga agjentët kërcënues të cilët përpiqen të zbulojnë dhe shfrytëzojnë çdo dobësi që aset i mund të shfaqë. Si rezultat, kërcënim ndaj një asemi konsiderohet çdo objekt/person/entitet i cili përbën rrezik për sigurinë e asemi. Sipas (Benson, 2018), një mënyrë klasifikimi e kërcënimeve të sigurisë ndaj një organizate paraqitet në Figurën 2.

Pra, sulmet klasifikohen duke patur në bazë njeriun në sulme të shkaktuara ose jo nga njeriu, dhe nëse po, me apo pa qëllim të keq. Në varësi të pozicionimit të njeriut, nëse është aktor i brendshëm apo i jashtëm në kompani, kërcënimet ndaj sigurisë së kompanisë i klasifikojmë në kërcënime të jashtme dhe kërcënime të brendshme (Benson, 2018).

Figura 2. Klasifikimi i kërcënimeve të sigurisë



5. Mbrojtja nga punonjësit e privilegjuar

Ditët e sotme kompanitë kanë një problem i cili sa vjen dhe rritet sëbashku me rritjen e numrit të llogarive të privileguara që aksesojnë rrjetin e tyre (Ashiq, 2015). Përdoruesit e privilegjuar

kanë më tepër akses dhe të drejta mbi sistemet kritike të biznesit krahasuar me përdoruesit e thjeshtë. Në këtë kategori bëjnë pjesë përdorues të cilët aksesojnë llogari të përbashkëta administrative të cilat ndahen mes administratorëve të rrjetit, si përshebull përdoruesi root i sistemit Linux/Unix. Gjithashtu pjesë tjetër e këtij grupi janë përdoruesit me llogari personale të privileguara ku mund të përmendim menaxherët e biznesit, CEO ose IT- të (Crowd Research Partners 2018). Një lloj tjetër i aksesit të privileguar është dhe aksesimi i llogarive emergjente të cilat përdoren për të përmirësuar situatën në raste emergjente, ku mund të përmendim administratorët, operatorët IT, personelin help-desk. Gjithashtu, duke qënë se biznesit kanë sisteme të veçanta për ruajtjen dhe menaxhimin e të dhënave sensitive të aplikacioneve kyçe për kompaninë, ka përdorues të cilët kanë akses mbi këto të dhëna (Balabit, 2018a).

Ajo çfarë trajtohet në këtë artikull konsiston në disa nga mënyrat se si ne mund të mbrohemi nga gabimet apo punonjësit keqdashës në një kompani. Në mënyrë që të arrihet një mbrojtje efektive, është me rëndësi të kuptohet sa më mirë kërcënimi që kanoset ndaj aseteve. Për këtë, hapi i parë është të njohurit mirë i të dhënave që kompania ka dhe aseteve të informacionit. Gjithashtu, duhen njohur mirë përdoruesit e privileguar dhe sjelljet e tyre (Balabit, 2018b). Së fundmi, me rëndësi gjithashtu është dhe njohja e detyrimeve dhe standardeve ligjore që kompania duhet të plotësojë.

5.1 Kontrolli i sesionit të privileguar si zgjidhje

Gjatë kësaj çështje do shikohet më nga afër kontrolli i sesioneve dhe akseseve të privileguara ndaj sistemeve IT (Deursen, 2015). Kjo zgjidhje fokusohet në krijimin e kanaleve të komunikimit, politikave të mbrojtjes së këtyre kanaleve, politikave të kontrollit të aktivitetit dhe veprimeve të punonjësve të privileguar, indeksimit të çdo aktiviteti dhe ruajtjes së logeve për të si dhe regjistrimit me video të sesionit i cili është gjithashtu i rëndësishëm për shkak të indeksimit.

5.2 Implementimi Politikave të Sistemit të Monitorimit

Për të implementuar Politikën e Sistemit të Monitorimit (PSM) për të monitoruar konkretisht një lidhje me Sistemin e Shfrytëzimit (SSH), si fillim është e nevojshme të ilustron skema e rrjetit dhe të shikohen hap pas hapi politikat e krijuara. Programi është i instaluar në një makinë virtuale me sistem operativ Ubuntu 64. Makina dhe dy hostet që do të lidhen me njëri tjetrin janë në të njëjtin rrjet. Për këtë rast studimi, është përzgjedhur të jetë e tillë, përndryshe do kishte dy ndërfaqe për lidhjen e rrjeteve të ndryshme. Dy hostet të cilat do lidhen me SSH, janë Windows dhe Ubuntu 17.


5.3 Hartimi i politikave të monitorimit të aksesit të privileguar

Objektivi i parë i sigurisë është që të lejohet aksesimi me SSH nga një host tek tjetri vetëm sipas rregullave të PSM, dhe vetëm nëpërmjet kalimit nga PSM.

Konkretisht, të lejohet aksesimi i hostit Linux me IP: 192.168.2.44 nga kompjuteri Windows me IP 192.168.2.88 por vetëm nëpërmjet kalimit përmes PSM, aksesimi i drejtpërdrejtë është i bllokuar (Figura 3). Në këtë mënyrë ne sigurohemi që vetëm lidhjet të cilat ne


dëshirojmë të lejojmë mund të ndodhin dhe i gjithë trafiku kalon dhe monitorohet nëpërmjet PSM.

Figura 3. Skema ilustruese e rrjetit



Kështu, krijohet rregulli për lejimin e aksesit me SSH nga 192.168.2.88 tek 192.168.2.44 si në Figurën 4,


Figura 4. Krijimi i lidhjes mes dy hosteve



Sipas këtij rregulli, kompjuteri windows duhet të lidhet me PSM me SSH dhe më pas të zgjedhë IP e vërtetë të synuar. Nëse nga kompjuteri Windows kërkohet lidhja me hostin linux dhe kryhet me sukses, atëherë PSM lejon lidhjen host windows- host linux. Përndryshe nëse nga kompjuteri windows kërkohet lidhja me një host tjetër përveç atij me IP 192.168.2.44, PSM kontrollon të gjithë rregullat; nëse kjo lidhje nuk lejohet në asnjë prej rregullave atëherë nuk ja lejon aksesin. Që në momentin që lidhja vendoset, është nën monitorimin e administratorit të PSM.

Objekti i dytë i sigurisë është hartimi i politikave të sigurisë të cilat kufizojnë veprimtarinë keqdashëse/ gabimet e punonjësit me të drejta të privileguara bazuar tek përmbajtja.

Pavarësisht se një punonjës gëzon të drejta të privileguara, ai nuk duhet të neglizhohet apo të lihet i lirë të bëjë çdo veprim mbi sistemet. Kështu hartohen politika të cilat indikojnë se me shkrimin e komandave të caktuara të padëshirueshme, të shkëputet menjëherë lidhja SSH. Konkretisht, është hartuar politika e përmbajtjes si në Figurën 5.

Figura 5. Politika e përmbajtjes

Kjo politikë e emërtuar “no_shutdown”, është krijuar për lidhjet me SSH, konkretisht mbi komandat që mund të ekzekutohen në një lidhje SSH. Sipas kësaj politike, nëse gjatë sesionit SSH, përdoruesi shkruan komandën *shutdown* ose *reboot*, veprimi që ndërmerret menjëherë është shkëputja e lidhjes (Terminate), pra personi duhet të kërkojë akses edhe njëherë për hostin. Gjithashtu, mbahet log mbi këtë event.

Deri në këtë pikë, kemi dy masa sigurie të pavarura nga njëra tjetra. Me anë të së parës kufizojmë aksesin ndërmjet hosteve dhe sigurohemi që trafiku kalon përmes PSM dhe tek e dyta, kemi një politikë që nuk lejon fikjen apo ri-fillimin e një kompjuteri/sistemi pasi menjëherë shkëput lidhjen SSH pa lejuar ekzekutimin e komandës. Hapi tjetër lidh dy të parët sëbashku.

Objektivi i tretë i sigurisë kërkon që pavarësisht se lejohet lidhja nga hosti Windows tek ai Linux, përdoruesi i privilegjuar të mos ketë të drejtë të fikë apo rifillojë hostin Linux.

Për këtë duhet përmendur si fillim koncepti kanalit. Në momentin që ne kemi krijuar rregullin e figurës së mësipërme, kemi lejuar krijimin e një kanali komunikimi mes dy hosteve (Verizon, 2017). Por që ky komunikim të mos keqpërdoret apo të jetë pre e gabimeve njerëzore, duhet t’i bashkëngjiten politika sigurie të cilat kufizojnë dhe menaxhojnë të drejtat e përdoruesve në sistem/host (Ponemon, 2016). Kështu, për të bërë lidhjen që në komunikimin SSH_Simple të kufizohen veprimet e përdoruesve sipas politikës së përmbajtjes “no_shutdown” duket krijuar një politikë kanali, e cila konkretisht është quajtur “shell_no_shutdown” si në Figurën 6.

Sipas kësaj politike të kanalit, 24x7 orë në ditë monitorohet komunikimi në kanal dhe ushtrohet politika e përmbajtjes “no_shutdown”. Gjithashtu, çdo komunikim duhet t’i nënshtrohet autorizimit “four-eyes” dhe të auditohet. Gjatë aplikimit të autorizimit “four-eyes”, edhe pse përdoruesi mund të logohet me sukses në hostin destinacion, do presë lejimin ose jo të lidhjes nga administratori i PSM.

Figura 6. Politika e kanalit të komunikimit

Type	From	Target	Time	Actions
Session shell			7x24	<input checked="" type="checkbox"/> Four-eyes <input checked="" type="checkbox"/> Audit

Gateway groups: [redacted] +

Remote groups: [redacted] +

Content policy: no_shutdown

Tashmë, kemi një komunikim nga hosti Windows në atë Linux të krijuar dhe një politikë kanali e cila monitoron lidhjen 24x7; në vetvete mban politikën e përmbajtjes ku kufizohen komandat *shutdown* dhe *reboot*. Hapi i fundit është lidhja e këtyre politikave me komunikimin Windows-Linux, e cila realizohet si në Figurën 7, në opsionet e lidhjes SSH_simple.

Figura 7. Realizimi i lidhjes Komunikim-Politikë kanali-Politikë përmbajtje, PSM

Enable indexing:

Priority: normal

Indexing policy: full_indexing

Connection rate limit: [input] connections/minute

Channel database cleanup: [input]

SSH settings: default

Authentication policy: base

Channel policy: shell_no_shutdown

Audit policy: default

LDAP server: [input]

Usermapping policy: [input]

Backup policy: [input]


Archive/Cleanup policy: [input]

Analytics policy: [input]

Credential Store: [input]


AA plugin: [input]

Si përfundim, kemi arritur që të lidhim hostin Windows me atë Linux në një kanal komunikimi. Mbi këtë kanal dhe komunikim ushtrohet politika e kanalit “shell_no_shutdown” sipas së cilës kanali monitorohet 24x7, auditohet, i nënshtrohet autorizimit “four-eyes” dhe gjithashtu kufizon veprimet e përdoruesit gjatë komunikimit sipas politikës së përmbajtjes “no_shutdown” e cila ndalon ekzekutimin e komandës *shutdown*, *reboot* duke shkëputur lidhjen dhe ruan loge për çdo event. Kjo ndërlidhje e këtyre masave të sigurisë është ilustruar dhe në Figurën 8.

Figura 8. Skemë ilustruese e lidhjes Komunikim-Politikë kanali-Politikë përmbajtje


5.4 Implementimi i monitorimit të aksesit të privilegjuar

Politikat e hartuara në pikën e mësipërme mund të përshtaten sipas rasteve dhe nevojave bazuar tek veçoritë e secilit prej komunikimeve. Në këtë seksion do të trajtohet hap pas hapi monitorimi dhe parandalimi i veprimeve të punonjësit aty ku dyshohet për ndodhi incidentesh. Si fillim vendosim një IP statike në kompjuter dhe dhënia e një IP të lirë nga rrjeti për PSM.

Figura 9. Konfigurimi i IP së hostit Windows, PSM


PSM-ja (Figura 10) ka IP: 192.168.2.50 dhe si gateway ka IP e router-it 192.168.2.111.

Figura 10. Dhënia e një IP-je ndërfaqes menaxhuese të PSM




Përdoruesi dëshiron të lidhet me SSH me hostin Linux 192.168.2.44. Për këtë si fillim hap programin Putty dhe vendos IP e PSM, pasi siç u tregua në skemën e parë të rrjetit, më parë duhet kaluar të PSM dhe pastaj është ajo e cila bëhet urë për komunikimin mes dy hosteve. Gjithashtu, duke qënë se kemi të bëjmë me akses SSH, zgjidhet opsioni SSH si protokoll dhe vendoset si portë ajo me numër 22, porta e SSH-së.

Figura 11. Lidhja mes SSH me PSM-në



Në mënyrë që të procesohet për vendosjen e lidhjes, është hapur porta 22 tek hosti në Linux dhe në programin e PSM hostuar në makinë virtuale. Pas vendosjes së IP së PSM do hapet terminali i SSH korrespondues i IP 192.168.2.50.

Figura 12. Autentifikimi tek hosti Linux, PSM



Në këtë çast punonjësi është lidhur me SSH me PSM. Për të kaluar tek IP e dëshiruar i kërkohet autentifikimi me një adresë e cila ka të drejta në hostin Linux. Ndryshe nga rastet kur aksesojmë direkt hostin pa ndërmjetësimin e PSM, në këtë rast vendoset logimi si :root@192.168.2.44. Ky format mund të deshifrohet si: dua të logohem si përdorues root në kompjuterin me IP 192.168.2.44. Në rastet e aksesit të drejtpërdrejtë do vendosej në *putty* IP e hostit Linux dhe në terminal logimi do ishte vetëm si root. Vendosija e IP bëhet për arsye se përmes PSM mund të kalojnë qindra lidhje komunikimi. Vetëm në këtë mënyrë mund të kuptohet se tek cili nga hostet e rrjetit do të logohet punonjësi këtë rradhë.


Pasi ka vendosur informacionin e llogarisë që do të logohet, i jepet mundësia të vendosë fjalëkalimin për të bërë autentikimin e plotë. Kjo është vija e parë e mbrojtjes. Duke qenë se për komunikimin “ssh_simple” është aktivizuar në politikën e kanalit komunikues autorizimi “four-eyes”, punonjësi nuk merr asnjë shenjë nga terminali nëse logimi ka qënë me sukses ose jo. Pra ndeshet me një ngrirje të ndërfaqes së terminalit. Kjo për vetë faktin se në kohë reale i ka shkuar një kërkesë për konfirmim administratorit të PSM, ku mund të shihen opsionet si në Figurën 13.

Figura 13. Kërkesa për akses, autorizimi Four-eyes, PSM

PROTOCOL	CONNECTION	CHANNEL	USER	REMOTE USER	SOURCE	DESTINATION	SERVER	START TIME	
ssh	ssh_inband	session-shell	root	root	192.168.2.88:33790	192.168.2.50:22	192.168.2.44:22	2018-04-06 16:14:27	Accept Reject Accept&Follow

Si fillim administratorit i tregohet që ka lidhje që presin për t’u konfirmuar dhe lista e tyre rifreskohet automatikisht. Në lidhje më të dhënat e kërkesës, si fillim tregohet protokollin ku po tentohet lidhja, konkretisht që kemi të bëjmë me një lidhje SSH. Më pas përmbajtja e kërkesës tregon përdoruesin e hostit Windows që po kërkon lidhjen (root i 192.168.2.88) dhe se si cili përdorues i hostit në linux po kërkon të futet (si root i 192.168.2.44). Një pjesë tjetër e kërkesës konsiston në informacion rreth hosteve ku shohim hostin burim të kërkesës, IP e PSM me të cilën lidhet me SSH dhe serverin/hostin e targetuar. Vlen për tu theksuar se kërkesa gjenerohet nga IP 192.168.2.88 dhe nga porta 33790 drejt dy të tjerave por në portën e SSH, portat 22 të secilës. Administratori pasi merr dhe vlerëson të dhënat e kërkesës mund të ndërmarrë një nga mundësitë: të pranojë kërkesën për lidhje me SSH, të refuzojë kërkesën për lidhje me SSH, të pranojë kërkesën dhe të ndjekë lidhjen në kohë reale.

Pranimi i kërkesës për lidhje me SSH. Pasi pranon këtë kërkesë, në të njëjtën kohë punonjësit i aktivizohet sërish terminali dhe tashmë figuron si i loguar dhe mund të kryejë veprimet e dëshiruara por pa kërcënuar sigurinë.

Figura 14. Pranimitë e kërkesës për akses


```


root@localhost:~
login as: root@192.168.2.44
root@192.168.2.44@192.168.2.50's password:
Last login: Wed Apr 4 16:19:06 2018
[root@localhost ~]# █

```

Refuzimi i kërkesës për lidhje me SSH. Në këtë rast përdoruesit marrin një alert mbi të cilin thuhet se aksesit tek 192.168.2.44 nuk mund të kryhet për momentin.


Pranimi i kërkesës dhe ndjekja e lidhjes në kohë reale. Ky është një opsion shumë i rëndësishëm përse i përket zbulimit dhe parandalimit të kërcënuesve të padryshuar më përpara. Administratori mund të futet në kohë reale dhe të shohë se çfarë po bën apo tenton të bëjë punonjësi që ka fituar aksesin. Ky monitorim në kohë reale nuk lë të kuptohet gjë nga ana e punonjësit, ai vepron sikur të ishte vetëm por realisht jo, dikush po e vëzhgon pa u kuptuar. Nëse administratori vëren aktivitetet jo të zakonshëm apo sjellje të pa evidentuara më përpara, i jepet mundësia t'ja shkëpusë lidhjen punonjësit, kështu ai nuk mund të dëmtojë dot sistemin.

Në këtë rast administratori sheh gjithçka në formë videoje (Figura 15) por me dallimin që kjo ndodh në kohë reale. Në anën e djathtë të figurës është pamja nga aktiviteti që po kryen punonjësi dhe majtas shikohet **se si në kohë reale, brenda orës 16:19:06**, ky logim dhe ekzekutim komandash reflektohet në ekranin e administratorit, i cili mund ti ruajë dhe të kërkojë me fjalë kyçe edhe pasi sesioni mbaron.

Figura 15. Monitorimi dhe regjistrimi në kohë reale i sesionit të punonjësit

Në rastin e zgjedhjes për t'i shkëputur lidhjen kur situata nis dhe bëhet e dyshimtë, atij i shfaqet një njoftim sipas së cilit sesioni ka mbaruar dhe serveri ka shkëputur lidhjen (Figura 16).

Figura 16. Ndërprerja e aksesit të punonjësit



Për arsye demonstrimi është marrë rasti kur përdoruesi shkruan komandën *ls* për të lexuar listën e files-ve brenda direktorisë *cd/etc*. Në të njëjtën mënyrë mund të parandalohet një veprim fshirje, shutdown-i, etj.

Një ndër avantazhet më kryesore të programit PSM ndër të tjera është llogaridhënia. Për sa kohë që trafiku kalon përmes PSM, çdo gjë regjistrohet (komunikim, ndryshim, gjenerim raportesh etj).

Nga kjo pjesë e shkëputur (Figura 17), vihet re që është mbajtur rekord i lidhjes me sukses të SSH nga 192.168.2.88 tek 192.168.2.44.

Figura 17. Mbajtja e log-eve të lidhjeve mes hosteve

6	2018-04-06 12:47:58	2018-04-06 12:47:58	00:00:00	ssh_inband			192.168.2.110
7	2018-04-06 12:47:58	2018-04-06 12:47:58	00:00:00	ssh_inband			192.168.2.110
8	2018-04-06 12:47:58	2018-04-06 12:47:58	00:00:00	ssh_inband			192.168.2.110
9	2018-04-06 12:47:59	2018-04-06 12:47:59	00:00:00	ssh_inband			192.168.2.110
+10	2018-04-06 16:16:11	2018-04-06 16:19:54	00:03:43	ssh_inband	MyPcToNagios	Session shell	192.168.2.88 192.168.2.44

6. Politika dhe procese mbrojtëse

Përveç aplikimit të teknologjive mbrojtëse, me rëndësi është dhe hartimi i politikave për minimizimin e kërcënimeve të brendshme. Sikurse implementimet teknologjike, këto procedura gjithashtu mbartin rëndësi pasi mund të parandalojnë sulmet pa kosto dhe vështirësi. Ndër to mund të përmendim:

Kryerja e kontrolleve në sfond. Rekomandohet që të kryhen kërkime paraprake përpara se të merren punonjës të rinj në punë sa i takon aktivitetet e tyre të mëparshme dhe historikut të tyre të punësimit. Kjo do ishte një mënyrë për tu siguruar që nuk bën pjesë të kompanisë punonjës me precedentë të mëparshëm.

Studimi i sjelljes së punonjësve. Është gjithmonë e rëndësishme të mbash punonjësit nën vëzhgim. Sjellja e tyre mund të tregojë shumë rreth kënaqësisë/pakënaqësisë në punë.

Vendosja e principit të privilegjit minimal. Sa më pak privilegje të kenë punonjësit, aq më e lehtë është mbrojtja e të dhënave. Kjo pasi ka më pak punonjës që mund të kryejnë gabime apo veprime keqdashëse dhe më pak llogari me akses të privilegjuar.

Kontrolli i aksesit. Aplikimi i masave të kontrollit të aksesit gjithashtu është një politikë e cila ndërmerret nga shumë kompani. Këtu mund të përfshihen politikat mbi shpërndarjen e fjalëkalimeve dhe përdorimin e tyre, autentifikimit të dyfishtë, ndarja e punonjësve në grupe aksesit dhe vendosja tek secili grup i të drejtave të aksesit sipas nevojës.

Edukimi i punonjësve. Një masë tjetër e cila merret për parandalimin e incidenteve është trajnimi dhe edukimi i punonjësve mbi sigurinë, rëndësinë e saj, efektet dhe pasojat që mund të ketë secili prej veprimeve të tyre.

7. Përfundime

Siguria është një proces i vazhdueshëm dhe i përhershëm që kërkon angazhimin e plotë dhe përfshirjen e secilit në kompani, proces që nuk duhet ndalur dhe neglizhuar. Kjo për vetë faktin se asnjëherë nuk mund të jemi plotësisht të sigurtë që kemi arritur sigurinë maksimale dhe që asgjë nuk mund të na kërcënojë më. Siguria nuk arrihet vetëm një herë gjatë një procesi, por duhet punuar në mënyrë konstante dhe të vazhdueshme që ta minimizojmë çdo herë.

Pavarësisht se sa një kompani investon në teknologji mbrojtëse ndaj kërcënimeve dhe sulmeve, hallka më e rëndësishme për t'u investuar është njeriu. Kjo për vetë faktin se mund të investohet shumë në teknologjitë më të fundit por nëse nuk janë njerëzit e duhur për t'i menaxhuar dhe përdorur atëherë nuk do arrihen objektivat e sigurisë dhe këto teknologji nuk do shfrytëzohen siç duhet. Gjithashtu, pavarësisht se sa kemi investuar në teknologji, mjafton një moment dobësie i njeriut dhe mund të arrihet deri në kërcënim të vazhdimësisë së biznesit dhe organizatës.

Kërcënimet e brendshme janë më të dëmshme dhe më të frikshme për një kompani. Mund të mos kuptohet kurrë që një sulm i brendshëm ka ndodhur. Kjo dhe sepse punëdhënësit janë të prirur ta presin kërcënimin nga jashtë dhe jo nga brenda, kërcënimet e tilla janë të vështira për t'u kuptuar pasi nuk lihen gjurmë dhe prekin në zemër të aseteve të kompanisë. Kjo sepse personat që i shkaktojnë kanë akses të plotë dhe mbi asetet më kritike. Nëse një sulm i jashtëm duhet të depërtojë shumë shtresa për të mbërritur tek asetet kritike, një sulm i brendshëm është thjesht vetëm një hap larg.

Literatura

Ashik, JA. (2015) *Insider vs. Outsider Threats: Identify and Prevent*. JA, Ashiq. s.l. : Infosec Institute, 8 June 2015.

Australian Computer Society. (2016). *Cybersecurity Threats Challenges Opportunities*. Sydney. November 2016.

- Balabit. (2018a). One Identity. *The rogue privileged user*. California.
- Balabit. (2018b). One Identity. *The Known Unknowns of Cyber Security*. California.
- Benson, C. (2018). Security Threats. www.microsoft.com. [Online] [Cited: Qershor 23, 2018.] <https://msdn.microsoft.com/en-us/library/cc723507.aspx>.
- Brdiczka, Oliver. Security. *Computerworld*. [Online] Dhjetor 5, 2014. [Cited: Qershor 22, 2018.]
- Crowd Research Partners. (2018). *Insider Threat Report*.
- Deursen, N. (2015). CISO. *Security Intelligence*. [Online] Janar 13, 2015. [Cited: Qershor 26, 2018.]
- Gogan, M. (2017, April 17) Insider Threats as the Main Security Threat in 2017. Tripwire, <https://www.tripwire.com/state-of-security/insider-threats-main-security-threat-2017>
- Gohari, A. (2012) Introduction & Concepts. [book auth.] N.Karami. *Management Information Systems*.
- Hunke, J., Probst, C. (2011) Insiders and Insider Threats: An Overview of Definitions and Mitigation Techniques. *Journal of Wireless Mobile Networks, Ubiquitous Computing, and Dependable Applications*. 3(1), pp 4-27. DOI: 10.22667/JOWUA.2011.03.31.004
- McCauley-Bell, P.R., Crumpton, L.L. (1998). The human factors issues in information security: What are they and do they matter? *In Proceedings of the Human Factors and Ergonomics Society*, 42(4). <https://doi.org/10.1177/154193129804200408>
- Nikolakopoulos, T. (2009). Evaluating the Human Factor in Information Security. <http://urn.nb.no/URN:NBN:no-23698>
- Ponemon. (2016). *Cost of Insider Threats*.
- Schultz, E. (2005). The human factor in security. *Computers & Security*, 24:425–426, 2005.
- Verizon. (2017) *Data Breach Investigations Report*.
- Vrapi, A, Kanushi, B. (2021, April 23). Technology trend after the Covid-19 and Cybersecurity.[Conference session]. Shaping The Future: Digital Economy and Recent Technology Trends. Tirana, Albania. <https://cit.edu.al/icdertt-2021-conference/>
- University of Portsmouth. (2018). *Cyber Security Breaches Survey*.

